

ETIKA



BAJRAMI I KURBANIT
OSMAN NURI TOPBASH



NAIM DRIJAJ
OËLLIMET E HAXHIT



ABDULLAH DRAZ
KURANI, LAJMI TRONDITËS




DETYRIMI I NJERIUT
NDAJ TOKËS
DR. LULZIM ESATI



RRETHI I DASHURISË
ZEJNEP ÇALLËSHKAN



ZAHIT GENÇ
FJALA ËSHTË SI FARA



Mirësia
E ZOTIT

I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.

Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar, Bimët dhe pemët i përulen (Allahut). Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkëlqeni atë. Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!

Ai e ka bërë Tokën për krijesat. Aty ka fruta të llojllojshme dhe palma hur-mash me frutat si bistaqe, ka drithëra me gjethe e kërcje dhe bimë me erë të mirë.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Ai e krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu si vorba, ndërsa xhindet i krijoi prej flakës së zjarrit.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

(Ai është) Zoti i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Ai i ka lëshuar dy dete që të takohen, por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Prej tyre nxirren margaritarë dhe korale.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Atij i përkasin edhe anijet që lundrojnë nëpër dete e që lartohen si male.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Atij i lutet gjithkush që ndodhet në qiej dhe në Tokë e në çdo kohë Ai ushtron fuqinë e gjithëmbarshme.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

O ju dy barrët e Tokës (njerëz dhe xhinde), së shpejti do të caktojme gjykimin tuaj!

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

O xhinde dhe njerëz, nëse keni fuqi të përshkoni kufijtë e qiejve dhe të Tokës, atëherë përshkujini ato! Por nuk do të mund ta bëni këtë, përveçse me një fuqi të madhe (nga Allahu)!

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Kundër jush do të dërgohen flakë zjarri dhe tunxh i shkrirë (si dënim për mohimin e dhuntive të Allahut) dhe ju nuk do të mund të mbroheni.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Veç kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili (në Ditën e Kiame-tit)!

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Atë Ditë njerëzit dhe xhindet nuk do të pyeten për gjynahet e tyre.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

Keqbërësit do të njihen sipas she-njave dhe do të kapen për ballukesh dhe për këmbësh.

Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?

(Rahman, 1-42)

Tetor 2013

VITI: VII
NUMRI: 67

BOTUESI
Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR & KRYEREDAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahusa

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja




8

Kurbani dhe festa
Ali Riza Temel




34

Bajrami i Kurbanit
Osman Nuri Topbash



16



24

Furat Ibn Hajjani
Mustafa Erish

- 5 Nëse do mungonte mirësia e Zotit?!
Ahmet Tashgetiren
- 10 Tevhidi
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 12 Të papriturat e Ditës së Gjykimit
Sedat Islami
- 15 Na ishte njëherë
Salih Zeki Meriç
- 16 Kurani, lajmi tronditës
Abdullah Draz
- 20 Njeriu është krijuar për të luftuar
me vështirësitë
Ihsan Kurt
- 22 Rrethi i dashurisë
Zejnep Çallëshkan
- 26 Fjala është si fara
Zahit Genç



48

- Kushti për ekzistencë 30
Idris Arpat
- Një Ajet - Një Hadith 32

- Problemet e besimit në periudhën moderne 40
Prof. dr. Selim Ozarsllan
- Pengesat në rugën e thirrjes islame 42
Ebubekir M.
- Fryma e qytetërimit bashkëkohor
dhe disa specifika të tij 46
Nexhat Ibrahim
- Detyrimi i njeriut ndaj tokës 49
Dr. Lulzim Esati
- Sqimatarët 52
Nuredin Nazarko
- Tregtia me Allahun e Madhëruar 54
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi
- Qëllimet e Haxhit 58
Naim Drijaj

- Marrëdhëniet besim-moral në Islam
Prof. dr. Iljas Çelebi



44

- Politika e ekuilibrit
Nuredin Jëlldëz

59





Nëse do mungonte mirësia e ZOTIT!

Ahmet Tashgetiren

Në vende të ndryshme të Kuranit, Allahu i porositi njerëzit të jenë të vetëdijshëm dhe të mendojnë mbi mirësitë që u janë dhënë në zotërim.

“O njeri! Ç’të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd Bujar l cili të krijoi, të përsosi dhe të dha formë harmonike, i cili të formësoi në formën që Ai dëshiroi?” (Infitar, 6-8)

Thuaju: “Është Ai, që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat e, megjithatë, ju pak e falënderoni!” (Mulk, 23)

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.” (Nahl, 78)

“A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë?” (Beled, 8-9)

“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?” (Fussilet, 53)

“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

“Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?” (Ky ajet përmendet 24 herë në suren Rrahman.)

Sipas një transmetimi të Ebu Dherrit, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: **“Për çdo nyjë të trupit duhet sado-ka.”**

Kurse në një hadith tjetër informohemi për 360 nyje të trupit dhe që për secilën duhet të jepet lëmoshë.

Prej njeriut kërkohet shikimi i vetvetes, vëzhgimi i gjithësisë dhe gjetja e Zotit... Në fakt, kjo nuk është e vështirë.

Kur hedhim shikimin në horizont, çdo gjë shfaqet, derdhet para syve tanë, por njeriu mund të mos i shikojë gjërat që i shfaqen para syve. Atij i duket sikur çdo gjë buron prej tij. I duket sikur do të ekzistojë përgjithmonë, sikur shikon gjithçka, sikur çdo gjë që hamë, pimë dhe përdorim ka ekzistuar ngaherë.

Njeriu merr frymë, ha, pi dhe jeton pa menduar mbi to.

Por si mund të realizohet ndërgjegjësimi për mirësitë?

Ndërgjegjësimi arrihet, kur mirësitë të pushojnë së ekzistuari...

Kur të humbasim fëmijën, kur të humbim një të afërm, kur të humbim shikimin, dëgjimin, kur të humbin një dorë, një këmbë, kur të kemi probleme me frymëmarrjen, me zemrën, me veshkat, me tensionin, me diabetin, me kujtesën...

“Le të meditojë njeriu se prej çfarë është krijuar” na këshillon Kurani, pastaj shton: **“është krijuar prej një lëngu që hidhet e që del ndërmjet shtyllës kurrizore dhe brinjëve.”** (Tarik, 5-7)

Si arrihet krijimi i njeriut nga një pikë ujë? Ku fshihet

në atë pikë ujë zemra, truri, mushkëritë, dora, krahu, syri, veshi, fytyra, gjuha? Për më tepër, ku çdo gjë është në një harmoni perfekte.

Përbërja e atmosferës...

Roli jetësor i oksigjenit për trupin e njeriut...

Rrugët e përshtatshme të frymëmarrjes për kalimin e oksigjenit me lehtësi nëpër trup...

Mushkëritë...

Gjaku...

Roli jetësor i gjakut për çdo organ të trupit.

Rrjeti i përsosur i venave, që bën të mundur përçimin e gjakut deri në skajet më të largëta të trupit...

Përzjerja e oksigjenit me gjakun...

Marrëdhënia zemër, tru dhe mushkëri.

Ndërgjegjja e përhapur në çdo pjesë të trupit.

Nervat...

Palca...

Nëse nuk do të kishim thonjtë. Nëse do të humbisnim një gisht... Nëse nuk do të ishin gjëndrrat e sekretimit të djersës... të lotit... Nëse do të prishej ritmi i zemrës... sikur të dëmtoheshin rrugët e gjakut... Nëse do të bllokohej një damar i trurit...

Çdonjëri prej nesh frikësohet nga humbja e këtyre mirësive, apo jo?

Ja pra, gjithë këto mirësi që na janë dhuruar nga Allahu, por që kujtohem për to vetëm kur i humbasim...

Kurse ata që janë të vetëdijshëm për gjithë këto mirësi, bien në sexhde falënderimi ndaj Allahut.

Kur Fudajl ibn Ijadi po lexonte ajetin: **"A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë."** (Beled, 8-9), filloi të qante me dënësë. Kur u pyet për shkakun, tha:

A e ke kaluar ndonjëherë natën, duke falënderuar Allahun për shikimin dhe dëgjimin që të ka dhuruar?"

Sadi Shirazi thotë se për çdo frymëmarrje dhe frymënxjerrje duhet nga një falënderim, sepse, nëse merr frymë, por nuk e jep dot vdes, jep frymë por nuk merr dot, përsëri vdes.

Por, sa i vetëdijshëm është njeriu për këtë?

Prof. dr. Arif Sarsëlmaz ka bërë shumë studime mbi mrekullitë e trupit të njeriut. Ndarja me ju e një pjese shumë të vogël nga studimet e tij do të mjaftonte për të kuptuar mrekullinë hyjnore në trupin tonë.


"Për të krijuar syrin e mushkonjës, duhet njohur shumë mirë natyra e diellit dhe e dritës. Uji ka një rol jetësor për organizmin. Vetëm një që ka njohuri të thella për qelizat, proceset metabolike dhe kushtet ekologjike, mund të dijë mënyrën më funksionale të përdorimit të ujit nga organizmi."

Megjithëse roli i veshkave në ruajtjen e ekulibrit të ujit në organizëm është i rëndësishëm, nuk duhet harruar edhe roli i mekanizmave rregullues hormonalë, sekretimi i të cilave varet drejtpërdrejt nga mirëfunksionimi dhe mirëkoordinimi i qendrave përgjegjëse për prodhimin e tyre në tru, po ashtu edhe gjëndrrat e djersitjes, të cilat funksionojnë sipas nivelit të temperaturës, sistemet e përthithjes së ujit nga ushqimet organike që konsumojmë, të gjitha këto sisteme të përkryera dhe të mirëllogaritura e refuzojnë prerazi rastësinë dhe pavetëdijen.

Uji, kaq i domosdoshëm për qindra reaksione që ndodhin në trup, nga njëra anë u bashkohet mbeturinave dhe përmes rrugëve të posaçme del jashtë, nga ana tjetër ripërtërihet vazhdimisht. Sasia dhe përbërja e ujit në qelizë dhe inde është vazhdimisht nën kontroll dhe në rast të uljes së sasisë të tij, menjëherë ndërhyjnë mekanizmat përgjegjës për plotësimin e sasisë së humbur. Edhe teprica edhe mangësia e tij në organizëm janë të dëmshme. Ekulibri i ujit në organizëm rregullohet përmes sinjaleve të ngopjes ose etjes.

Truri dhe sistemi nervor i krijuar për kryerjen e një sërë funksioneve në trup, si marrjen dhe vlerësimin e sinjaleve që vijnë nga organet shqisore, drejtimin e lëvizjes së muskujve, nyjeve, kockave, kryerjen e një sërë funksionesh për mirëfunksionimin e organeve të brendshme, ende vazhdon të ruajë enigma për shkencën. Megjithatë, mjafton një pjesë e vogël e atyre që dihen mbi trurin, për të kuptuar mrekullinë dhe strukturën e tij të përsosur.

Gjatësia totale e indeve nervore në organizmin e njeriut arrin deri në 768.000 km. Një qelizë nervore



mund të transmetojë njëkohësisht mbi 200 000 informacione. Numri total i qelizave nervore në trupin e njeriut është 30 miliard. Nga këta, 10 miliard janë në koren e trurit, kurse 10 miliard në trurin e vogël. Çdo ditë vdesin 50 000 deri në 100 000 qeliza nervore. Por të mos ju frikësojë ky numër, sepse te një person që jeton 70 vjet, gjatë gjithë jetës së tij vdesin vetëm 1.5-2 miliard qeliza nervore. Humbja e këtyre qelizave mund të vlerësohet si proces normal i plakjes.

Siç vërehet, "Krijimi", nuk shpreh thjesht krijimin e një organi, por ai përfshin krijimin e çdo gjëje në univers dhe ekzistencën në harmoni të plotë midis tyre.

Marrëdhënia e syrit të mushkonjës me dritën e diellit, marrëdhënia jashtë mase komplekse e sistemit të frymëmarrjes me atmosferën dhe përbërjen e ajrit..., marrëdhënia midis ekzistencës së ujit dhe nevojës së organizmit për ujë..., marrëdhënia shikim-dritë..., marrëdhënia natë-ditë me disiplinën e njeriut për të punuar dhe pushuar..., marrëdhënia midis sistemit tretës dhe ushqimit..., marrëdhënia e diellit me tokën, forca e gravitetit të trupave në hapësirë dhe në fund, marrëdhënia e njeriut me gjithë universin...

Marrëdhënia e bletës me lulen dhe mjaltin...

Marrëdhënia e tokës me lulen...

Marrëdhënia e shijes së frutave me diellin...

Marrëdhënia e peshkut me ujin...

Marrëdhënia e mjaltit me trurin...

Marrëdhënia e krahëve të zogut me qiellin...

Marrëdhënia e anijes me ujin...

Është e qartë se fuqia që frymëzon bletën, frymëzon njeriun, lulen dhe gjithçka tjetër. Është një fuqi që rregullon marrëdhëniet deri në detaje të krijesave.

Si mund të ekzistojë tërë ky sistem i përkryer?

A mund të ekzistojë pa një fuqi hyjnore?

Dhe nëse kjo fuqi është një realitet i pakontestueshëm, i pamohueshëm, a mundet njeriu të mos e shikojë këtë realitet?

Një njeri që vëren këtë të vërtetë, a mund të silltet në mënyrë të papërgjegjshme?

A nuk duhet të jetë i përgjegjshëm një njeri, që vëren këtë të vërtetë?

"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!" (Tekathur, 8.)

Syri është përgjegjës, veshi, gjuha, zemra, truri është përgjegjës. Një ditë do të përballesh me pyetjen: "Si i ke përdorur mirësitë? Nëse nuk përgjigjet gjuha, do të përgjigjet dora, këmba..."

Njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm, që ishte i Gjithëmëshirshmi, që tha "bëhu" dhe ajo u bë. Çdo mirësi që zotëron njeriu është si pasojë e mëshirës dhe bujarisë së Allahut.

Në një pikë spermë gjenden mesatarisht 300 milion spermatozoidë. Ndër këta, 300 milion spermatozoidë, vetëm njëri arrin të plotësojë vezën. Kodimi i gjithë informacionit gjenetik në ADN, i cili është një proces që nuk lë aspak hapësirë për rastësinë.

Çfarë do të ishte njeriu pa përkujdesjen e të Gjithëmëshirshmit dhe Mëshirëplotit...

A ka garanci njeriu, që pas një frymëmarrjeje do të ketë një tjetër? A është i sigurt njeriu se kjo rrahje zemre nuk do të jetë e fundit? A e di njeriu se çfarë ndodh, nëse këputet një damar në tru? A është në gjendje të njohë nënën, fëmijët, nëse i fshihet kujtesa?

Prof. Sarsëlmazi më tutje vazdon:

"Asgjë nuk duhet vlerësuar sipas madhësisë dhe vëllimit. Pa pankreasin, megjithëse një organ shumë i vogël, nuk mund të jetohej. Zemra, që peshon mesatarisht 300 gr pompon gjak pa pushim për gjithë trupin, truri, i cili përbën 3.5% të organizmit, drejton gjithë trupin, pa veshkat edhe pse shumë të vogla, jeta është e pamundur."

Vetëdijësimi për mirësitë e Allahut është sprova themelore e njeriut në këtë botë.

"O njeril ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd Bujar, i cili të krijoi, të përsosi dhe të dha formë harmonike, i cili të formësoi në formën, që Ai dëshiroi!" (Infitar, 6-8)

Përballë gjithë këtyre mirësive, njeriu më së paku nuk duhet të jetë mosmirënjohës.



Kurbani dhe Festa

All Riza Temel

Nga ana etimologjike, fjala *kurban* shpreh çdo lloj afriteti shpirtëror dhe fizik, kurse si term shpreh therjen e kafshëve të caktuara në kohë të caktuar, me qëllim arritjen e afërsisë dhe dashurisë së Allahut. Megjithëse kurban mund të quhet çdo gjë që të afron me Allahun, në terminologjinë fetare ky term përdoret kryesisht për ritin e flijimit. Edhe në Teurat termi *gorban* ka të njëjtin kuptim me fjalën kurban.

Kurbani është një rit që ekziston në të gjitha fetë. Në fetë pagane bëhet kurban për idhujt, kurse në fetë hyjnore për Zotin. Në shumë fe dhe kultura flijimi bëhet për të shpëtuar nga e keqja dhe për të arritur begati. Në periudhën paraislamike kurban realizohej për idhujt, të cilët spërkateshin më pas me gjakun e kurbanit, kurse mishi lihej mbi gurë për grabitqarët. Në dhjetëditëshin e parë të muajit Rexhep realizohej kurban në shenjë falënderimi dhe respekti ndaj idhujve. Kurbanin për hir të idhujve, Islami e konsideroi shirk dhe e ndaloi rreptësisht.

Nga një këndvështrim, kurban është dhuratë e besimtarit për Allahun. Kurbanët që bëhen në Haxh quhen *hedj*, që ka kuptimin dhuratë. Ky rit është tregues i adhurimit ndaj Allahut, sepse siç dihet, Allahu nuk ka nevojë për dhurata dhe rite. Namazi, zekati, agjërimi, haxhi, kurban, lëmosha etj., thjesht janë tregues të ibadetit ndaj Allahut. Të gjitha adhurimet janë në dobi të njerëzimit.

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por

arrin përkushtimi juaj.” (Haxh, 37.)

Përmes kurbanit besimtari tregon bindjen dhe adhurimin ndaj Allahut. Kurbani është ndarja e të mirave që ka dhënë Allahu me të tjerët. Në një kohë, kur egoizmi dhe pragmatizmi po mbyt njerëzimin, është shumë e rëndësishme ringjallja e adhurimeve dhe institucioneve që promovojnë solidaritetin, bamirësinë dhe dashurinë e ndërsjelltë, si zekati, sadakaja, kurban, dhurimi dhe vakëfi. Rigjallërimi i këtyre adhurimeve dhe institucioneve është njëkohësisht rigjallërimi i ndjenjave njerëzore.

Kurbani mban gjallë shpirtin e vëllazërisë, të solidaritetit, ndihmës reciproke dhe bashkimit të të gjithë shoqërisë madje të të gjithë njerëzimit. Kurbani siguron arritjen e drejtësisë sociale. Shembull tipik i kësaj është dërgimi dhe prerja e kurbanëve në vende të ndryshme të botës, kryesisht në vende të varfra të Afrikës, Azisë dhe Ballkanit. Kurbani nuk shpreh thjesht ofrimin e një sasive mishi për këta të varfër, ai në radhë të parë shpreh dashurinë dhe vëllazërinë për ata njerëz. Dhurata është e shtrenjtë për simbolikën që ka, jo për vlerën reale të saj. Normalisht që për të varfrit edhe dhurata është e rëndësishme. Kjo mund të jetë një ndihmë e konsiderueshme për njerëzit që nuk kanë mundësi të gjejnë bukë e ujë, jo më mish, por në të njëjtën kohë, kjo dhuratë ndihmon në ringjalljen e ndjenjave dhe vlerave njerëzore të vdekura. Zgjidhja më e mirë e grindjeve, mosmarrëveshjeve dhe armiqësive është miqësia, mëshira, dhe ndihma. Nëse nuk do të ishte zekati, sadakaja, kurban, vakëfi dhe të tjera institucione fetare, jeta do të ishte më e vështirë. Për ta bërë botën të jetueshme për të gjithë, duhet të



kultivohen ndjenjat e dashurisë, mëshirës, miqësisë dhe ndihmës reciproke. Njerëzimi nuk ka nevojë për armë vdekjeprurëse, por për përpjekje dhe organizime që japin jetë. Lumturia individuale nuk është e mjaftueshme. Nuk mund të konsiderohen njerëz ata që nuk ndjejnë në zemrat e tyre dhimbjet dhe vuajtjet e të tjerëve. Ata janë si kafshët grabitqare që e shqyejnë prenë e tyre. Njeriu duhet ta konsiderojë veten pjesëtar të familjes njerëzore dhe të ndjejë përgjegjësinë e tij ndaj pjesëtarëve të tjerë. Vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtohet një shoqëri e lumtur dhe e qetë.

Ne përmes kurbanit nuk afrohemi vetëm me Krijuesin, por edhe me krijesat e Tij. Distancat e largëta afrohen përmes miqësisë, kurse distancat e shkurtra bëhen të largëta me armiqësi. Ndihma është ngritja e urës së zemrës midis njerëzve. Edhe kurbanit është një urë, një urë dashurie dhe miqësie.

Kurbanit është simbol i sakrificës. Gjëja më e shtrenjtë e njeriut është jeta. Gatishmëria e Ibrahimit për ta bërë kurban për hir të Allahut birin e tij të dashur, Ismailin, që i ishte bërë dhuratë nga Zoti në moshë shumë të thyer dhe pranimit me kënaqësi nga ana e Ismailit është kulmi i sakrificës që mund të bëjë njeriu. Për njeriun edhe pasuria është shumë e shtrenjtë. Jeta normale e njeriut është e lidhur ngushtë me pasurinë. Ndarja e pasurisë, kaq e shtrenjtë për njeriun, është shenjë e lartë sakrificë. Në sakrificë të tilla bëhet i dukshëm adhurimi dhe njerzillëku.

Moskryerja e detyrave ndaj shoqërisë është largim prej Allahut dhe njerëzve. Në Islam mosdhënia e zekatit është e dënueshme, kurse mosbërja kurban nga ana e personave që kanë mundësi, është e qortueshme. Pejgamberi (a.s.), në lidhje me Kurbanin thotë: *"Kush nuk bën kurban duke pasur mundësi për të, le të mos na afrohet."* (Ibn Maxhe, Edahi, 2) Pra, kush nuk ndihmon dhe sakrifikon, nuk e meriton të jetë pjesë e shoqërisë, sepse shoqëria formohet nga individë që ndihmojnë, ndajnë dhimbjet dhe gëzimet me njëri-tjetrin. Shoqëria nuk është thjesht një turmë njerëzish, që zënë të njëjtën hapësirë. Që të jesh pjesëtar i shoqërisë, duhet përpjekje dhe sakrificë. Shoqëria kryen funksione dhe shërbime shumë të rëndësishme. Prandaj janë të domosdoshme bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjelltë.

Pejgamberi (a.s.), nuk e ka lënë asnjëherë kurbanin. Në fakt, për Pejgamberin (a.s.), kurbanit ka qenë obligim **"... andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!"**

(Keuther, 2.) Të qenët vaxhip ose sunet i kurbanit për ymetin, nuk ndikon në rëndësinë e tij. E rëndësishme është që Pejgamberi (a.s.), e ka bërë për vete dhe e ka këshilluar për ymetin. Pejgamberi (a.s.), në një hadith thotë: *"O njerëz! Është vaxhip prerja e kurbanit një herë në vit për familjen."* (Tirmidhi, Edahi, 18.)

Kurbanit nga ana tjetër, është festë dhe gëzim. Çdo gëzim ka një ose disa shkaqe. Festa në fund të Ramazanit është përjetimi i gëzimit pas një agjërimit njëmuor, ibadeti intensiv, pastrimi të mëkateve dhe fitimit të së drejtës për t'u bërë anëtar i Xhenetit. Siç e thekson hadithi, që fundi i Ramazanit është shpëtim prej Xhenemit.

Festimi i kurban bajramit është i lidhur më shumë me kryerjen e Haxhit dhe me gëzimin e rikthimit në atdhe pa mëkate, porsì një foshnjë e porsalindur. Haxhinjtë e përjetojnë gëzimin në Qabe, kurse ata që nuk kanë mundur të shkojnë, e përjetojnë gëzimin dhe atmosferën e haxhit në selitë e Qabes, të cilat janë xhamitë nëpër gjithë botën. Kjo festë, në një këndvështrim është përhapja dallgë-dallgë e gëzimit dhe haresh nga zemra e botës, Qabja, drejt gjithë pjesës tjetër të rruzullit. Në fakt, festa nuk mund të jetë individuale. Nuk mund të festojë një person që jeton i vetmuar në një ishull në një cep të botës. Festimi i përbashkët shndërrohet në liqen, në det. Ashtu si pikat e shiut kur bashkohen vërshojnë fuqishëm edhe grimcat e dashurisë, kur përqendrohen në një pikë krijojnë dritë të fuqishme dashurie dhe miqësie.

Festat janë koha ku shfaqet më gjallë se kurrë bashkimi, solidariteti, uniteti, vëllazëria, miqësia, konsultimi dhe bashkëpunimi. Festat janë momente të volitshme për të përmirësuar marrëdhëniet e prishura, për të forcuar lidhjet e dobësuar dhe krijuar lidhje dhe miqësi të reja.

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e të gjithëve në festë, për të treguar në këtë mënyrë unitetin, vëllazërinë, gjallërinë, forcën dhe bashkimin kombëtar. Festat janë raste të jashtëzakonshme për të kuruar shpirtin social. Prandaj festa e bajramit duhet të dalë përtej familjes, duke u shtrirë në të gjithë shoqërinë, në spitale, në burgje, në azile etj.

Festa e bajramit si urë që lidh zemrat, është rasti më i mirë për të fshirë armiqësitë, grindjet, mëritë dhe mosmarrëveshjet e ndryshme, duke ia lënë vendin dashurisë, respektit, vëllazërisë dhe bashkimit. Për ta përfunduar me një varg të poetit të famshëm Fuzuli:

"Njerëzit për ibadet bëjnë kurban një herë në vit.

Kurse unë jam gati në çdo moment të bëhem kurban për ty."



TEVHIDI

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Mbas periudhës iluministe, në shekullin e XX-të ndikimi i rrymave materialiste dhe pozitiviste hyri në jetën e përditshme si stil jetese dhe i ndihmuar nga mjetet e komunikimit modern u vetëshpall si modeli më i mirë për gjithë njerëzimin.

Sistemi filozofik i shekullit të kaluar, i cili e përkufizonte jetën vetëm si një interval kohor midis lindjes dhe vdekjes dhe që pretendonte se parajsja e premtuar mund të realizohej vetëm në këtë botë, injoronte çdo vlerë, çdo fe, çdo gjë të shenjtë, duke

i ofruar në këtë mënyrë egos një mjedis me liri të pakufizuar. Sipas kësaj filozofie, njeriu duhet të përjetojë çdo kënaqësi të kësaj bote, pa u penguar dhe kufizuar nga asgjë. Dhe e gjitha kjo në emër të lumturisë së njerëzimit, sepse sipas kësaj filozofie, rruga e lumturisë kalon përmes harbimit dhe shfrenimit të papërmbajtur. Shfrenimi, megjithëse mund t'i sigurojë individit një lumturi momentale, shoqërohet me pangopësi dhe lindjen e dëshirave të reja.

Krahas përhapjes së pozitivizmit dhe ateizmit,

njerëzimi është duke u përballur me probleme serioze fetare, përkundrejt përhapjes dhe ekspansionit të rrymave të shumta të devijuara, si: satanizmi, misionerizmi, budizmi, hinduizmi, jehovaizmi etj. Përpjekjet për të krijuar ndarje dhe dallime duke përdorur ideologji dhe sekte të ndryshme fetare, janë shndërruar sot në një problem madhor. Por krahas këtyre përpjekjeve për të devijuar njerëzit nga feja, është fakt edhe një rikthim i njeriut te feja dhe jeta fetare. Është për t'u gëzuar nga fenomeni i ringjalljes së jetës fetare dhe rikthimit të vështrimit nga feja.

BOSHTI I ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE BASHKËKOHORE

Sekreti i zgjidhjes së problemeve bashkëkohore qëndron në përvetësimin e një disipline shpirtërore. Mënyra më e sigurt për të shpëtuar njerëzit nga sektet e devijuara, është pajisja me dituri dhe ndjenja fetare të sakta dhe krijimi i kushteve optimale për zbatueshmërinë e tyre në jetë, sepse jeta fetare nuk mund të ekzistojë vetëm me interesimin dhe dashurinë për të. Por në rrugën e jetës fetare më tepër se mësimi teorik, është i rëndësishëm zbatimi dhe praktika e mësimave fetare. Pra, feja është e bazuar në binomin besim-veprim. Besimi i ushqyer dhe i forcuar me vepra të mira është një udhërrëfyes shumë më i sigurt për jetën në këtë botë dhe botën tjetër. Qëllimi kryesor i njerëzve që jetojnë në vorbullën e modernizmit, duhet të jetë zgjidhja e problemit fetar dhe kthimi me dashuri te Krijuesi i gjithësisë.

Ajo që e mban të gjallë, i jep gjallëri, i jep shpirt njeriut në kuptimin e vërtetë është feja. Njeriu që mbështet dhe strehohet në besimin tek Allahu i Përhershëm dhe i Gjallë, gjen jetë dhe gjallëri. Zemra e njeriut ndriçohet përmes shpalljes hyjnore dhe mbahet e gjallë me frymën e Kuranit. Personi që ka gjetur Kuranin dhe Pejgamberin, është plot gjallëri dhe energji. Kurse kush jeton larg kësaj strehe, zhytet në krizë besimi dhe me kalimin e kohës vdes shpirtërisht.

Një besim i shëndoshë i siguron njeriut një mburojë të fortë kundër ndikimeve të jashtme. Imani ndriçon zemrën si një pishtar. Por kjo dritë është gjithmonë nën sulmet e faktorëve të jashtëm, që përpiqen ta zbehin apo ta shuajnë plotësisht atë. Mbrojtja nga kjo, sigurohet duke e lidhur zemrën me Allahun, duke u dhënë gjallëri parimeve fetare dhe duke besuar fort në botën tjetër.

Besimi në botën e amëshuar rrit kuptimin dhe vlerën e jetës. Një person që jeton me vetëdijen e ringjalljes dhe gjykimit pas vdekjes, sigurisht që do të bëjë një jetë më të kujdesshme dhe të rregullt. Një person që është i vetëdijsëm se pas vdekjes do të pyetet për Zotin, Librin, Pejgamberin, Fenë dhe për çdo vepër të mirë apo të keqe, sigurisht që do të përpiqet ta mbushë librin e tij me vepra të mira dhe të dobishme.

Nevoja për besim është e lindur tek njeriu. Krijuesi ka vendosur në natyrën e njeriut tevhidin. Ajeti Kur'anor: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Rrum, 30.), shpreh pikërisht këtë realitet. Prandaj njerëzit historikisht kanë jetuar të lidhur pas një besimi apo një ideologjie.

Qëllimi i parë dhe kryesor i feve hyjnore dhe pejgamberëve ka qenë pastrimi shpirtëror i njerëzve, rafinimi i zemrave nga veset e këqija dhe të dëmshme. Pastrimi i zemrës fillon me largimin e çdo besimi dhe ideologjie, që bie ndesh me Tevhidin. Misioni kryesor i pejgamberëve të përmendur në Kuran, ka qenë shpëtimi i njerëzimit nga politezimi dhe ndërtimi i një shoqërie mbi baza të shëndosha besimi. Pejgamberi (a.s.), gjithë periudhën e Mekës e kaloi duke luftuar për Tevhidin.

Tevhidi përmirëson zemrën dhe gjendjen shpirtërore të njeriut, sepse përtej një sistemi mendimi dhe besimi, Tevhidi është një stil dhe model jetese. Niveli i parë i Tevhidit është njësimi i plotë i Zotit. Tevhidi është njësimi i plotë i Allahut në besim, në adhurim dhe pastrimi i plotë i botës shpirtërore nga çdo gjë që ndot Tevhidin.

Një person që beson në Tevhidin e pastër, arrin grada të larta shpirtërore. Në këtë mënyrë, çdo veprim i tij është i mbështjellë nga sinqeriteti dhe bindja e plotë ndaj Allahut. Në këtë mënyrë, Allahu, Krijuesi i gjithësisë bëhet syri i besimtarit me të cilin ai shikon.

Personi i vetëdijsëm për Tevhidin, të vetmin qëllim dhe synim ka Allahun dhe askënd tjetër. Personi që ka vendosur në zemër Tevhidin, shpëton përfundimisht nga kurthet e egos. E gjithë kjo bëhet e mundur, jo vetëm duke e realizuar Tevhidin në besim dhe ibadet, por duke e shtrirë atë në çdo fushë dhe aspekt të jetës.

TË PAPRITURAT E DITËS SË GJYKIMIT

Sedat Islami

Jo çdoherë njeriu i gëzohet fundit të gjërave. Edhe pse ndonjëherë planifikon dhe pret rezultatet pozitive, ai tronditet kur mëson se gjërat nuk kanë shkuar siç ka menduar. Është një ndjenjë e keqe, e cila nganjëherë ka edhe përfundim tragjik. Ka prituri të korrë rezultate në provime, por ka dështuar; ka shpresuar në sukses të biznesit, por ka humbur; ka ëndërruar pasuri, por ka përfunduar i varfër...

Kjo "befasi" me atë që nuk e ke menduar fare, e përcjell njeriun edhe në botën tjetër. Edhe atje njeriu do të ngelë i habitur kur të dalë para Allahut, ndërsa, edhe pse është falur dhe ka agjëruar, edhe pse ka dhënë Zekatin dhe ka kryer Haxhin, veprat e tij nuk do të pranohen. Allahu i Madhëruar thotë :

"...E prej Allahut do t'u prezantohet (lloji i dënimit), **çka as nuk kanë mundur ta mendojnë"**. (Zumer, 42.)

Disa nga gjeneratat e para të myslimanëve kanë thënë: "Sa herë do të dëshpërohet njeriu në Ditën e Llogarisë, ndërsa nuk e ka menduar fare!"

Përse nuk do të dalin në botën tjetër parashikimet e njeriut?

Për ç'shkak njeriu nuk do të shpërblehet ndonëse është falur, ka agjëruar, ka dhënë Zekatin dhe ka kryer Haxhin?

Ku qëndron problemi?

MANGËSITË NË SINQERITET

Shkaku pse njeriu pëson këtë të papritur të hidhur, në radhë të parë, siç kanë përmendur shumë komentues në shpjegimin e ajetit që cituam më parë, ka të bëjë me mungesën e sinqeritetit. Veprat e njeriut që nuk ka punuar për të arritur kënaqësinë e Allahut, por atë të njerëzve do të jenë të papranuara. Këtë njeri dijetarët e kanë përngjasuar me një njeri që kalon nëpër treg me një thes plot me gurë. Njerëzit mendojnë se ka gjësënd me vlerë, por ai ka vetëm gurë, me të cilët nuk mund të blejë asgjë. Për këtë shkak, Sufjan Theuriu thoshte: "Mjerë për hipokritët! Mjerë për hipokritët! Ky është ajeti i tyre dhe kjo është historia e tyre."

Allahu i Madhëruar ka shpjeguar në Kuranin Famë-lartë se veprat e këtyre njerëzve janë të asgjësuar në botën tjetër.

"Dhe Ne do t'u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t'i shndërrojmë në pluhur e hi." (Furkan, 23.)

Njerëzit që nuk ia kanë frikën Allahut, por iu fshihen vetëm syve të njerëzve, janë ata, që ndonëse mund të kenë vepra të mira, ato do t'u bëhen hi e pluhur. Ibni Maxheh (*Allahu e mëshiroftë!*), transmeton se Theubani (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), se Muhamedi (*sal-lAllahu alejhis ves sel-lem*), ka thënë:

"Unë do t'i njoh disa njerëz nga umeti im, që do të

vijnë Ditën e Kiametit me të mira të shumta si kodrat e bardha të Tihames, por të cilat Allahu i Madhëruar do t'i shndërrojë në hi e pluhur!" Theubani tha: "O i Dërguari i Allahut, na i përshekruaj ata, që të mos jemi prej tyre nga padija!" "Atëherë, ata -tha i Dërguari i Allahut- janë vëllezërit tuaj nga lëkura (lloji, raca) juaj, ata falen gjatë natës siç faleni dhe ju, por kur vetmohen, shkelin ndalesat e Allahut!" (Albani e vlerëson hadithin si autentik.)

GAFLETI APO PAKUJDESIA

Njeriu ndonjëherë tregohet aq i shkujdesur, sa harron edhe vdekjen. Ai vazhdon me mëkatet e tij, vazhdon me kryeneçësinë, vazhdon me injorimin e së vërtetës deri në momentet e fundit, kur i kupton të gjitha, por që është tepër vonë. Allahu në suren Kaf na rrëfen se vdekja sjell të vërtetën, të cilën njeriu e ka anashkaluar dhe i ka ikur gjatë tërë jetës.

(Mohuesit do t'i thuhet): **"Ti ke qenë i pavëmendshëm për këtë. Tashti ta kemi ngritur perden (e syve), dhe shikimi yt sot është i mprehtë."** (Kaf, 22.)

Perdja u hoq dhe ai mësoi atë që nuk e kishte llogaritur kurrë se mund t'i ndodhte. Ja si na e përshekruan këtë Allahu i Madhëruar:

"Sikur keqbërësit të kishin çdo gjë që gjendet në Tokë, dhe po kaq më tepër, të gjitha këto do t'i flijonin (për të shpëtuar) prej dënimit të ashpër në Ditën e Kiametit. Atëherë, do të përballen me atë që nuk e kanë llogaritur, do t'u shfaqen atyre të këqijat që kanë bërë dhe do t'i kaplojë ajo të cilën e përqeshnin." (Zumer, 47-48)

MENDOJNË SE JANË VEPRA TË MIRA, POR JANË TË KËQJIA

Arsyeja se pse njerëzit mund ta pësojnë keq dhe të ballafaqohen me këto të papritura të hidhura është edhe gabimi i tyre në perceptimin e së mirës. Ata ndonjëherë bëjnë keq, ndërsa deklarohen sikur bëjnë mirë. Ose, sikur ajo që bëjnë nuk është mëkat. Fudaj!

Ibn Ijjadi në koment të ajetit bazë ka thënë: "Ata kanë bërë vepra për të cilat kanë menduar se janë të mira, por kanë dalë që ato të jenë të këqija. Ata do të ndihen shumë keq kur të mësojnë për fatin e veprave të tyre. Këta janë humbësit më të mëdhenj!" Allahu i Lartmadhëruar në Librin e Tij ka thënë:

Thuaj: "A doni t'ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, për-pjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?" (Kehf, 103-104)

ATA QË SHPIKIN NË FE

Nga ata që dijetarët kanë nënvizuar si njerëz që do të përjetojnë tmerrin e asaj që nuk e kanë imagjinuar fare janë dhe shpikësit e traditave fetare të pabaza. Imam Gazaliu në Ihjau Ulumiddin shpjegon se si atyre, që besojnë forma të gabuara në besim dhe aplikojnë po kështu forma të gabuara në adhurim, ende pa u larguar nga kjo botë, respektivisht në momentet e vdekjes, u bëhet e qartë kotësia e veprimeve të tyre. Për këtë shkak, ata edhe përjetojnë llahtarinë e këtij ballafaqimi me atë që e kanë kujtuar si të mirë. (Shih: 4/175.)

E keqja në rastin e këtyre bidatçinjve është se ata, duke qenë se e mendojnë si të qëlluar atë vepër, nuk pendohen kurrë për gabimet e tyre. Ky është shpjegimi i thënies se "Për bidatçiun nuk ka pendim!", pra për shkak se atij nuk i shkon ndërmend të pendohet, ngase e sheh rrugën e tij të drejtë dhe të duhur.

MËKATET I MARRIN PËR TË VOGLA

Shkak tjetër pse ndodh kjo befasi e hidhur është nënvlerësimi i rrezikut të mëkateve. Disa gjëra janë të mëdha, ndërsa ne nuk i marrim për të tilla. Alkooli është shumë i dëmshëm për shëndetin, por qindra litra alkool nuk mund të kenë ndikim sa ka një pikë helm. Enes Ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, ka thënë: "Ju po bëni disa gjëra që për ju janë më të imëta se qimja e flokut (pavlera) ndërsa ne, në kohën

e të Dërguarit të Allahut, i merrnim për shkatërruese." (Transmeton Buhariu në Sahihun e tij.) "Ne sot përgojtmë njerëzit, ndërsa bëjmë sikur nuk kemi bërë mëkatë fare." Buhariu dhe Muslimi, *Allahu i mëshiroftë*, transmetojnë se Muhamedi, *salallahu alejhis ve sellem*, ka thënë:

"...dhe njeriu nga pakujdesia do ta flasë një fjalë nga ato që e hidhërojnë Allahun, ndërsa do të futet thellë në Xhehenem."

MËKATET E SHUMTA OSE SHLYERËS TË SHPËRBLIMEVE

Ashtu sikur të mirat që shlyejnë të këqijat, po kështu, edhe të këqijat shlyejnë të mirat ose pamundësojnë përfitimin prej shpërblimit të të mirave. Kjo është kur mëkatet të jenë më shumë se të mirat apo të jenë prej atij lloji që zhvleftëson të mirat. Muhamedi, *salallahu alejhis ve sellem*, siç përmendëm edhe më lart, ka thënë:

"Unë do t'i njoh disa njerëz nga ummeti im, që do të vijnë Ditën e Kiametit me të mira të shumta si kodrat e bardha të Tihames, por të cilat Allahu i Madhëruar do t'i shndërrojë në hi e pluhur!" Theubani ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, na i përshkruaj ata, që të mos jemi prej tyre nga padija!" "Atëherë, ata -tha i Dërguari i Allahut- janë vëllezërit tuaj, nga lëkura (lloji, raca) juaj, ata falen gjatë natës siç faleni dhe ju, por kur vetmohen, shkelin ndalesat e Allahut!" (Albani e vlerëson hadithin si autentik.)

Kjo ndonjëherë ndodh kur, pas së mirës pason e keqja. Allahu na ka ndaluar nga një traditë e tillë. P.sh., përkitazi me lëmshën ka thënë:

"O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer..." (Bekare, 264.)

Pra, i ka dhënë lëmshë, por në anën tjetër ia ka përmendur atë duke e vënë në siklet. Këto gjëra bëjnë që njeriu të mos ketë shpërblim fare për veprën e tij. E dini që një grua ka hyrë në Xhehenem për shkak të gjuhës së saj, edhe pse është falur dhe ka agjëruar?

PADREJTËSITË DHE RREZIKU I TYRE

Njeriu mund të befasohet për të keq në botën tjetër, edhe pse ka vepra të mira, nëse ai sillet padrejtësisht ndaj njerëzve. Muhamedi, *salallahu alejhi ve sellem*,

ka thënë:

"A e dini kush është i falimentuari?" Thanë: "I falimentuar mes nesh është ai i cili nuk ka asnjë dërrhem e asnjë plaçkë." Ai tha: "I falimentuari prej umetit tim është ai që vjen Ditën e Kiametit me namaz, agjërime, zekat, por ka sharë dikë, ka shpifur për dikë tjetër, ka ngrënë pasurinë e dikujt tjetër, ka derdhur gjakun e këtij apo ka qëlluar atë tjetrin. Atyre u jepen nga të mirat e këtij, derisa kur mbarojnë të mirat e tij para se atyre t'u jepet e drejta, merren nga të këqijat e tyre dhe i hidhen atij e pastaj ai hidhet në zjarr." (Transmeton Muslimi.)

SHPRESA E RREME

Thirrja në mëshirën e Allahut dhe mashtrimi me shpresën se mund të më falë Zoti, ndonjëherë mund të jenë shkak i hidhërimit të Allahut e kështu, kur të dalë njeriu para Tij, të befasohet për atë që nuk e ka pritur fare. Fjala është gjithnjë për ata që shpresën e marrin pretekst për të vazhduar në mëkatë. Hasan Basriu ka thënë:

"Një grup njerëzish janë ngazëllyer (mashtruar) nga shpresat e faljes, aq sa dolën nga kjo botë, pa asnjë të mirë. Ata thanë: 'Ne kemi mendime të mira për Zotin, por, gënjen, ngase po të kishin mendime të mira, edhe do të punonin mirë.'"

Tek Allahu i drejti dhe i padrejti nuk janë të njëjtë. Besimtari i devotshëm dhe mëkatari nuk janë njësoj. Allahu (xh.sh.) në Kuran

thotë:

"A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se Ne do t'i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të jetë e njëjtë? Sa keq që gjykojnë ata!" (Xhathije, 21.)

Për këto dhe gjëra të tjera njeriu do të befasohet për të keq, kur të gjejë tek Allahu atë që nuk e ka kujtuar fare dhe as që e ka pritur. Andaj, të nxitojmë që më parë të përmirësojmë veten tonë, të kërkojmë hallallin nga njerëzit, nëse u bëjmë keq, të rishikojmë veprat që kemi bërë në janë në përputhje me traditën profetike, si dhe ta lusim Allahun e Madhëruar për falje. Të bëjmë mirë, të angazhohemi me vepra të mira dhe ta lusim Allahun e Madhëruar që fundi i jetës sonë të jetë ashtu si Ai dëshiron!

Na ishte njëherë

Sallh Zeki Meriç

Njeriu është një udhëtar në këtë botë. Është një udhëtar që ndalon për të pushuar disa momente nën hijen e një peme, pastaj vazhdon udhëtimin. Është në dorën tonë se si do ta mbushim hapësirën midis ardhjes dhe vajtjes. Siç thotë poeti, erdhëm nga nëna në pazar, blemë një qefin dhe u kthyem në varr. Jeta jonë është si fletët e një kalendari, që këputen çdo ditë. Me kalimin e kohës, çdo gjë vyshket, plaket dhe vdes. Vjeshta na jep një panoramë shumë interesante të kësaj gjendjeje, ku gjethet zverdhen dhe malet marrin një ngjyrë të trishtueshme. Ato lugina dhe male, që deri dje ishin plot lule, gjelbërim dhe jetë, sot janë zhytur në një heshtje të thellë, sikur po përgatiten për një pritje të gjatë në Berzah (jeta e varrit). Ky është një afrim drejt finishit.

Lindja, jeta dhe vdekja, këto janë tre stadet ku kalon çdo gjallesë. Ajo që e dallon njeriun nga gjallesat e tjera, është aftësia për të mirëadministruar këtë aventurë.

Njeriu nuk është krijuar pa ndonjë qëllim. Ai jeton në një botë, ku sprovat e ndjekin njëra pas tjetrës dhe pas çdo sprove qëndron humbja ose fitimi.

Një ditë do të mbarojë gjithçka në këtë botë dhe do të fillojë një jetë e vërtetë dhe e përhershme. Atje do të japim llogari për çdo gjë të jetuar këtu.

Do të japim llogari për mënyrën e jetesës, për kohën, për pasurinë dhe çdo gjë që ka lidhje me këtë botë.

Sa bukur e përshkruan jetën e përkohshme ky tregim mbrësëlënës!

Një shitës, që e kishte dyqanin në dalje të qytetit, për çdo xhenaze të dalë nga porta e qytetit hidhte një bërthamë në një shishe dhe në fund të muajit numëronte bërthamat në shishe. Pas numërimit, thoshte me vete:

- Këtë muaj ranë kaç njerëz në shishe!

Një ditë vdiq edhe vetë. Një mik, i cili nuk dinte gjë për vdekjen, erdhi për ta takuar në dyqan, por pasi nuk e gjeti, pyeti fqinjët:

- Ku është shitësi i këtij dyqani?

I thanë:

-Edhe ai ra në shishe.

Sigurisht që edhe ne do të biem një ditë në shishe. Madje do të vijë një ditë, ku nuk do të jemi as ne, as shishja. Por do të mbeten pas nesh vetëm veprat dhe qëllimet e mira.

Gjithë çështja qëndron në përgatitjen tonë për udhëtim dhe marrjen me vete të gjërave të domosdoshme për udhëtim.

Allahu përshkruan në Suren Al'Imran fytyrat e bardha dhe të nxira:

"Ditën (e Kiametit), kur disa fytyra do të zbardhen e disa të tjera do të nxihen. Atyre që do t'u nxihet fytyra, do t'u thuhet: 'Vallë, ju mohuat pas besimit? Atëherë shijoni dënimin, për shkak se nuk besuat! Kurse ato fytyra që do të zbardhen e do të shkëlqejnë, do të jenë në mëshirën e Allahut (në Xhenet), ku do të qëndrojnë përgjithmonë." (Ali Imran, 106.)

Fytyra e bardhë,

Libri i bardhë,

Zemra e bardhë,

E shkuara e bardhë,

Për të kaluar faqebardhë në jetën e përtejme, duhet të jemi të vetëdijshëm për natyrën e përkohshme të kësaj bote dhe, sipas kësaj, duhet të punojmë dhe të sillemi në këtë botë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojmë që ne jemi thjesht udhëtarë në këtë botë dhe ky udhëtim herët a vonë do të mbarojë.



KURANI

LAJMI TRONDITËS

Abdullah Draz

Kurani, për vetë rëndësinë e madhe që ka, duke qenë jo vetëm libër hyjnor, por edhe gur themeli mbi të cilin është ndërtuar qytetërimi, kultura dhe shoqëria islame, është bërë objekt studimi për shumë shkencëtarë, myslimanë dhe jomyslimanë. Shumë orientalistë janë përpjekur të hedhin dyshime mbi autorësinë e Tij hyjnore, duke ia mveshur atë Muhamedit (a.s.). Mbi mrekullitë shkencore të Kuranit, që vërtetojnë burimin e Tij hyjnor, janë shkruar shumë libra. Por ne këtu do të përqipemi të trajtojmë karakterin hyjnor dhe pamundësinë e Muhamedit

(a.s.), për të qenë autor i Kuranit në një këndvështrim ndryshe.

Për myslimanët, Kurani është fjalë e Allahut, si nga përmbajtja edhe nga forma. Ai nuk mund të jetë kurrë një vepër njerëzore. Kurani është një kryevepër letrare dhe estetike. Për nga këshillat, parimet morale, juridike dhe shoqërore që përmban, është një vepër madhështore. Ai po ashtu është një thesar dhe burim i pashtershëm. Për nga informacionet metafizike që jep, është një mrekulli më vete. Një mendimtari ose shkrimtari i mjafton të ketë autorësinë e vetëm një pjese të vogël të këtij libri, për t'u bërë i pavdekshëm në historinë e njerëzimit. Megjithatë, Pejgamberi (a.s.), nuk pretendon autorësinë e këtij libri, të cilin do ta dëshironte çdo shkrimtar. Ai jo vetëm që nuk e pretendon, por me zë të lartë predikon autorësinë e Tij hyjnore. Përballë refuzimit të autorësisë së këtij thesari, kur të tjerët do të sakrifikonin gjithçka për ta pasur, nuk mbetet gjë tjetër përveçse të pranohet siç është.



Është për t'u habitur nga disa që kërkojnë argumente për të pranuar autorësinë hyjnore të këtij libri.

Një mendje djallëzore mund të thotë: Muhamedi (a.s.), ia ka atribuar autorësinë, Allahut për të fituar prestigj dhe autoritet. Por përse i përket lidhjes dhe besimit të fortë të tij tek

Allahu, e gjithë jeta e Tij është dëshmi për këtë. Po ashtu, të gjithë janë të një zëri, qofshin miq apo armiq të tij, përse i përket besnikërisë dhe sinqeritetit të tij. Një njeri që thotë vetëm të vërtetën për njerëzit, nuk mund të mendohet se do të gënjejë për Allahun. Historia e Muhamedit (a.s.), na jep një profil të qartë të sinqeritetit dhe besnikërisë së tij. Në një rast kur një grup vajzash të vogla po thurnin vargje lëvduese për dëshmorët e luftës së Bedrit, një vajzë ndër të tjera thuri një varg të tillë: "Në mesin tonë ndodhet një Pejgamber që di të ardhmen." Pejgamberi (a.s.), sapo e dëgjo, ndërhyri duke e korrigjuar dhe e ndaloi të thoshte një gjë të tillë. Kurse në një rast tjetër, kur vdiq Osman ibn Maz, një grua tha: "Unë jam dëshmitare që Allahu të ka shpërblyer dhe vendosur në një pozitë të lartë." Pejgamberi (a.s.), i tha: "Ku e di ti se Allahu e ka shpërblyer atë, unë jam i dërguari i Allahut dhe nuk e di përfundimin tim..." Kjo sjellje e tij është paralel me ajetin Kuranor: **Thuaju: "Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta."** (Ahkaf, 9) Të mendojmë për një moment se Pejgamberi (a.s.), nuk gënjente, sepse kishte frikë se mbas një kohe mund t'i dilte gënjeshtër në shesh. Atëherë, çfarë e pengonte të gënjente për çështje metafizike, ku mundësia për t'u zbuluar gënjeshtër nuk ekziston, përveç frikës nga Gjykatësi Suprem.

Vetë Muhamedi (a.s.), ka konfirmuar se fjalët e Tij për nga vlera juridike janë të barasvlefshme me dispozitat kuranore.

Prandaj, për të përcaktuar ndalesën apo lejimin e diçkaje

nuk është kusht konfirmimi kuranor. Mjafton gjykimi i hadithit për të përcaktuar dispozitën juridike të saj dhe vlefshmëria e kësaj dispozite është e njëjtë me një dispozitë të përcaktuar qartë nga Kurani. Megjithatë,

Ai bënte një ndarje të qartë midis hadithit dhe Kuranit. Madje, për një kohë relativisht të gjatë, nga frika e përzjerjes me njëri-tjetrin, e pati ndaluar shkrimin e haditheve. Nga ana tjetër, një njeri që ka sadopak shije letrare e kupton shumë lehtë dallimin midis stilit kuranor dhe hadithit sepse kanë stile qartësisht të dallueshme midis tyre. Një kritik letrar, duke lexuar hadithet dhe jetën e Pejgamberit, mund të nxjerrë një profil të qartë në lidhje me mendimet, idetë, ndjenjat dhe botën shpirtërore të tij, gjë që nuk ndodh me Kuranin.

Autori i Kuranit nuk mund të gjendet as midis politeistëve, të krishterëve apo hebrejve. Sepse Kurani, megjithëse përfshin histori dhe ngjarje nga Bibla dhe Teurati, ai flet për detaje që nuk gjenden në to dhe herëherë bën korrigjimet e duhura. Një nxënës, që mëson dy gjëra nga një mësues, nuk mund të marrë guximin të sfidojë mësuesin. Është e pamundur për një person analfabet të japë informacione të tilla të detajuara historike. Detajet historike hasen edhe në numra, si në ajetin:

"Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore)." (Kehf, 25.)

Nuk thotë 309 vjet, por treqind plus nëntë për të shprehur ndryshimin midis kalendarit diellor dhe hënor. Kjo është një matematikë shumë e hollë për një analfabet. Nëse të dhënat historike do të ishin produkte të intelektit të tij, patjetër që me kalimin e kohës do të përballej me gabime. Mendjes së shëndoshë i ka hije të pranojë revelatën hyjnore të Kuranit.

Kurani flet për fitoren dhe triumfin e myslimanëve qysh në periudhën e Mekës. Si mund të marrë guximin një njeri të pretendojë një gjë të tillë në ato kushte që ishin myslimanët, ku ishte në dyshim ekzistenca, jo më të bëhej fjalë për fitore dhe sundim mbi tokë. Si mundet një njeri të jetë kaq i sigurt për fitoren përveçse me ndihmën e një informacioni qiellor? Kush do ta siguronte atë pas vdekjes se feja e tij nuk do të zhdukej?

"Në të vërtetë, jobsimtarët e shpenzojnë pasurinën e tyre për t'i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta



shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.” (Enfal, 36.)

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Saff, 9.)

Përveç disfatës së mushrikëve, Allahu flet edhe për përplasjet e myslimanëve me hebrejtë. **“Kudo që gjeندن, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t'i kaplojë mjerimi.”** (Al 'Imran, 111.)

Historia është dëshmitare e poshtërimit të hebrejve dhe pamundësisë për të jetuar dhe siguruar ekzistencën e një shteti normal vetëm kur kanë qenë nën mbrojtjen e myslimanëve dhe kur janë mbështetur nga ndonjë fuqi tjetër botërore. Vetëm në këtë mënyrë kanë arritur ta sigurojnë ekzistencën e vet. Si mundet një njeri të japë informata kaq të përpikta dhe të sakta për të ardhmen dhe të kaluarën. Vetëm Krijuesi i gjithësisë mund të japë një verdikt kaq të prerë për një popull të tërë.

Ku e gjente sigurinë se nuk do të vdiste pa e përmbyshur misionin? Kjo është një siguri që nuk mund ta pretendojnë as njerëzit më të fuqishëm të botës, sepse vdekja mund t'i vijë në çdo moment njeriut. Një siguri të tillë mund ta japë vetëm Ai që jep dhe merr jetën. **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përçjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67.)

Kur besimtarët emigruan në Medine, menduan se gjetën qetësinë, mirëpo atje u përballën me luftë, armiqësi dhe rrezik për shfarosje. Në një gjendje të tillë frike dhe pasigurie, ku myslimanët flinin me armë te koka dhe bënin roje me turne për t'u ruajtur nga sulmet, Kurani i lajmëronte për sundim planetar. **“Allahu u ka premtuar atyre që besuan prej jush dhe bëjnë vepra të mira se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç kanë bërë ata para tyre dhe do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërrtojë në siguri.”** (Nur, 55.)

Përmes këtij ajeti, Allahu u premtonte besimtarëve brenda një kohe të shkurtër sundim botëror. Ky sundim nuk u premtohet vetëm besimtarëve të pranishëm në atë kohë, por të gjithë besimtarëve që do të bëjnë vepra të mira.

Një tjetër anë që tregon burimin hyjnor të Kuranit është mungesa e diturisë dhe informacionit të Pejgamberit (a.s.), në lidhje me disa detaje, përfundime dhe kuptimin e ajeteve. Nëse Kurani do të ishte vepër e Tij, është e pashpjegueshme thurja e vargjeve pa u ditur kuptimin. Për më tepër, kur kjo gjendje i trondiste atij

autoritetin dhe shpesh e vendoste në një pozitë shumë qesharake. Një person nuk mund t'i urdhërojë as vetes e as të tjerëve urdhëresa që nuk ua di kuptimin dhe urtësinë. Kjo tregon që Ai ishte thjesht një transmetues i mesazhit.

Në vitin e gjashtë të hixhretit Pejgamberi (a.s.), së bashku me 1500 sahabë niset nga Medina për në Mekë, për të vizituar vendin e shenjtë, Qaben, sepse kishin vite që nuk e vizitonin dot për shkak të idhujtarëve kurejshë. Nga ana tjetër, myslimanët ishin fuqizuar shumë gjatë kësaj kohe, kurse kurejshët ishin dobësuar nga ana ekonomike dhe ushtarake. Nëse do të donte Pejgamberi (a.s.), mund ta merrte me forcë Mekën që atëherë, por nuk e bëri një gjë të tillë, sepse qëllimi ishte vetëm vizita. Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije, deveja e tij ndaloi së ecuri. Me gjithë përpjekjet, nuk e bënë dot të ecte. Përballë kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: **“E ndaloi Ai, i Cili ndaloi edhe elefantin”.** Kjo nënkuptonte që Allahu, ashtu si nuk lejoi Ebrehenë të pushtonte Qaben me luftë, nuk do të lejonte as myslimanët të merrnin Mekën me luftë. Pejgamberi (a.s.), pa e kuptuar urtësinë iu bind shenjës hyjnore dhe fushoi në Hudejbije, duke e ndaluar kështu përparimin drejt Mekës. Kërkesës së myslimanëve për të vizituar Qaben kurejshët iu përgjigjën negativisht, megjithëse myslimanët ishin të veshur me ihram dhe kishin marrë me vete kafshët për kurban. Pra ishin përgatitur me gjithë zemër për të vizituar Qaben. Megjithëse nuk kishte forcë që mund t'i ndalonte të hynin në Mekë, kurejshët vendosën kushte shumë të rënda për myslimanët. Pejgamberi (a.s.), e pranoi marrëveshjen me gjithë kushtet e rënda që përmbante. Ngaqë nuk mundën të vizitonin Qaben, Pejgamberi (a.s.), i urdhëroi të dilnin nga Ihrami dhe të bënin kurbanet aty ku ishin. Me gjithë bindjen absolute ndaj Pejgamberit, sahabët hezituan në zbatimin e urdhrit të Tij. Omeri (r.a.), si përfaqësues i grupit të pakënaqur me kushtet e marrëveshjes, i thotë Pejgamberit (a.s.): **“Përse po e nënçmojmë kështu fenë tonë?”** Pejgamberi (a.s.), megjithë rrezikun për t'u përballur me kundërshtimin e të gjithë sahabëve, i përgjigjet: **“Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk mund t'i dal kundër Atij, Ai është ndihmësi im.”** Me këtë donte të thoshte se edhe ai ishte një njeri si ata dhe marrja e këtij vendimi nuk ishte në kompetencën e Tij. Si përfundim, Pejgamberi (a.s.), së bashku me sahabët u kthyen mbrapsht pa e kuptuar urtësinë e kësaj marrëveshjeje, në pamje të parë krejtësisht në disfavor të myslimanëve. Urtësia e kësaj marrëveshjeje mbeti enigmë, deri sa Allahu e zbuloi në suren Fet'h. Kur u realizuan sihariqet e Kuranit, e kuptuan që marrëveshja, në dukje kundër tyre, kishte qenë një fitore e madhe për ta. Çfarë vlere kanë masat që merr njeriu përballë masave që merr kaderi? Dijetari i famshëm Zuhri bën një evidentim shumë interesant në lidhje me marrëveshjen e Hudejbijes: **“Asnjë fitore përpara Hudejbijese nuk ka qenë më e madhe**

se ajo, sepse më parë, sapo myslimanët përballeshin me idhujtarët, fillonte grindja dhe luftimi. Por me nënshkrimin e marrëveshjes, gjendja u qetësua, gjakrat u ulën, kjo sollti reflektimin e palës kundërshtare dhe gjatë kësaj kohe u kthyen në myslimanë, armiq të përbetuar të Islamit, si: Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi e shumë figura të tjera të shquara të kurejshëve. Numri i njerëzve që pranuan Islamin gjatë kësaj periudhe, e kaloi numrin e myslimanëve të konvertuar gjatë 19 të viteve të kaluara.”

Një nga kushtet e marrëveshjes ishte që myslimanët të vizitonin Qaben vitin tjetër dhe përveç shpatës që mbahet vazhdimisht me vete të mos merrnin asnjë armë tjetër. Si mund t’u besonin myslimanët kurejshëve, kur ata ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të vrarë Pejgamberin (a.s.)? Si mund të ishin të sigurt se ata nuk dëshironin shfarosjen e të gjithëve? Mirëpo Allahu u siguroi atyre kryerjen e rritit dhe kthimin e sigurt. **“Allahu e vërtetoi saktësinë e ëndrrës së të Dërguarit të Tij, Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”** (Fet’h, 27.)

Shpallja shpesh vinte në kundërshtim me mendimin e Tij për një çështje të caktuar, madje në disa raste kishte ngjyra të forta kritike.

“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.” (Teube, 113)

Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kushton vëmendje, megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet. Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndjen frikë (nga Allahu), ti atij nuk po ia vë veshin. Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë, pra, kush të dojë, le të marrë këshillë! (Abese, 5-12.)

“Asnjë profet s’ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të Allahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t’ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë.” (Enfal, 67-68.)

Nëse Muhamedi (a.s.), do të ishte autor i Kuranit, vënia në dukje e gabimeve të veta do ishte jashtë arsyes,

i parrokshëm për mendjen e njeriut.

Megjithëse profetët janë njerëzit më inteligjentë dhe të urtë në botë, ata përsëri kanë rënë në gabime. Për ilustrim po japim rastin e Jakubit (a.s.), kur i akuzoi fëmijët për sjelljen e dëshmisë së rreme në lidhje me gjakun, duke u thënë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf, 18.) dhe në lidhje me vjedhjen në sarajet e Faraonit, kur i thanë se në trastën e Benjaminut u gjet një send i vjedhur. Ai edhe në rastin e dytë tha të njëjtën gjë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf, 83.) Jakubi (a.s.), në rastin e parë qëlloi, kurse në të dytin gaboi, sepse ata thanë të vërtetën.

Vetë Pejgamberi (a.s.), ka mbrojtur fajtorin duke e gjykuar si të pafajshëm, deri sa i ka ardhur zbulesa hyjnore. **“Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!”** (Nisa, 105.)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte gjykimi i gabuar që dha Pejgamberi (a.s.), në lidhje me një vjedhje. Myslimani Tuame ibn Ubejrik i kishte vjedhur parzmoren fqinjit të tij Katade ibn Numanit. Kur Numani filloi kërkimet për gjetjen e parztores, Ibn Ubejriku nga frika e zbulimit e fshehu parzmoren në oborrin e një hebreu. Kur Numani e gjeti parzmoren në shtëpinë e hebreut, çështjen ia çoi Pejgamberit (a.s.), për gjykim. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori në gjykim çështjen, hebreu pohoi se parzmoren e kishte lënë ibn Ubejriku tek ai. Ibn Ubejriku së bashku me një grup burrash nga fisi i tij e mohuan fjalën e hebreut dhe të gjithë dëshmuan se vjedhjen e kishte kryer hebreu. Kur Pejgamberi (a.s.), duke u nisur nga provat dhe dëshmitë po mendonte të jepte gjykim kundër hebreut, zbriti ajeti i mësipërm, i cili e shpallte të pafajshëm hebreun, në këtë mënyrë Allahu zbardhi të vërtetën duke dhënë një gjykim të kundërt me të Pejgamberit (a.s.).

Si mundet një njeri të nxjerrë me anë të mendjes dhe logjikës përfundime të vërteta në lidhje me të ardhmen dhe të shkuarën, kur nuk mund të gjejë të vërtetën midis dy njerëzve në konflikt. Arsyeja dhe inteligjenca humbasin vlerën për sa i përket identifikimit të ngjarjeve që kanë lidhje me të ardhmen dhe botën metafizike. Një njeri që gjykon në këtë sistem, njëherë qëllon dhe shumë herë të tjera gabon. Nëse do të ishte kështu, ajeti Kuranor: **“A nuk përsiatin ata mbi Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërtënie.”** (Nisa, 82.) do të ishte një sfidë e pakalueshme.





NJERIU ËSHTË KRIJUAR PËR TË LUFTUAR ME VËSHITRËSITË

Ihsan Kurt

“Ne e kemi krijuar njeriun për të luftuar në vështirësi.” (Beled, 4.) Një fjalë e urtë thotë: “Murin e shemb lagështira, kurse njeriun e shkatërron brenga.” Stresi, i cili përfshin kuptimet brengë, trishtim, hidhërim etj., është bërë shqetësimi më i madh i njeriut të shekullit XXI. Stresi, për herë të parë si term mjekësor është përdorur në vitet 1900. Shfaqja e këtij termi në periudhën e ndryshimeve të mëdha sociale, ekonomike, teknologjike dhe industriale është shumë domethënëse. Të gjitha gjendjet negative, që përjeton njeriu shprehen përmes termit stres. Gjendje të tilla si trishtimi, hidhërimi, ankthi, depresioni, plogështia, lodhja, pagjumësia, vetmia, dobësimi i kujtesës, mendimi për vetëvrasje e të tjera emocione negative janë simptoma të stresit.

Madje çdo faktor që e tëhuajson njeriun, që e largon nga vlerat njerëzore, që i shuan atij aftësinë për të marrë kënaqësi prej jetës, që e pengon atë nga produktiviteti në jetën arsimore dhe profesionale përfshihet në termin stres.

Kurse në psikologji, stresi përkufizohet si një reagim natyror i organizmit ndaj presioneve të jashtme dhe të

brendshme ngacmuese, të cilat prishin ekuilibrin shpirtëror dhe fiziologjik të njeriut.

Faktorët që shkaktojnë stresin quhen stresorë. Këta stresorë mund të jenë të karakterit fizik, biologjik, psikologjik dhe social. Pra stresi nuk është një gjendje që shkaktohet dhe është i lidhur vetëm me shkaqe biologjike dhe fizike. Shkak për stres mund të jenë edhe faktorët dhe gjendjet psikologjike dhe sociale. Studiuesit e kanë evidentuar stresin si shkak të njëjtë në shumë sëmundje biologjike dhe shpirtërore. Madje në raste të tilla, është theksuar rëndësia e fuqisë shpirtërore në përballjen e sëmundjeve dhe shqetësimeve fiziologjike. Prandaj, gjendja shpirtërore është shumë e rëndësishme në përballjen me stresin.

Megjithëse nga ana e individëve, mekanizmat e zhvilluara për mbrojtjen kundër stresit perceptohen si faktorë të jashtëm, ata janë shumë të lidhur me gjendjen psikologjike të njeriut. Mekanizmat mbrojtës për të luftuar stresin i shërbejnë një qëllimi të caktuar dhe ai është ruajtja e dinamizmit, gjallërisë dhe sigurimit të aktiviteteve normale jetësore.

Njeriu modern, i edukuar me frymën e revoltës, për-

ballë pengesave dhe vështirësive më të vogla, fillimisht konfliktohet me veten për të vazhduar më pas me mjedisin dhe shoqërinë. Normalisht që duke mos siguruar një aktivitet normal jetësor, personi pushtohet nga emocionet negative, si pikëllimi, brenga, kriza etj.

Ndërsa një grup stresorësh është i njëjtë për të gjithë njerëzit, një grup tjetër është i ndryshëm në varësi të dallimeve psikologjike dhe fizike të individëve. Sepse njeriu në varësi të botëkuptimit dhe këndvështrimit të tij për qëllimin e krijimit, shfaq mekanizma mbrojtës dhe kundërreagime të ndryshme përballë gjendjeve stresante dhe vështirësive që has në jetë.

Shkaktarët e stresit, që pothuajse janë të njëjtë për të gjithë njerëzit, janë:

Të gjitha problemet ditore që mund të hasë njeriu gjatë ditës janë elementë potencialë për të shkaktuar stres të intensiteteve të ndryshme, në varësi të karakteristikave individuale të njeriut. Sjelljet negative me të cilat mund të përballlet njeriu në shtëpi, në punë, në shkollë, në trafik janë gjithashtu burime stresi. Brengat e vogla, që fillojnë si pasojë e ndryshimeve të statusit dhe pozitës në punë apo në jetën shkollore shumë shpejt mund të shndërrohen në stres. Është evidentuar se konfrontimi që ndodh midis punonjësve për shkak të mospërcaktimit të roleve dhe kompetencave në një institucion është burim për stres.

Ndryshimet dhe zhvillimet e menjëhershme që ndodhin në jetën e njeriut, në familje, në punë, në shkollë dhe në mjedisin ku jeton sjellin problemin e përshtatjes me zhvillimet e reja. Sepse tek disa persona ndryshimet dhe zhvillimet e menjëhershme dhe të papritura sjellin me vete tension, shqetësim dhe probleme. Të gjitha këto mund të jenë shkak për shfaqjen e stresit.

Po ashtu, stres shkaktojnë edhe disa shqetësime biologjike dhe psikologjike. Ashtu si mungesa e koordinimit midis funksioneve biologjike sjell shqetësime fizike edhe mungesa e përshtatjes me gjendjen e re psikologjike apo sociale sjell përjetimin e stresit. Në emër të shpëtimit prej stresit njeriu mbështetet te alkooli dhe droga, duke u zhytur në këtë mënyrë në gjendje pa rrugëdalje. Por në të dyja rastet, më i rëndësishëm se vetë sëmundjet dhe problemet me të cilat përballlet njeriu, është qëndrimi që do të mbajë ai karshi këtyre.

Kurse ndër stresorët që shkaktojnë stres në varësi të karakteristikave individuale të personit, mund të numërojmë: mënyrën e qasjes ndaj shqetësimit apo problemit, filozofinë e jetës, besimin, botëkuptimin dhe aftësinë për t'u përshtatur.

Sekreti i zhvillimit të një reaguesi të shëndetshëm për të luftuar stresin është i fshehur në aftësinë për

t'u përshtatur me gjendjen e re. Nga ky këndvështrim, stresi nuk mund të konsiderohet vetëm si një gjendje negative dhe e padëshiruar.

Stresi është i domosdoshëm në disa gjendje dhe periudha të jetës së njeriut, sepse e dimë që procesi i krijimit të njeriut kalon nëpër faza të vështira. Sipas kësaj pikëpamjeje, theksi nuk vendoset në sigurimin e një jete pa stres, por në zhvillimin e mënyrave dhe rrugëve për të luftuar dhe shpëtuar prej stresit. Sepse stresi i moderuar pranohet si normal, madje për shumë persona është një nxitës për sukses. Stresi në disa raste që ne i perceptojmë si të rrezikshme apo kërcënuese merr rolin e mbrojtësit. Por në rastet kur gjendja bëhet kritike dhe e papërballueshme, ndërhyjnë forca më të mëdha dhe efikase, të ashtuquajtura "fuqi shpirtërore". Me ndihmën e këtyre forcave stresi mund të pakësohet dhe mundet. Thënia e poetit: "O Zot! Ose më jep fuqi sipas problemeve që kam, ose më jep probleme sipas fuqisë" është një vetëdijësim për pamundësinë për të shpëtuar përfundimisht nga stresi. Por edhe mënyra se si i qaset problemit të stresit është krejtësisht e përputhshme me jetën e njeriut në tokë. I gjithë sekreti për të triumfuar mbi stresin qëndron pikërisht në filozofinë që njerëzit kanë për jetën. Njerëzit që i konsiderojnë problemet dhe shqetësimet e ndryshme që hasin gjatë jetës si prova të kësaj bote, janë më të suksesshëm në kapërcimin e problemeve dhe gjendjeve stresante.

Atëherë, në lidhje me rrugët dhe mënyrat për të minimizuar dhe mundur stresin mund të themi:

E para dhe më e rëndësishmja është rregullimi i perceptimit negativ që kemi ndaj stresit. Në vend të përpjekjes për të zhdukur krejtësisht stresin, duhet menduar mënyra si të kapërcehet me sukses ai. Rrugëzgjdhjet e dëmshme nuk duhen konsideruar si rrugëzgjdhje. Një problem nuk mund të zgjidhet duke u mbështetur te një problem tjetër, i cili nga ana e tij mund të hapë shumë probleme të tjera. Shembulli tipik i kësaj dukurie është personi që sapo përballlet me një problem, shikon si rrugëzgjdhje të vetme alkoolin, drogën, pesimizmin dhe vetëvrasjen.

Një fjalë e urtë thotë: "Shoku i njeriut që rri kot, është shejtani." Kjo tregon se personi që kalon kohën kot përfshihet nga krizat, stresi dhe nga ndjenja e nënvlerësimit të vetvetes. Prandaj, angazhimi me punë dhe mbushja e kohës me aktivitete luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e një jete të gjallë dhe produktive.

Krahas të drejtës për punë dhe sukses, njeriu ka po aq të drejtë t'i ndajë kohë vetes për pushim, çlodhje dhe argëtim. Por këto aktivitete çlodhjeje dhe argëtimi përsëri duhet të jenë në funksion të mirëqenies dhe dobisë së përgjithshme të njeriut.

RRETHI I

Dashuria u hodh jashtë nga zemra e njeriut të fundit, që shikonte me shpresë dhe nisi të ecte kokulur, e vetmuar nëpër rrugica. Ku të shkonte e çfarë të bënte? Ndërkohë që vendi i saj ishte zemra, tashmë kishte përfunduar rrugëve. Kurse Urrejtja dukej kudo. Një ditë, Urrejtja u përball me Dashurinë. Duke u tallur me të dhe duke qeshur me të madhe, tha:

- S'je më në asnjë zemër. Ty as që të donte njeri. Madje, shumica nuk dinte gjë rreth teje. Pse akoma sillesh andej-këndej? Ik diku dhe prit që të zhdukesh!..

Kurse Dashuria iu drejtua:

- Përderisa Allahu më ka krijuar, kjo do të thotë se Ai më do. Dhe, për sa kohë që do të jem unë, Ai do të jetë me mua. Dhe, për sa kohë që Ai do të jetë me mua, unë përherë do të mbaj shpresë te njerëzit. Si përfundim, unë do të jem në zemrat e tyre përgjithmonë.

Kështu, Urrejtja heshti dhe iku menjëherë prej aty.

Dashuria sërish nisi të shëtiste e vetmuar...

Po mendonte ato çfarë i tha Urrejtja, përpiquej të dukej si e fuqishme, por ishte e shkatërruar. Ishte e vetme... Ndërkohë, i afrohet dikush. Ishte Mëshira...

Mëshira e pyeti me kureshtje:

- Përse je këtu, a nuk duhet të ishe në zemra?

Dhe Dashuria iu përgjigj:

- Po, në zemra isha. Por kur erdhi Urrejtja, njerëzit ma sollën shpinën. Kurse tani jam këtu. Po mirë, po ti përse je këtu?

Mëshira iu përgjigj:

- Unë iu pata dhuruar nga Allahu disa njerëzve. Por, kur njerëzit u njohën me Smirën, më harruan mua. Smira u përhap gjithandej. E bëftë të mundur Allahu të bashkohemi sërish me ta!

Tashmë të dyja së bashku u ulën diku dhe filluan të mendonin. Vallë ç'të bëjmë? Do të fillonin të binin në pesimizëm, sikurse njerëzit që nuk e njohin Krijuesin e tyre. Shpresa e pa këtë gjendje të tyre, erdhi dhe u tha:

DASHURISË

- Mirë që mua më harruan njerëzit, po ju ç'ju ka ndodhur? Ju lutem, mos bini në pesimizëm!

Ndërkaq, erdhi Drejtësia dhe u tha:

- Po vij nga Hz. Omeri. Mua më solli ai njeri, 'shembull i drejtësisë'. Më tha se, sikur të mblidheshin vlerat e mirësjelljes njerëzore, do t'u ktheheni ditëve të lumtura dhe plot qetësi.

Edhe Durimi ishte në një gjendje të mërzitur, mirëpo për arsye të natyrës së tij, po priste. Pasi, brenda kishte një shpresë. Po shkante pranë Dashurisë dhe Mëshirës, duke thënë me vete: "Mua vetëm ato të dyja do të më ndihmojnë." Kur po shkante, rrugës kërkoi edhe Mirësjelljen. Edhe ajo, sikurse të tjerat, po priste në një qoshe të rrugës, e mërzitur. Eja, i tha Durimi Mirësjelljes, eja me mua. Zemrat e vyshkura kanë nevojë vetëm për ujë... Më pas u takuan të gjitha... Dashuria, Mëshira, Drejtësia, Durimi, Shpresa dhe Mirësjellja. Takuan një njeri që kishte humbur shpresën në jetë, por

që po i lutej Allahut të Madhëruar. Ia treguan të gjitha atij. Mëshira u hodh menjëherë:

- Për të realizuar **Rrethin e Dashurisë**, na nevojitet një zemër që pendohet. A mund të na ndihmosh për këtë? Mund të bëhemi eliksiri i jetës së zemrave që janë vyshkur.

Njeriu i habitur u shpreh:

- E pranoj, por si mund të bëhet kjo gjë vetëm me mua?

Dashuria i tha se mund t'ia shpjegonte.

- Detyra jote është që të kalosh një jetë të kujdesshme dhe të kryesh me nder obligimin tënd si rob i Allahut. Të marrësh sa më shumë njerëz pas teje. Gjithçka është e fshehur në farën tënde. Fara jote duhet të bashkohet me eliksirin e jetës dhe kështu rriten filizat e së ardhmes dhe si përfundim **Rrethi i Dashurisë** do të përhapet gjithandej...

Njeriu tha:

- E pranoj këtë detyrë.

Tha, por ama...



Furat Ibn Hajjani

— SI NJË GJURMUES I MIRË, SI NJË UDHËRRËFYES I DENJË —

Mustafa Erish

Furat Ibn Hajjani, radijall-llahu anhu, ishte një sahab hero dhe guximtar, që Resulullahu (s.a.s), e dërgoi tek Musejlimeja.

Një sahab që kishte merituar konsideratën e Pejgamberit (s.a.s.), i cili kishte thënë “*Ata janë njëri më trim se tjetri*.”

Ai ishte një udhërrëfyes mjaft i mirë, pasi njihnte shumë mirë rrugët përreth Mekës.

Një udhërrëfyes mekas, që bënte udhërrëfyesin e karvaneve të kurejshëve dhe veçanërisht karvaneve tregtare të Ebu Sufjanit dhe shquhej edhe si agjenti i tij!

Në periudhën e injorancës, ishte prej atyre që i patën thurur kurthe Resulullahut (s.a.s.).

U nderua me Islamin pas betejës së Uhudit.

Ai ishte pjesë e degës Ixhli, nga fisi i bijve të Bekirëve në Mekë.

Ishte shumë i lidhur me fenë e gjyshërve të vet. Vazhdimisht shqetësonte myslimanët, si dhe Resulullahun (s.a.s.), me fjalime fyese. Kjo armiqësi e tij ndaj Islamit, u bë shkak të vonohej që të përndritej me nurin e Islamit. Nuk ia hapi menjëherë zemrën të vërtetës. Islamizimi i tij ndodhi pas disa ngjarjeve që do t'i ren-

disim më poshtë.

Furat Ibn Hajjani shquhej si agjenti i Ebu Sufjanit. Para luftës së Bedrit, ndodhej në Mekë. Në një çast, u përhap lajmi se myslimanët kishin ndjekur karvanin tregtar të Ebu Sufjanit nga Shami dhe do t'i sulmonte. Kurejshët menjëherë nisën të përgatiteshin për luftë. Për t'i bërë të ditur këto përgatitje, Furat Ibn Hajjanin e dërguan si korrier te Ebu Sufjani.

Furat Ibn Hajjani nisi udhëtimin menjëherë dhe, ngaqë dinte rrugët, shkoi pa humbur kohë. E lajmëroi Ebu Sufjanin se në drejtim të tij po vinte një ushtri e përbërë nga kurejshët. (Ibni Sad, Tabakat, II, 36.)

Furat Ibn Hajjan ishte shumë i guximshëm dhe shumë energjik. Në luftën e Bedrit, u zu rob nga myslimanët. Mirëpo, e gjeti një rrugë dhe u iku.

Ishte pragu i luftës së Uhudit. Myslimanët kishin marrë nën kontroll rrethinat e Medines. Mushrikët mekas ishin shumë të shqetësuar. Thuajse kishin arritur në gjendjen që të mos mund të bënin tregti.

Një ditë, kur Safvan Ibn Umejje po diskutonte me ata që e rrethonin mbi këtë çështje, Esved Ibn Muttalib-i i tha: “Nëse rruga e bregdetit është e rrezikshme, atëherë nise karvanin nga rruga e Irakut.”

Safvani i tha se nuk e dinte atë rrugë. Kurse Esvedi i tha: "Mund të ta këshilloj një udhërrëfyes. Ai të shpie atje me sy mbyllur." Kur Safvani pyeti se kush ishte, ai u përgjigj: "Furat Ibn Hajjan el-Ixhli".

Safvan ibn Umejje e thirri Furatin dhe i tha: "A mund të më bësh udhërrëfyesin për të shpënë karvanin në rrugën e Irakut?" Dhe ai u përgjigj: "Unë të shpie në ato rrugë, që askush nuk mund të guxojë të vijë andej. Aty është zona e shkretëtirave të thata të Nexhidit." Safvani u bind nga ato çfarë i tha, bëri përgatitjet dhe nisi udhëtimin. (Vakidi, Megazi, I/198)

Ndërkohë që karvani po lëvizte drejt Shomit, në Medine ndodhi një ngjarje. Mekasi Nuajm Ibn Mesud erdhi në Mekë. Në gjendje të dehur u tregoi rrugën nga po shkonte karvani i Safvanit. Pasi dëgjoi këtë Thabit ibn Numani, radijall-llahu anhu, ia tregoi Resulullahut (s.a.s.).

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), menjëherë përgatiti një ushtri prej 6000 vetësh nën komandën e Zejd Ibn Harise-së. Ushtria u takua me karvanin në zonën Kare. Ata që ishin në karvan, ia mbathën duke e lënë ashtu siç ishte karvanin, plot mallra e gjëra të çmueshme. Vetëm udhërrëfyesi Furat Ibn Hajjani u kap dhe u soll në Medine.

Furat Ibn Hajjani kishte një miqësi të hershme me Ebu Bekrin. (Ibni Sad, Tabakat, II, 36). Ndaj dhe Ebu Bekri (r.a.), i propozoi të bëhej ndërmjetës që të shpëtonte nga robëria.

Nuk arriti t'i thoshte menjëherë "po", propozimit të Hz. Ebu Bekrit, pasi, u mendua: "Një herë kam shpëtuar nga duart e Muhamedit, kurse tani nuk shpëtoj dot."

Miqtë që i gjendeshin afër, u përpoqën t'i jepnin kurajo, i thanë se, nëse hunte në Islam, do të shpëtonte.

Furat Ibn Hajjani, mbeti shumë i kënaqur nga udhëzimi që i dhanë miqtë dhe në zemrën e tij u krijua një dëshirë për të hyrë në Islam. Menjëherë iu ndriçua syri e mendja dhe pranoi fenë islame. Nga miqtë e tij mori njohuri lidhur me Islamin, tha shahadetin dhe u bë mysliman.

Njëri që ndodhej aty, shkoi menjëherë tek Resulullahu (s.a.s.) dhe i tregoi se Furat Ibn Hajjani ishte bërë mysliman.

Krenaria e gjithësisë (s.a.s.), u gëzua nga ky lajm dhe tha: "Ka njerëz të tillë në mesin tuaj, që ne i besojmë deklaramit të tyre se janë bërë myslimanë. Njëri prej atyre është edhe Furat Ibn Hajjani." (Ebu Davud, Xhihad, 109, Hadithi nr. 2652)

Jeta e Furat Ibn Hajjanit (r.a.), ndryshoi menjëherë. Nuk u kthye në Mekë. Për të mësuar Islamin, qëndroi pranë njerëzve të Suffes. Mësoi Kuranin. Zgjeroi dituritë dhe njohuritë dhe u bë një mysliman i mirë. (Ebu Nuajm, Hiljetul-Evlja, 2/17)

Ai, krahas guximit që kishte, ishte gjithashtu edhe një njeri shumë modest dhe i sjellshëm. Bëri edhe një xhami në emër të vet. Një ditë, Hanzala Ibn Rebia (r.a.), erdhi në këtë xhami. Ndërkohë që kishte ardhur vakti i namazit, Furat Ibn Hajjani (r.a.), ftoi Hanzala Ibn Rebianë (r.a.), të printe në namaz. Hanzala Ibn Rebia (r.a.), nga modestia dhe edukata që kishte, tha: "O Furat! Ti je më i madh se unë. Ke bërë hixhret para meje. Dhe mbi të gjitha, xhamia është e jotja."

Furat Ibn Hajjani, u shpreh kështu: "O Hanzala! Pasi dëgjova gjithë ato fjalë të bukura që thoshte Resulullahu (s.a.s.), për ty, unë s'kam ndërmend të të prij në namaz."

Pas kësaj, Hanzala (r.a.), u bë imam dhe priu në namaz. (Ibni Manzur, Muhtasar, VII, 283). Të gjithë sahabët e nderuar ishin po kaq modestë.

Resulullahu (s.a.s.), i dha një tokë Furat Ibn Hajjanit në Jemame, me vlerë prej katër mijë derhemëve. (Usdul Gabe, IV, 335)

Ai mori pjesë në të gjithë betejat, pas Betejës së Hendekut. Luftoi si hero. Në ngadhënjimin e Mekës, në Hunejn, në Taif ishte gjithnjë me Resulullahun (s.a.s.). I Dërguari i Allahut i dha një detyrë të veçantë, që bashkë me Jemamasin Thumame Ibn Usal, të vriste Musejlimenë, profetin e rremë që kishte dalë në rrethinat e Jemames.

Për të kryer këtë detyrë, Furat Ibn Hajjani (r.a.), bashkë me Ebu Hurejranë (r.a.), u nisën nga Medina. Pejgamberi ynë, pasi ata ikën, tha: "Ata janë njëri më trim se tjetri." Në këtë mënyrë, trimëria e tyre u vërtetua.

Furat Ibn Hajjani, kur iu afrua Jemames, nisi të bënte plane bashkë me Thumame Ibn Usalin (r.a.). Ndërkohë, mbështetën Ala Ibn Hadramin, i cili po luftonte me Musejlimenë. U bënë bashkë, vranë Musejlimenë dhe shkatërruan ushtrinë e tij. Në shenjë mirënjohjeje ndaj Allahut, aty ranë në sexhde. (Isabe, V, 272 - 274; Istiab, III, 1258-9.)

Furat Ibn Hajjani (r.a.), në kohën e Hz. Omerit (r.a.), mori pjesë në çlirimin e Iranit. Tregoi heroizma të mëdha. Ai u dërgua edhe si korrier te Rustemi. E ftoi atë në Islam. Rustemi, duke e pyetur atë për gjëra të ndryshme, mori njohuri rreth Islamit. Mirëpo, as nuk pranoi Islamin e as nuk pranoi të bënte ndonjë marrëveshje. (Ibn Kethir, el-Bidaje ven-Nihaje, VII, 38.)

Nuk dihet saktësisht se ku dhe kur ka vdekur Furat Ibn Hajjani (r.a.). Sipas disa burimeve, ai, pasi ndërroi jetë Resulullahu (s.a.s.), u shpërngul nga Medina dhe qëndroi pak në Mekë, pastaj u drejtua në Kufa, ku bëri një shtëpi për vete. (Isabe, V, 272- 274.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!



Fjala është si Fara

Zahit Genç


Fjala është si fara. Fara duhet të jetë e shëndetshme, në mënyrë që të rritet, të kthehet në bimë a pemë dhe më së fundi, të japë frutat e saj.

Nëse fara është e shëndetshme, përsëri nuk është e mjaftueshme, po qe se toka në të cilën do të mbillet nuk është tokë pjellore. Madje edhe kjo nuk mjafton. Për të mbjellë farën duhet të punohet toka. Edhe pasi të mbillet fara, toka duhet të jetë e shkrifët.

Pasi fara ta plotësojë kohën e duhur nën tokë dhe të dalë në dritën e diellit si një filiz i freskët, duhet të

plehërohet, të pastrohet nga barërat e egra, të prashitet dhe vaditet. Duhet të mbrohet nga krimbat e zogjtë, duhet t'i hidhet ilaçe mbrojtëse, të mblidhet e të shihet, të depozitohet dhe të silllet në një gjendje të gatshme për t'ua paraqitur njerëzve, në mënyrë që të përfitojnë sipas llojit të saj.

Nëse është grurë, duhet të shkrihet apo të bëhet miell. Mielli duhet të bëhet brumë, brumi duhet të bëhet bukë dhe të piqet në furrë. Të gjitha këto janë gjëra që duan durim, përpjekje dhe falënderim.



Që fjala të ketë dobi dhe të ndikojë te bashkëbiseduesi, duhet të punohet në mënyrë paraprake dhe të bëhet përgatitje serioze. Grupmoshat që do ta dëgjojnë fjalën, si: fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit, duhet të merren parasysht sipas moshës që kanë.

Të mbjellësh farën e fjalës pa e punuar tokën e zemrës, mund të mos ketë shumë dobi për njeriun. Asnjëherë nuk është parë që një bujq të mbjellë farën pa punuar tokën, sepse farën e hedhur në një tokë të papunuar, e merr era, ose e merr rrëkeja, ose bëhet ushqim për zogjtë dhe insektet.

Të ndikosh me fjalë ata, të cilëve u janë verbuar ndjenjat dhe ngurtësuar zemrat, nuk është gjë e thjeshtë.

Për këtë arsye, duhet të bëhen përgatitjet e nevojshme nën dritën e dijes së përshtatshme me krijimin e njeriut dhe të dhënave fetare. Siç duhet punuar toka, duhet punuar edhe ara e zemrës.

Siç thotë edhe Mevlana:

“Guri nuk lulëzon, edhe nëse mbi të kalojnë njëmijë pranvera.”

Nëse gjendja është e tillë, fjalën nuk duhet t’ua themi gurëve apo zemrave të ngurtësuara. Së pari, duhet të hapim zemrat me edukim, dashuri, interesim dhe informacion, pastaj duhet t’u flasim. Shpresojmë se atëherë fjala do të ndikojë.

Sot, në mentalitetin e zbatimit të detyrës nëpër shkolla ka shumë mangësi dhe dobësi. Perceptimi i një detyre ideale ka humbur. Ka shumë njerëz që mendojnë kështu:

Të hyj në mësim për të marrë pjesë, të plotësohet ora

dhe pastaj të dal. Në këtë mënyrë, shpeshherë edhe orët e mësimit nuk janë produktive. Rezultati nuk është gjë tjetër përveçse humbje kur nuk ka sinqeritet, sakrificë dhe përpjekje. Studentët po dalin nga shkolla pa asnjë formim atdhetar e shpirtëror dhe pa edukim human e njerëzor. Fjalët sikur ngelin në ajër, hyjnë në njërin vesh e dalin nga veshi tjetër.

Kjo ndodh për shumë arsye. Nëse mund të përme-ndim disa prej tyre, atëherë mund të themi:

E para, nuk kemi bazë, domethënë, nuk kemi një mjedis edukimi në përputhshmëri me besimin tonë.

E dyta, përpjekja është e mangët. Mërzia, nënvlerësimi dhe indiferentizmi kanë depërtuar në sjelljet tona.

E treta, njetet nuk janë të sinqerta.

E katërta, nuk ka sinqeritet dhe pastërti. Sytë e njerëzve tanë i ka mbuluar pasioni i pasurisë dhe pozitës. Puna po bëhet me një zemër të mbushur me llogarinë e parave dhe hallet e shtëpisë e të makinës. Rezultati: Brezi ynë që duhet të jetë një brez i shkëlqyer, po kthehet në një shoqëri të papërgjegjshme, të parespektueshme, agresive, e vështirë, e paqëllimtë dhe e pasynim.

E vërteta është kjo: Rezultati i qëndrimeve dhe sjelljeve, në të cilat nuk ka vetëdije, sinqeritet, përpjekje, sakrificë e mund dhe që nuk merret parasysht kënaqësia e Allahut Teala, detyrimisht është bosh dhe i padobishëm.

Mjerë për ne nëse biem në dorën e atyre njerëzve që nuk e perceptojnë dot orarin e punës nga aspekti i mëkatit, që nuk e vlerësojnë, që nuk e zbatojnë, që nuk merren me hallet e shoqërisë dhe që nuk e ndjejnë në zemër dhimbjen e tyre. Nëse biem në duar të tilla, asnjëherë nuk do të mbarojnë vuajtjet, vajtimet dhe hallet tona...

Nisur nga kjo, së pari, mësuesit duhet të gjejnë rrugët e hyrjes në zemrat e fëmijëve tanë, duhet ta lodhin kokën për këtë dhe duhet të lidhin marrëdhënie të ngrohta e të sinqerta me ta. Atyre duhet t’u japin vetëdijen e adhurimit dhe të gdhendin në zemrat e tyre ndjenjën e atdheut, popullit dhe fesë. Pas këtyre, duhet t’u japin mësimet, si: shkencat e artit, letërsinë, historinë dhe kulturën.

Ata që zhvillohen fizikisht dhe shpirtërisht me këtë praktikë, besojmë dhe shpresojmë se do të fillojnë të edukojnë një brez të dobishëm dhe të respektueshëm ndaj njerëzve dhe se fjalët që mbillen në zemra, do të gjejnë vendin e tyre.

Ne duhet të punojmë me ndjenja njerëzore e islame dhe me një entuziazëm që nuk shuhet asnjëherë, për të arritur synimin dhe qëllimin e dëshiruar...



Ky shembull është për të gjithë

Mehmet Dinç

Po. Ky shembull është për të gjithë, sepse ky është tregimi i një mashtrimi. Ky është lajmi në lidhje me Bel'am bin Bauran... Sipas transmetimeve që jepen në literaturën e tefsirit, Bel'ami kishte jetuar në kohën e Musait, alejhi's-salam dhe ishte prej dijetarëve të Beni Israilëve. Ai kishte dije të gjerë rreth shpalljes së Allahut Teala dhe ishte njeri i hakikatit, por i besonte dijes më shumë se çdo gjëje dhe pandehte se ajo e mbronte nga gabimet. Ndërkohë që ishte njeri i dashur te Allahu dhe i pranohej lutja, në një çështje e kundërshtoi pejgamberin e Tij. U mashtrua prej disa

dredhive dhe u lut keq për të. Ai këmbënguli në këtë gabim dhe e teproi. Allahu Teala thotë:

“...Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, që ata të meditojnë.” (Hashr, 21.) Ndërsa në surel el-Araf, Mëshiruesi flet për shembullin e Bel'ami, duke e shfaqur me një përngjasim spikatës:

“Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit.” (Araf, 175.)

“Sikur të donim, do ta ngrinim atë (me shpalljet Tona), por ai u mbërthye pas jetës tokësore dhe u dha pas dëshirave të veta. Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën. Ky është shembull i njerëzve, që mohojnë shpalljet Tona. Tregojua atyre këto ngjarje, në mënyrë që ata të mendojnë.” (Araf, 176.)

Kur lexojmë këto ajete, tabloja që përshkruan pikat kryesore të mësipërme, pothuajse vjen para syve tanë: Mendojmë një njeri që i besoi Allahut Teala. Si rezultat, i Plotfuqishmi ia lehtësoi atij pasimin e Pejgamberit. Të gjitha veprat që bëhen për hir të fesë, janë nga një nder më vete. Këtij personi iu dha mundësia të bënte veprat më të mira. Atij iu dha dija dhe urtësia. Iu dha mundësia për të qenë pranë profetit të kohës së tij. Por ai nuk ua diti vlerën gjithë këtyre. Gjërat që ia dha Allahu Teala, filloi t’i shndërronte në gjëra të pavlefshme. Ai iu bind shejtanit, edhe pse e dinte të vërtetën dhe të gabuarën. U dha pas pasioneve dhe u bë prej të devijuarve...

I ndjeri Hamdi Jazëri, e komenton kështu fjalinë në krye të historisë: “Njoftoi ata për historinë e këtij njeriu të poshtër. Atij i patëm dhënë argumentet tona. Ai pati dije dhe ndershmëri, por i la të gjitha këto. Shejtani e bëri t’i nënshtruhej dhe ai devijoi nga rruga e drejtë...”

Kur mendojmë: “Si mund ta bëjë këtë ai që i beson Allahut dhe ahiretit? Si mund të mashtrohet pas dëshirave të përkohshme, edhe pse e di të vërtetën?” Përsëri në ndihmë na vjen shpjegimi i të ndjerit Elmallëllë: “Domethënë, vullneti hyjnor nuk deshi që ai të qëndronte i fortë në të vërtetën, kështu që u la në gjendjen e tij dhe u bë prej atyre që i binden shejtanit.”

Ja, pikërisht atëherë i luteni Allahut përsëri dhe i thoni: “O Zot! Mos na lër të mbështetemi te vetja jonë, qoftë edhe sa hap e mbyll sytë!”

Dashuria ndaj Kuranit rritet përsëri në zemrat tuaja dhe thoni: “Ja, kjo ishte.” Kjo duhet të jetë mënyra koncize e Librit të Lartë që qetëson zemrat e besimtarëve... Atyre nuk u jep detajet e ngjarjes, por esencën e saj. I trondit me shembullin më spikatës, i inkurajon që të pyesin veten dhe i mëson të kuptojnë gjërat që ndodhin rreth e rrotull tyre.

Mendoni: Gjendja e atij që i ndërron virtytet fetare me interesat e kësaj bote, përngjasohet me gjendjen

më të keqe të qenit...

Nga shpjegimi i mësipërm mësojmë se synimi i kësaj historie nuk është përkufizimi i personit, i cili përbën temën e saj, por përshkrimi i gjendjes së tij dhe informimi i të gjithë njerëzve, në mënyrë që të marrin mësim nga ai shembull. Themi shembull për të gjithë njerëzit, sepse Kurani Fisnik, e shëmbëllen gjendjen e këtij njeriu të tillë me një gjendje të pështirë, e cila nuk gjendet te asnjë kafshë tjetër në tokë përveçse te qeni...

“Shembulli i tij është si shembulli i qenit: nëse e ndjek, ai të nxjerr gjuhën, nëse largohesh, ai përsëri të nxjerr gjuhën.”

Grada e atij njeriu, që u jep përparësi dëshirave të tij ndaj vlerave të larta të fesë së Allahut, është grada më e ulët e poshtërimit, sepse nuk ka gjë më të keqe sesa të shkëmbesh me këtë botë dijet e vërteta fetare pasi i ke mësuar ato. Ja pra, gjendja e atij apo e atyre që i përgënjeshtrojnë argumentet e Zotit, i ngjan asaj që thamë më sipër. Fundi i tyre është i keq, po ashtu edhe çdo aspekt i jetës së tyre, që i ka mbartur ata te ai fund... Sepse ata përpëliten në detin e një pasioni që ua merr frymën...

Mistikët e kanë shfaqur gjendjen e Bel’am bin Bauras, që jepet si shembull në ajet, si modelin më të qartë të atyre që devijojnë për shkak të mendjemadhësisë dhe dëshirave të kësaj bote. Për sa i përket përngjasimit me “qenin”, kanë thënë se ai përfaqëson nefsu’l-emmaaren. Sepse qeni këtu përfaqëson dhënie pas pasioneve dhe epsheve, për të cilat bëhet fjalë. Po ashtu, përfaqëson edhe pasionet e shpresat që nuk kanë fund.

Lajkatimi i qenit, pandershmëria e tij dhe shkuarja pas një cope kocke të pavlerë, tregojnë poshtërsinë, apo me fjalë të tjera, gradën më të fundit të poshtërsisë...

Shpjegimi i ajeteve të mësipërme në Ruhul-Bejan është kështu: “Besimtari i vërtetë, edhe nëse arrin gradat më të larta, përsëri nuk mund të jetë i sigurt nga kurthi i Allahut. Asnjëherë nuk mund t’ia mbyllë vetes rrugët e përpjekjes dhe nuk neglizhon për të kundërshtuar veten e dëshirat e tij.” Kështu ishte edhe gjendja e hulefai rrashidinëve të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), e sahabëve, e selefus-salihin, e imamëve dhe e shehlerëve të vërtetë.





KUSHTI PËR EKZISTENCË

Idris Arpat

Bota në mendjen dhe imagjinatën e njeriut formohet nga besimi, mendimi, ndjenjat apo nga përzjerja e të gjitha këtyre. Në lidhje me këtë çështje, nuk kemi një përgjigje të prerë. Ajo që dihet me siguri, është mos-përputhja e botës reale me botën që kemi në mendje

dhe në imagjinatën tonë. Gjendja reale nuk përmban veçoritë e gjendjes që dëshirohet prej nesh. Nëse një person nuk e sakrifikon botën në vizionin e tij, është e pamundur të mos tëhuajsohet, vetmohet dhe në fund të çmendet përballë gjezurave, dokrrave, absurditete-

ve, degjenerimit, shthurjes, përmbysjes së ekuilibrave, shpenzimit të shfrenuar, shndërrimit të njeriut dhe teknikës në terminator dhe përhapjes së marrëzive si kancer. Ose do të përfshihesh nga psikologjia e masës dhe do të heqësh dorë përfundimisht nga njerzillëku. Por edhe kjo nuk është e thjeshtë për ata që e kanë mburjtur karakterin me shpalljen hyjnore. Këta njerëz nuk mund të bëjnë sikur nuk shikojnë, dëgjojnë apo nuk dinë, kur çdo gjë ndodh para syve dhe zemrave të tyre.

Në këtë pikë, duhet marrë në shqyrtim natyra njerëzore, besimi dhe dituria. Këto janë perla të fjetura apo janë faktorë që kërkojnë ndërhyrjen dhe rregullimin e botës së jashtme?

Duhet ditur natyra e njeriut dhe besimi. Qëllimi i diturisë duhet të jetë njohja e njeriut dhe zbukurimi i mjedisit ku ai jeton. Ndërtimi i një bote pa marrë në konsideratë besimin dhe natyrën njerëzore, nuk mund të sigurojë lumturinë e njeriut, përkundrazi, ajo bëhet shkak për shkatërrimin e tij. Megjithëse gjendja është kritike, fatkeqësisht, ne akoma nuk zotërojmë njohuritë e duhura rreth njeriut dhe besimit. Prandaj as bota jonë nuk është botë dhe as jeta jonë nuk është jetë. Po zvarritemi pas jetës të pasinqertë, të palumtur dhe të pabegatë. Diku është bërë një gabim, por ku? Ne, fatkeqësisht jemi të privuar edhe nga ajo dituri, e cila na bën të mundur dallimin e gabimit. Pandehëm se besimi mund të jetohej si padituri, mirëpo u mashuram rëndë. Për momentin jemi të çoroditur dhe të paqartë përballë botës.

Jetojmë një botë të rremë, në një botë ku çdo gjë është fals, marrëdhënia, dashuria, tregtia, të gjitha janë false. Sistemi arsimor prodhon njerëz pa karakter, pa qëllim dhe synime në jetë. Në vend të zgjidhjes së problemeve, ai i shtyn njerëzit drejt krizës dhe pështjellimit. Sistemi i sotëm global vazhdimisht prodhon gënjeshtër, duke i shitur për të vërteta. Çdo gjë në këtë botë është bërë turistike dhe ne, me hir apo pa hir, jemi turistët e saj.

Që nga krijimi i gjithësisë e deri më sot ngjarja më e rëndësishme ka qenë krijimi i njeriut dhe shpallja hyjnore. Prandaj duhet të thellohemi dhe zgjerohemi në fushën e njohjes së njeriut dhe shpalljes. Shpallja e parë e fesë, së cilës i përkasim dhe mburremi jo më kot, është **"Lexo!"** Allahu, jo më kot, menjëherë pasi krijoi Ademin, i mësoi atij emrat dhe e lartësoi atë mbi engjëjt.

Ne duhet të ndërgjegjësohemi se pa udhërrëfimin e diturisë, besimi nuk mund të jetojë gjatë në këtë botë dhe nuk mund të zbatohet në jetë. Prandaj, dy

gjërat më të nevojshme për myslimanët janë kultivimi i njerëzve të zemrës dhe mendimit.

Hapi i dytë është fillimi punës dhe përpjekjes për krijimin e botës sonë nën udhëheqjen e imanit dhe diturisë. Natyrisht që kjo kërkon përpjekje këmbëngulëse dhe durim pa kufi. Sepse kjo që duam të ndërtojmë nuk është një çadër, por një botë. Nuk ka gjë që nuk mund të arrihet, nëse punohet me këmbëngulje dhe durim. Por kjo nuk mund të arrihet duke anashkaluar shkencën mendimin, artin teknikën etj. Nëse ndodh, atëherë shndërrohemi në pre e të tjerëve, si Iraku, Bosnja dhe Afganistani.

Ne kemi humbur një epokë, kemi humbur kohën e natyrës dhe njeriut, kohën kur njeriu konsiderohej njeri dhe natyra shikohej si amanet hyjnor. Ndërsa njeriu lartësohet me besim, dituri dhe urtësi, mjedisi dhe natyra ku jeton ai zbukurohet. Feja dhe natyra lexoheshin si përgjigje për natyrën e njeriut. Vlerat ishin të larta dhe natyra ishte e pastër.

Por sa zgjati kjo gjendje? Në cilët shekuj ka ekzistuar kjo jetë?

Këtë përgjigje mund ta japin historianët, ajo që ne kërkojmë është një botë plot me njerzillëk dhe natyrshmëri. Nëse nuk e gjejmë dhe nuk punojmë për ta ndërtuar, atëherë ne do të shkojmë nga kjo botë si bilbili që ka harruar të këndojë.

Huntigtoni shpalli domosdoshmërinë e përfshirjes së të gjithë globit në procesin e modernizmit, qoftë kjo edhe me forcë. Kjo është ideologjia e globalizmit.

Qytetërimet në mënyrë të pashmangshme do të përplasen. Në këtë përplasje rezistenca më e fortë do të vijë nga bota islame, prandaj qytetërimi perëndimor do të mobilizohet me të gjitha forcat për ta shtypur këtë qëndresë.

Ai që nuk ka kauzën e vet, bëhet pre e kauzës së huaj; ai që nuk ka projektet e veta është i detyruar të zbatojë projektet e të tjerëve. Në këtë gjendje ka dy alternativa: ose bëheni ndërtues, ose material për ndërtim. Nëse nuk i mbajmë të gjalla dëshirat dhe pasionin për të ndërtuar botën tonë dhe nuk punojmë me gjithë forcën për të, atëherë do të vijë dikush të na përfshijë në procesin e tij qoftë edhe me forcë.

Jeta ju bën pyetje. Nëse nuk përgjigjeni, atëherë ajo ju shtyp. Kush qëndron, rrëzohet dhe kush rrëzohet shtypet, ky është ligji i xhunglës. Nuk vjen kush për t'ju ndihmuar të ngriheni. Ose do të qëndrosh fort përballë me besim, mendim dhe punë ose do të injorohesh. Ekzistenca në këtë botë është e mundur vetëm përmes respektimit të ligjeve të jetës.

*“Allahu e ka bërë shembull qytetin (e Mekës),
i cili ishte i sigurt dhe i qetë. Atij i arrinin ushqime
të bollshme nga të gjitha anët, por pastaj banorët e tij
i mohuan dhuntitë e Allahut dhe Ai i bëri të shijojnë urinë
dhe frikën, si ndëshkim për atë që bënë”*

(Nahl, 112)

Një Ajet

Njeriu është i prirur nga natyra të jetë mosmirënjohës ndaj të mirave dhe ankues ndaj të këqijave. Atij i janë dhuruar mirësi dhe begati pa fund, por nuk ua di vlerën dhe rëndësinë këtyre mirësive të mëdha që zotëron. Sapo përballet me një fatkeqësi, fillon të ankohet për problemet e shumta, duke i harruar kështu të gjitha mirësitë. Në fakt, duhej të ndodhte e kundërta, sepse mirësitë në raport me fatkeqësitë janë të panumërueshme. Ajeti kuranor: **“Njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet.”** (Adijjat, 6), shpreh pikërisht këtë natyrë të njeriut.

Në fakt, mosmirënjohja është veti e personave jobesimtarë. Por nuk mund të mohohet fakti që edhe besimtarët janë të prirur të jenë mosmirënjohës, sepse sapo na ndodh diçka e keqe, menjëherë revoltohemi duke e menduar si padrejtësi ndaj nesh të keqen e ndodhur.

Këtë gjendje pothuajse e përjetojmë të gjithë në raste fatkeqësie. Por përmes vështirësive dhe pengesave kuptojmë rëndësinë dhe seriozitetin e punës dhe jetës. Vështirësitë na afrojnë me Zotin dhe na bëjnë më të sinqertë me Të. Por problemi qëndron se kur kapërcehet vështirësia, harrohet gjithçka, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme. Allahu në Kuran vë në dukje qëndrimin e njeriut përballë fatkeqësisë dhe mirësisë. **“Kur Ne i japim njeriut të shijojë mëshirën Tonë e pastaj ia heqim atë, ai atëherë bëhet shpresëhumbur dhe mohues.”** (Hud, 9) **“Kur atë e godet e keqja, ligështohet fort.”** (Mearixh, 20.) Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: **“Zoti im më ka poshtëruar.”** (Fexhr, 16.) Kjo është gjendja e njerëzve të larguar nga Zoti gjatë vështirësive dhe problemeve në jetë. Normalisht që kjo gjendje nuk mund të mendohet për besimtarët.

Kurse ajeteti: **“Kur pas fatkeqësisë që e ka goditur atë, Ne i japim atij dhuntitë, ai me siguri do të thotë: ‘Gjynahet e mia janë larguar nga**

unë!’ atëherë bëhet i gëzuar dhe mendjemadh.” (Hud, 10.), tregon gjendjen e njeriut përballë mirësive. Shembull tipik i kësaj është Karuni.

Njeriu i pa mbujtur me besimin përballë ulje-ngritjeve të jetës, përfshihet nga ekstremiteti i gjërave: herë përfshihet nga pesimizmi dhe humbja e shpresës, herë nga mendjemadhësia dhe arroganca. Në këtë mënyrë, e shkatërron veten duke u përpëlitur sa nga një skaj në skajin tjetër. Kur përballet me vështirësi, pushtohet nga ndjenja e pamundësisë për të shpëtuar nga gjendja e keqe. Po ashtu, kur shpërblehet me mirësi, harron gjithçka dhe pushtohet nga mendjemadhësia. Të dyja këto janë gjendje psikologjike ekstreme.

Përballë këtyre, gjendja e besimtarit është krejt tjetër, sepse ai është i vetëdijshëm për mirësitë dhe vuajtjet me të cilat përballet në jetë. Dhe në këtë mënyrë ruan ekuilibrin. Në rast fatkeqësie, besimtari nuk bie në pesimizëm dhe në rast mirësie nuk pushtohet nga mendjemadhësia.

Bota e brendshme dhe e jashtme e besimtarit nuk ndikohet lehtë përballë sprovave të kësaj bote. Ai vazhdon rrugën drejt ahiretit, i vendosur dhe i bindur se pas çdo vështirësie ka dy mirësi. Gjithashtu, ai është i vetëdijshëm që mirëqenia dhe rehatia në këtë botë nuk është e përhershme. Gjendjen e besimtarëve e shpreh shumë bukur ajeti: **“(Nuk janë të tillë) vetëm ata që durojnë dhe bëjnë vepra të mira; për ata do të ketë falje dhe shpërblim të madh.”** (Hud, 11.)

Detyra e besimtarit është falënderimi përballë mirësive dhe durimi i bukur përballë fatkeqësisë. Falënderimi dhe mirënjohja ndaj Allahut është një detyrim që kemi ne ndaj Tij. Mirënjohja ndaj Allahut është shkak për shtimin e mirësive, si në planin individual ashtu edhe në planin shoqëror. Kurse jeta e mbushur me mosmirënjohje është shkak i fatkeqësisë, i problemeve dhe vështirësive.

Transmetohet nga Uthman bin Beshir (r.a.),

se Pejgamberi -sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

"Shembulli i atyre që zbatojnë ligjet e Allahut, në krahasim me ata që i neglizhojnë ato, është si shembulli i një grupi njerëzish që hipin në një anije. Disa qëndrojnë në kuvertë, kurse disa të tjerë në pjesën e poshtme të saj. Kur ata që janë poshtë kanë nevojë për ujë, u duhet të ngjiten lart për ta marrë, gjë që shqetëson ata që janë në kuvertë. Mendohen dhe vendosin të shpojnë një vrimë për të marrë ujë, në këtë mënyrë nuk do të shqetësojnë ata që janë lart. Nëse ata që janë në kuvertë qëndrojnë indiferentë, nuk ndërhyjnë për t'i ndaluar, të gjithë do të mbyten, por, nëse ndërhyjnë shpëtojnë të dy grupet." (Buhari)

Pejgamberi (a.s.), si në shumë raste të tjera edhe këtu përdor krahasimin, për ta përcjuar dhe për ta bërë sa më të qartë dhe të kuptueshëm mesazhin për audiencën. Ky krahasim i thjeshtë dhe i gjallë i Pejgamberit (a.s.), na jep një tablo të qartë për gjendjen e atyre që respektojnë ligjet e Allahut dhe atyre që i neglizhojnë ato. Këto dy grupe nuk janë të njëjtë, por përgjegjësia e grupit që i zbaton rregullat, nuk mjafton për të shpëtuar përfundimisht. Shpëtimi i tyre përfundimtar nuk varet vetëm nga zbatimi i rregullave për vete, por është i lidhur ngushtë edhe me rolin që do të luajnë në shoqëri, për të përmirësuar gjendjen e saj. Fryma islame nuk e toleron indiferentizmin ndaj së keqes që mund t'i kanoset shoqërisë.

Të gjithë ne jemi pjesë e ekipazit të një anijeje: familja është një anije, lagjja është një anije, atdheu është një anije, gjithë bota është një anije, ku një pjesë e ekipazhit është sipër, pra pjesë që jeton brenda kornizave të vendosura nga Allahu dhe për pasojë, mbart ndjenjën e përgjegjësisë sociale, kurse pjesa tjetër poshtë, e cila jeton jashtë këtyre kornizave dhe përbën rrezik potencial edhe për veten, por edhe për të tjerët. Qëndrimi pasiv përballë së keqes, çon në shkatërrimin e gjithë shoqërisë. Në fakt, veçoria kryesore që e dallon një shoqëri të qytetëruar, është aftësia e saj për t'i thënë ndal së keqes.

Islami i kundërvihet indiferentizmit dhe përtacisë në atë mënyrë, sa që e urdhëron çdo individ, të rregullojë me gojë ose me dorë, çdo gabim që sheh." Kushdo prej jush që konstaton një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. Nëse nuk mundet, le ta ndryshojë me gjuhën e tij. Nëse nuk mundet, le ta ndryshojë me zemrën e tij, por kjo tregon shkallën e dobët të besimit." Ky urdhër do të thotë ndërhyrje ndaj fenomenit në emër të mbrojtjes së të drejtës dhe drejtësisë. Dhe këtë ndërhyrje nuk e ka kufizuar, nuk e ka bërë të posaçme vetëm për një grup të ngarkuar me detyrë, por e ka shtrirë dhe përgjithësuar në të gjithë kolektivin.

Çdo njeri është anëtar i shoqërisë në të cilën jeton dhe çdo individ duhet të jetojë konform rregullave të shoqërisë në të cilën aderon.

Me një komunikim të thjeshtë, profeti Muhammed, paqja qoftë mbi të, na dërgoi një mesazh të përjetshëm, universal, multikulturor, për të vegjlit dhe të rriturit, burrat dhe gratë, të edukuarit dhe të paarsimuarit, duke na kërkuar të shikojmë përtej vetes sonë, të luftojmë indiferencën tonë, ta hedhim vëmendjen dhe shikimin jashtë dyerve tona dhe të ngrihemi të bëjmë ndryshimin, duke pranuar se nuk duhet t'i lejojmë keqbërësit të keqpërdorin botën tonë të bukur.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nëse nuk parandalohet, pengohet e keqja që mund të vijë nga një grup i vogël, dëmtohet e gjithë shoqëria.
2. Ndalimi i së keqes është shkak për të shpëtuar shoqërinë, por edhe ata që i bëjnë të këqijat.
3. Urdhërimi për të mirë dhe ndalim nga e keqja, është shkak për të shpëtuar edhe shoqërinë, por edhe individin.





BAJRAMI I KURBANIT

EDUKIMI I SAKRIFICËS

Gjatë jetës së tij, njeriu i paguan çmimet më të shtrenjta për hir të dashurisë. Kjo, sepse peshorja e dashurisë së vërtetë, është sakrifica. Dashuria që nuk ka kaluar nga sprovat e sakrificës, nuk është gjë tjetër veçse një pretendim i thatë.

Ndërsa besimi është dashuria më e madhe. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?” (Ankebut, 2.)

Me të vërtetë, besimi është mirësia hyjnore më e madhe, ndërsa sprovat janë kriter që mat nivelin e meritës së robit për këtë mirësi. Durimi, dorëzimi dhe mbrojtja e besimit me devotshmëri, që pritët prej besimtarit, është në varësi të çmimit që paguan ai për të arritur shpërblimet hyjnore. Pra, Allahu Teala, për t'i bërë robërit e Tij ta kuptojnë mirë madhështinë dhe vlerën e mirësisë së besimit, kërkon që ata të paguajnë një çmim për të.

Në bazë të kësaj, jeta në sytë e besimtarëve të vërtetë është një sistem sprovash ku matet niveli i dashurisë së besimit. Besimtari sprovohet vazhdimisht në çështjet se sa do të sakrifikojë e do të përpiqet në rrugë të Allahut dhe se në çmasë do të heqë dorë nga interesat e tij të kësaj bote për hir të Allahut, nëse kjo do të kërkohej. Dhe në varësi të suksesit në këto sprovat, do të bëhet i afërt i Allahut, madje në fund fare do të bëhet edhe miku i Tij.

Jeta plot ndodhi mësimdhënëse e Halilullahut, pra mikut të Allahut, Ibrahimit (a.s.), është një shembull

konkret i kësaj sakrifice. Kur Allahu Teala e zgjodhi Ibrahimin (a.s.), si mik të Tijin, melekët duke kujtuar tri çështjet, të cilat e zaptojnë zemrën e njeriut dhe e pengojnë miqësinë me Allahun, thanë:

“O Zot! Ai ka një shpirt dhe një emër! Si do t'i kapërcejë ai këto pengesa të tmerrshme të dashurisë dhe të bëhet miku Yt?”

Allahu Teala, duke e sprovuar Ibrahimin (a.s.), në këto tri çështje, të cilat njeriu e ka të vështirë t'i kapërcejë, ua shfaq melekëve dorëzimin e tij të palëkundshëm që ishte treguesi kryesor i miqësisë së tij dhe sakrifikimit të gjithë qenies së tij për Të.

Në fillim, e sprovoi me zjarrin e Nemrudit. Kur Ibrahim (a.s.), po hidhej në zjarr, melekët i shkuan dhe kërkuan ta ndihmonin. Mirëpo ai iu përgjigj:

“Nuk kam nevojë për ju! Kush ia dha zjarrit fuqinë e djegies? Zjarrin mund ta fikë vetëm ai që e ndez.” Më pas, kërkoi mbrojtje dhe strehim tek Allahu, duke thënë: “Sa vëll i mirë është Allahu!”. Pra, për të mbrojtur teuhidin e Allahut prej idhujtarisë, ishte gati të sakrifikonte shpirtin e tij duke u djegur. Ndërsa Allahu Teala i drejtohet zjarrit dhe e urdhëron:

“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” (Enbija, 69.) Dhe zjarri u kthye në një kopsht.

Më vonë, Allahu Teala e sprovon Ibrahimin (a.s.), me pasuri, duke i falur atij tufa të panumërta. Xhebraili (a.s.), i shkoi Ibrahimit në formën e një njeriu dhe i tha:

“Kush i ka këto tufa? A m'i shet mua?” Ndërsa ai tha:



“Këto tufa janë të Zotit tim. Përkujtoje Zotin tim dhe unë do t’i fal të gjitha.”

E gjithë pasuria e humbi vlerën e saj në sytë e Ibrahimit (a.s.), në këmbim të tri herë përkujtimi të Allahut, që bëri Xhebraili (a.s.). Me kënaqësinë që ndjeu prej përkujtimit (që bëri Xhebraili), Ibrahim (a.s.), i tha:

“Merri, qofshin të gjitha të tuat!”

Ndërsa Allahu Teala u fali begati edhe pasardhësve, edhe pasurisë së tij. Kurse vetë u bë “Ebu’l-Enbija”, pra babai i pejgamberëve. Që atëherë, çdo gjë e begatë përkujtohet si “begatia e Halil Ibrahimit”. Ndërsa, kur besimtarët duan të luten për begatinë e njëritjetrit, thonë: “Allahu të dhëntë begatinë e Halil Ibrahimit!”.

Së fundi, Allahu Teala e sprovoi Ibrahim (a.s.), me bërjen kurban të birit të tij, Ismailit (a.s.). Dhe të dy ata, babë e bir, treguan një dorëzim të plotë ndaj urdhrin hyjnor. Ndërkohë që ishin duke shkuar, njëri për të bërë kurban djalin e tij, ndërsa tjetri për t’u bërë kurban nga babai i tij, të dy së bashku e gurëzuan shejtanin e mallkuar, i cili përpiquej të prishte bindjen dhe dorëzimin e tyre ndaj Allahut. Ibrahim (a.s.), e shtriu djalin e tij të dashur, shpirtin e shpirtit



të vet, fliznin e bukur që kishte dalë prej qenies së vet dhe për të cilin kishte pritur me mall deri në vitet e pleqërisë, me qëllim për ta bërë kurban dhe të përmbushte urdhrin e Allahut. Por në momentin e fundit, Allahu Teala e përgëzoi me kalimin e sprovës dhe i dërgoi për kurban një dash prej xhenetit, duke i thënë:

“...O Ibrahim! Ti e përmbushe ëndrrën. Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!” (Saffat, 104-106.)

“...O Ibrahim!
Ti e përmbushe ëndrrën.
Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë
punëmirët! Kjo, me të vërtetë
ka qenë një sprovë e qartë!”

(Saffat, 104-106)

Në këtë mënyrë, Ibrahim (a.s.), tregoi se i bindet urdhrin të Allahut në çdo lloj sprove dhe se ishte gati të sakrifkonte shpirtin e vet dhe çdo gjë tjetër për Të. Duke i thyer fronet e përkohshme të kësaj bote në zemrën e vet, në vend të tyre ndërtoi fronin e dashurisë dhe miqësisë hyjnore. Kjo, sepse ai ishte plotësisht i vetëdijshëm se të gjitha mirësitë ishin veç një amanet hyjnor. Dhe ngurrimi në dorëzimin e amanetit të Zotit të vet, nuk mund të përputhej me dashurinë e besimit të vërtetë. Ja pra, falë këtij dorëzimi, dashurie dhe mbështetjeje tek Ai, Allahu e bëri Ibrahim (a.s.), Halil/Mik të Vetin.

MEDITIMI RRETH KURBANIT

Adhurimi i kurbanit, që është edhe një kujtim i shenjtë i Ibrahimit (a.s.), duhet t'i thellojë zemrat në meditimin e ndjenjës së sakrificës për Allahun. Kjo, sepse dashuria për Allahun Teala, i Cili na krijoi prej asgjëse dhe na fali mirësi të panumërta, kërkon të mos kursejmë asnjë lloj sakrifice.

Nuk duhet harruar se njeriu jeton në pronën e Allahut dhe sakrifica e tij për hir të Tij, prej pasurisë që është amanet i Tij, nuk është dhuratë që i bëhet Allahut, por një dhuratë që Allahu i bën robit të Tij. Kjo, sepse Allahu nuk ka nevojë për asgjë, kurse robërit kanë nevojë të pafundme për kënaqësinë dhe dashurinë e Tij.

Përveç kësaj, niveli i dashurisë sonë për Allahun varet nga vështirësitë, të cilat i përballojmë për hir të Tij dhe sakrificat që i bëjmë me dëshirë të plotë. Prandaj, Bajrami i Kurbanit, që është edhe koha, kur bëhet edukimi i sakrificës dhe mëshirës, është një fllad mëshire, i cili valëvit në detin e shpirtit tonë trashëgiminë e shenjtë të Ibrahimit (a.s.) dhe ndjenjën e dorëzimit absolut ndaj Allahut Teala. Ky fllad duhet t'i çojë të gjithë besimtarët në një vetëllogari të thellë shpirtërore.

Duhet ta mendojmë mirë faktin se Ibrahim (a.s.), u përgatit për të sakrifikuar dashurinë që kishte për djalin e tij; dhe nga ana tjetër, Ismaili (a.s.), e ofroi shpirtin e vet pa ngurruar aspak. Padyshim se urdhri hyjnor që na është dhënë me këtë ndodhi, është që të përpiqemi të qëndrojmë brenda kuadrit të këtij ajeti fisnik: **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit...”** (Teube, 111.)

Të paguash çmimin që kërkon Allahu duke sakrifikuar në rrugën e Tij me dëshirë të plotë, me qëllim që të fitosh kënaqësinë hyjnore, bëhet shkak i arritjes së pjekurisë së besimit dhe miqësisë së Allahut. Ndërsa miqësia e vërtetë, nuk përzihet me pasurinë apo mallin. Për këtë arsye, robi nuk duhet ta harrojë kurrë se e gjithë ajo që zotëron, i takon Allahut Teala dhe se atij i është dhënë për një kohë të shkurtër përgjegjësia e përdorimit; pra, se ai luan vetëm rolin e një ruajtësi të amanetit.

ATJE ARRIN VETËM PËRKUSHTIMI/ DEVOTSHMËRIA JUAJ...

Kuptimi leksikor i fjalës “Kurban” është “takarrub”, pra afrim. Për të arritur afrimin me Allahun dhe për t'u pranuar në atmosferën e miqësisë së Tij, Ai gjithmonë kërkon një kurban prej nesh, robërve të Tij. Pra, Ai dëshiron që ne të sakrifikojmë pasurinë, jetën dhe çdo mundësi që kemi.



“Puna më e dashur për Allahun, që bën biri i Ademit në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit, është derdhja e gjakut (prerja e kurbanit). Në Ditën e Kiametit, ky kurban do të vijë me brirët, thundrat dhe qimet e veta. Ndërsa gjaku i kurbanit, arrin kënaqësinë e Allahut dhe pranohet pa rënë ende në tokë. Pra, pritni kurbanët tuaj me zemër të kënaqur!”

Kjo është edhe arsyeja që qëllimi i kurbanit material, është shfaqja e dëshirës së afrimit me Allahun duke iu bindur urdhrimit hyjnor. Kurban, i cili pritet me këtë qëllim, fiton një vlerë të veçantë pranë Allahut. Faktin se ky duhet të jetë qëllimi i pastër i besimtarit për kurbanin, e shpreh qartë ky ajet fisnik:

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...” (Haxh, 37.)

Prandaj, thelbi i adhurimit të kurbanit, është dorëzimi dhe bindja me gjithë shpirt dhe pa kushte ndaj Allahut Teala. Gjithashtu, ajo që do të ngrihet pranë Allahut dhe do të pranohet prej kurbanit, është pjekuria shpirtërore e robit.

Për shkak se prerja e kurbanit shpreh dashurinë që ndodhet në zemër për Allahun, është shumë e rëndësishme që ky adhurim të kryhet me respekt, delikatesë dhe edukatë. Për këtë arsye, më parë duhet që brenda mundësive, kurbanët t'i zgjedhim prej kafshëve të hijshme, të shëndetshme dhe të bëshme, sepse Allahu Teala ka urdhëruar:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Al 'Imran, 92.)



“O besimtarë!
Jepni pa u kursyer nga të mirat
që keni fituar dhe nga ato që jua kemi
nxjerrë Ne nga frytet e tokës.
Mos dhuroni nga ato gjëra
të pavlefshme të pasurisë suaj
e të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe
veçse symbyllur. Ta dini se Allahu
është i Vetëmjaftueshëm
dhe i Denjë për çdo lëvdatë.”
(Bekare, 267.)

Me këtë, Allahu Teala na e bën të ditur se sakrificat që do të bëjmë në rrugën e Tij, mundësisht të jenë prej gjërave të bukura e të mira që i duam dhe i pëlqejmë. Kjo, sepse sadakatë, dhurimet dhe kurbanët që bëhen larg dyfaqësisë, shkojnë në dorën e plotfuqishme të Allahut, ende pa kaluar në dorën e nevojtarit që ia japim. Allahu Teala, në një ajet fisnik, shprehet: **“... Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet...”** (Teube, 104) Prandaj kërkohet që dhurimet të bëhen me edukatë dhe ndjenja të larta, sikur je duke ia dhënë të Përhershmit e jo të përkohshmëve.

Një ditë, nëna jonë Aishja (r.anha.), dëshiroi të jepte si sadaka një sasi mishi, të cilit i kishte ndryshuar pak era. Ndërsa Rasulallahu (a.s.), e qortoi duke i thënë:

“O Aishe! A do të falësh diçka që nuk e ha as vetë?”
(Hejthem, III, 113)

Në lidhje me këtë çështje, shprehet qartë edhe ky ajet fisnik:

“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t’i

pranonit ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.” (Bekare, 267.)

Edhe kjo ngjarje, që ka ndodhur midis dy djemve të Ademit (a.s.), Habilit dhe Kabilit, është shumë domethënëse në këtë çështje:

Kabili donte të martohej me motrën e tij të njëjtit bark. Ndërsa Habili e paralajmëroi se kjo nuk ishte e lejueshme (nuk ishte hallall) dhe se duhej të martohej me një prej motrave të barkut tjetër. Mirëpo Kabili nuk e mori parasysh këtë paralajmërim dhe këmbënguli në pretendimin e vet se ky që po bënte ishte një veprim i drejtë. Për këtë arsye, me qëllim që të bëhej e qartë se kush kishte të drejtë, Habili propozoi t’i kushtonin Allahut një kurban.

Në atë kohë, kurban i bëhej prej mallit që gjendej në varësi të zanatit që kishin. Gjërat që kushtoheshin si kurban, vendoseshin në majë të një mali. Kur shkohej pas një kohe të caktuar për t’u kontrolluar, shihej se kurban i ishte pranuar prej Allahut Teala ishte zhdukur nga vendi, në sajë të një zjarri që binte nga qielli dhe e shkrumbonte.

Habili kishte një tufë me dhen dhe për kurban zgjodhi dashin më të pashëm dhe më të majmë. Ndërsa Kabili, i cili merrej me bujqësi, zgjodhi si kurban një tufë me kallëza të dobëta gruri.

Pas një kohe të caktuar, Habili me Kabilin shkuan të kontrollonin kurbanët që kishin lënë. Dashi që kishte bërë kurban Habili, ishte pranuar, ndërsa kallëzat e dobëta të grurit, që kishte bërë kurban Kabili, ishin aty ku i kishte lënë. (Ibn Sa’d, I, 36.)

Ajo që do të ngrihet dhe do të pranohet tek Allahu, është devotshmëria e robit. Ai që nuk bën një jetë të devotshme, ka probleme serioze në itikad/besim, ahlak/moral dhe muamelat/vepra. Kështu që edhe adhurimet dhe punët e tij nuk janë në rregull, sepse me vizore të shtrembër nuk bëhet vijë e drejtë. Prandaj, është kusht që jeta të bëhet në përputhje me urdhrat hyjnorë dhe devotshmëri të lartë. Ndërsa ajo që kërkon devotshmëria, është që adhurimet dhe veprat e mira të bëhen me “sinqeritet”, pra me vetëdijen, se ndodhesh gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore.

Një besimtar që bën nijetin për kurban, më parë duhet të ketë ndjenja të sinqerta dhe duhet të ruhet shumë mirë nga futja e gjërave të përkohshme në nijetin e vet. Kurban i nuk duhet të pritët për shkaqe të kota, si turpi nga të afërmit apo komshinj të apo rënia e autoritetit në shoqëri etj. Qëllimi i vetëm duhet të jetë kënaqësia e Allahut Teala. Pra, nuk duhet të harrojmë për asnjë moment se ajo që do ta bëjë kurbanin të pranueshëm, është nijeti i pastër.



Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

"Puna më e dashur për Allahun, që bën biri i Ademit në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit, është derdhja e gjakut (prerja e kurbanit). Në Ditën e Kiametit, ky kurban do të vijë me brirët, thundrat dhe qimet e veta. Ndërsa gjaku i kurbanit, arrin kënaqësinë e Allahut dhe pranohet pa rënë ende në tokë. Pra, pritni kurbanët tuaj me zemër të kënaqur!" (Ibn Maxhe, Edahi, 3; Tirmidhi, Edahi, 1/1493.)

Kjo do të thotë se kurbanët duhet t'i presim pa ndërje edhe shqetësimin më të vogël në zemër, madje me dashuri për Allahun, me shijen e besimit dhe me ndërgjegje të pastër për sakrificën që po bën për hir të Allahut.

Parë nga një këndvështrim tjetër, kurbanit është një nga simbolet e jetës fetare. Rëndësia dhe vlera e madhe që i jepet kurbanit nga myslimanët, është prej besimit, sepse në një ajet fisnik është urdhëruar: **"...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij."** (Haxh, 32)

Nënvlerësimi apo moskryerja e adhurimit të kurbanit nga ana e disa njerëzve të pakujdesshëm, me fjalët më të lehta, mund të quhet "injorancë"; ndërsa emërtimi i këtij adhurimi me emra të shëmtuar, si "bajram i përgjakur", janë fjalë shumë të rrezikshme, që mund të të çojnë edhe në kufër/mohim. Çdo besimtar i pasur e ka për detyrë të presë kurban, sepse paralajmërimi i Rasulallahut (a.s.), në lidhje me këtë çështje, është

shumë i rreptë:

"Kush nuk pret kurban, megjithëse i ka të gjitha mundësitë ekonomike, të mos afrohet në namazgjanë tonë!" (Ibën Maxhe, Edahi, 2.)

Nga kjo, kuptojmë se një njeri koprrac, i cili nuk pret kurban për hir të Allahut, megjithëse Ai i ka falur mirësi të panumërta, nuk ka vend në shoqërinë islame. Prerja e kurbanit, është vaxhib/detyrë e çdo myslimani të pasur, që i plotëson kushtet. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

"O Njerëz! Çdo vit, çdo shtëpi e ka vaxhib të presë kurban." (Ibën Maxhe, Edahi, 2; Tirmidhi, Edahi, 18/1518.)

RREGULLAT MORALE TË KURBANIT

Pikësëpari, asnjëherë nuk duhet harruar se kurbanit është një adhurim që bëhet për hir të Allahut. Për këtë arsye, entuziazmi shpirtëror i adhurimit në këto ditë të shenjta duhet ruajtur me përmendje dhe falënderime të Allahut. Përveç kësaj, ata që munden dhe dinë, duhet ta presin vetë kurbanin, duke u përpjekur ta ndjejnë nga afër shpirtin dhe kuptimin e kurbanit. Pejgamberi ynë (a.s.), në haxhin e lamtumirës, preu me dorën e vet 63 prej 100 kurbanëve. Ata që nuk mund ta presin vetë, duhet t'ua besojnë këtë detyrë atyre që munden dhe mundësisht, në kohën e prerjes të qëndrojnë pranë kurbanit me ndjenja respekti dhe dashurie.

Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

"O Fatime! Çohu dhe qëndro pranë kurbanit! Dije mirë, se me pikën e parë të gjakut që bie në tokë, falen të gjitha gjynahet (e vogla), që ke bërë." (Hakim, IV, 247/7524; Hejsemi, IV, 17; Bejhaki, Shuab, V, 483.)

Nga ana tjetër, duhet që edhe me kafshët e kurbanit të sillemi mirë, të mos i trembim, t'i ushqejmë dhe t'i çojmë në vendin e flijimit pa i torturuar. Kurbanit duhet ta themi me thikë të mprehtë, me qëllim që të mos e torturojmë. Pejgamberi ynë (a.s.), ka porositur që thikat t'i mprehim mirë dhe larg syve të kurbanit. Gjithashtu, ai (s.a.s.), na ka dhënë edhe këto porosi:

"Kur dikush prej jush dëshiron të thërë kurban, le ta bëjë shpejt!" (Ibën Maxhe, Zebahih, 3.)

"Allahu ka urdhëruar që çdo gjë të bëhet në mënyrën më të mirë... Kur të therni (kurban), bëjeni në mënyrën më të mirë! Çdonjëri prej jush le ta mprehë mirë thikën dhe ta qetësojë kurbanin!" (Muslim, Sajd, 57; Tirmidhi, Dijat, 14/1409.)

DHURIM, MËSHIRË DHE ALTRUIZËM

Për shkak se kurbanit nënkupton sakrificën prej pasurisë dhe jetës, ai është një motivim i rëndësishëm

i dhurimit dhe mëshirës. Ndërsa fitimi i vërtetë, që i takon robrit në kurban, është pjesa të cilën ua dhuron nevojtarëve. Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë të vërtetë:

Familja e Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), kishte prerë një dele. Pasi dhuruan një pjesë të mirë, Pejgamberi (a.s.), pyeti, se çfarë kishte ngelur prej deles. Aisheja (r.anha.), u përgjigj:

“Ka ngelur vetëm shpatulla.”

Pas kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha:

“Pse nuk thua o Aishe, se përveç shpatullës gjithçka na ka ngelur neve!” (Tirmidhi, Kijame, 33.)

Është e pëlqyeshme që mishi i kurbanit të ndahet në tri pjesë. Një e treta t’u jepet të varfërve, një e treta familjes dhe një e treta komshinjve, miqve dhe udhëtarëve. Mirëpo, ata që kanë familje shumanëtarëshe dhe janë nevojtarë, mund ta mbajnë komplet kurbanin për familjen e vet. Megjithatë, edhe në këtë rast, është e pëlqyeshme të ndahet sadaka për disa të varfër.

Nga ana tjetër, besimtarët që kanë mundësi dhe kohë, kurbanët që i kanë vaxhib, duhet t’i presin në vendin (qytetin/fshatin) e vet. Përveç kësaj, brenda mundësive, duhet të bëhen përpjekje që për të larguar fatkeqësitë, belatë dhe sëmundjet, për të shprehur falënderimin ndaj mirësive të Allahut dhe për t’u zgjatur dorën e ndihmës vëllezërve të fesë, të priten kurbane dhe të shpërndahen si sadaka tek nevojtarët në të katër anët e botës. Duke filluar që nga Afrika, sot në shumë vende ku mbizotëron uria dhe mjerimi, shumë myslimanë po presin me mall shfaqjen e vëllazërisë islame, madje një pjesë e këtyre vëllezërve tanë, edhe pse një herë në vit, arrijnë të shijojnë mishin në sajë të bajramit të kurbanit.

Një miku ynë që erdhi për vizitë në Stamboll, na tha:

“Më besoni, ka shumë njerëz që ju presin të vini në këtë bajram.” Me këto fjalë, ai solli tek ne thirrjen e vëllezërve tanë në ato vende të vuajtura dhe na kujtoi përsëri përgjegjësinë e vëllazërisë fetare.

Muslimani zotëron një botë shpirtërore plot mëshirë dhe duke edukuar shpirtin e tij, shpërndan paqe tek të gjitha krijesat. Ai është një njeri altruist, i cili i konsideron si përgjegjësi të vetën, të gjithë vëllezërit e tij të fesë në çdo vend të botës. Treguesi më i mirë i kësaj gjendjeje në këto ditë të bekuara, është që në sajë të kurbanit, të bëhemi shkak që çdo motër e vëlla i ynë i fesë, të përjetojë gëzimin e bajramit në çdo vend të botës ku arrin zemra jonë.

Për të fituar kënaqësinë hyjnore në këto ditë të bekuara, duhet të përpiqemi të fusim në botën tonë shpirtërore jetimët, të vetmuarit, të varfrit, nevojtarët

dhe veçanërisht, miliona prej vëllezërve e motrave tona të fesë, të cilët po vuajnë padrejtësinë dhe paspirtshmërinë njerëzore të shekullit tonë. Kjo është detyra jonë vëllazërore, të cilën duhet ta kryejmë qoftë edhe duke dhuruar një pjesë të vogël prej mishit të kurbanit.

Të mos harrojmë se Pejgamberi ynë (a.s.), i cili ndjente mëshirë për umetin e tij më shumë se një nënë për fëmijën e saj, bënte kurban edhe për vete, edhe për të dobëtit prej umetit të vet. (Ebu Daud, Edahi, 3-4/2792; Ibn Sa’d, I, 249.)

Të mendojmë pak se me çfarë ndjenjash të larta vetëmohimi do ta kishin kryer adhurimin e kurbanit sahabët fisnikë, të cilët u edukuan nga dora e Pejgamberit (a.s.), po të jetonin në kohën tonë. Pra, si umeti i Muhamedit (a.s.), që jemi, duhet të përpiqemi, që brenda mundësive, të tregojmë edhe ne butësinë, mëshirën dhe bujarinë që Pejgamberi ynë (a.s.), e tregoi ndaj atyre, të cilët nuk mund të bënin kurban. Kjo përpjekje do të jetë shprehja më e bukur e falënderimit tonë ndaj Allahut Teala, i Cili na bëri prej umetit të një pejgamberi kaq të mëshirshëm.

Allahu Teala mos na ndaftë prej gjurmëve të Pejgamberit tonë (a.s.), në këtë botë dhe prej hijes së lumturisë së tij në botën tjetër. Bajrami më i madh për ne, do të jetë kur të mblidhemi nën flamurin e Hamdit/falënderimit të Pejgamberit (a.s.) dhe të meritojmë shefaatin/ndërmjetësimin e tij.

Të mos harrojmë se kjo botë është vendi i sakrificës. Dhe si shpërblim për këtë sakrificë, Allahu Teala na fton ne robërit e Vet, në Daru’s-Selam, pra në vendin e lumturisë dhe shpëtimit, në xhenetin e Tij. Për ta merituar këtë ftesë për në xhenet, Allahu kërkon që ne të jetojmë duke u përpjekur t’i kthejmë bajramet e përkohshme në kapitalin e bajrameve të përjetshme. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar:

“Në Ditën e Kiametit, për buajt shumëngjyrësh, pra për mohuesit me qëllime të këqija dhe dyftyrëshit, do të ketë një bajram kurbanit të tmerrshëm. Atë ditë, për buajt (të shkujdesurit larg Allahut), do të ketë vdekje, ndërsa për besimtarët është ditë bajrami!”

Allahu na e bëftë të mundur t’i presim kurbanët duke marrë shembull sakrificën, dorëzimin, kënaqësinë, devotshmërinë dhe dashurinë në zemrën e Ibrahimit (a.s.). Gjithashtu, na bëftë prej atyre që përhapin paqen dhe qetësinë e bajramit në zemrat e të vuajturve, nevojtarëve dhe vëllezërve e motrave tona të fesë, duke u dhuruar prej të mirave që na ka falur Allahu Teala. Allahu na i gëzoftë fytyrat tona dhe të gjithë botës islame me lumturinë dhe gëzimin e bajrameve të vërteta...

Amin!..

PROBLEMET E BESIMIT NË PERIUDHËN MODERNE

Prof. dr. Sellm Ozarsllan

Njeriu në periudhën e shkencës dhe të teknologjisë po largohet çdo ditë e më shumë nga Krijuesi, nga feja, nga vetja dhe nga bota shpirtërore, duke u zhytur kështu në një krizë të rëndë shpirtërore dhe psikologjike.

Shkaku kryesor i kësaj krize padyshim që është botëkuptimi pozitivist dhe materialist, i cili propagandon, i ndihmuar edhe nga mjetet komunikative, braktisjen e vlerave shpirtërore. Nëse në një shoqëri vendoset kjo ideologji, atëherë është hapur dera e gjithë problemeve. Individët në krizë shpirtërore dhe të pakënaqur nga jeta sociale përbëjnë burimin kryesor të problemeve shoqërore. Në një shoqëri ku jetojnë njerëz të pakënaqur nga jeta, shfaqet pësjtjellimi, kaosi dhe prishja e harmonisë sociale. Në këtë mënyrë, fillon të zhvillohet një stil tjetër jetese.

Ndër Rrymat filozofike dhe ideologjike, që janë bërë shkak të krizave psikologjike, sociologjike dhe fetare mund të numërojmë: materializmin, pozitivizmin, darvinizmin, panteizmin, frojdizmin, ateizmin, deizmin, shekullarizmin, nihilizmin, satanizmin, ekzistencializmin e të tjera rryma me burim perëndimor. Mendoj se

do t'i shërbente lexuesit njohja shkurtimisht e këtyre rrymave.

Materializmi: Është botëkuptimi filozofik i hedhur dhe zhvilluar nga Karl Marks dhe F. Engels. Materializëm është quajtur doktrina që në themel të ontologjisë vendos materien, duke i dhënë asaj një rol parësor, aktiv dhe dinamik, kurse shpirtin dhe idenë, ose e konsideron si shfaqje të materies, ose nuk e pranon fare.

Pozitivizmi: Rrymë filozofike e hedhur nga Auguste Comte. Kjo rrymë e redukton njohjen njerëzore vetëm në pesë organet shqisore, duke mohuar në këtë mënyrë botën metafizike. Sipas kësaj teorie, çdo njohuri që sigurohet jashtë shqisave është teologjike, metafizike dhe konsiderohet produkt imagjinar. Sipas këtij mendimi, njeriu ka kaluar nëpër tri faza: teologjike, metafizike dhe pozitiviste. Shkalla e fundit dhe kulminante e mendimit është pozitivizmi.

Evolucioni : Është doktrina e hedhur nga Darvini, e cila mbështet teorinë e evoluimit të krijimit.

Panteizmi: Fjala panteizëm është përdorur për herë të parë nga irlandezi J. Toland. Sipas kësaj teorie, Zoti

dhe lënda janë një.

Frojdizmi: Sigmund Freud është një neurolog austriak, i cili zhvilloi teorinë e psikoanalizës. Ai e kërkonte zgjidhjen e problemeve shpirtërore në dëshirat e ndrydhura në subkoshiençë. Për këtë, organizonte seanca terapeutike, të cilat synonin nxjerrjen e ndjenjave nga subkoshienca në koshiençë. Ai i shikonte njohuritë fetare si pengesë për zhvillimin e njerëzimit.

Ateizmi: Është doktrina që mohon ekzistencën e një genieje mbinatyrore, që ka krijuar gjithësinë.

Deizmi: Është doktrina që pranon ekzistencën e Zotit, por mohon librat e shenjtë, fenë e organizuar, mrekullitë dhe elementët e tjerë karakteristikë për fetë tradicionale.

Shekullarizmi: Është doktrina që ka për qëllim heqjen e rolit të fesë nga jeta sociale.

Nihilizmi: Është doktrina që mohon çdo parim, normë morale dhe vlerë kulturore. Sipas kësaj teorie, njeriu nuk mund ta njohë realitetin, ndaj është e domosdoshme që, për njohjen e realitetit, vlerat të mos merren në konsideratë. Kjo rrymë në politikë nuk njeh asnjë autoritet, në moral asnjë vlerë dhe në shoqëri asnjë normë.

Satanizmi: Shpreh një sistem besimi që ka lindur si reagim kundër feve hyjnore dhe që djallin e konsideron si konkurent të Zotit.

Ekzistencializmi: Është një doktrinë irracionaliste borgjeze, që ka si objekt ekzistencën njerëzore në nivelin e individit të pandikuar nga kushtet e jashtme, të zhveshur nga çdo lloj vlere.

Të gjitha rrymat e mësipërme kanë pasur ndikim të madh në prishjen e ekuilibrit besim-arsye, besimshkencë dhe besim-jetë dhe, siç thotë mendimtari dhe poeti i madh turk me origjinë shqiptare M. Akif, të gjitha këto rryma janë bërë pengesë për ngjitjen e ndjenjave në nivele më të larta, duke i kufizuar ndjenjat vetëm në nivelin e egos. Botëkuptimet që e kufizojnë jetën vetëm në këtë botë, duke mohuar çdo vlerë shpirtërore nuk mund të jenë zgjidhje për problemet e njerëzimit.

Ndalimi i këtyre ndikimeve ideologjike mbi njerëzit është i mundur vetëm përmes rikthimit të Kurani, i cili e këshillon njeriun të përdorë mendjen sipas kritereve racionale dhe të zhvillojë shpirtin e disiplinën shkencore.

Siç dihet, Islami, si hallka e fundit e zinxhirit hyjnor, është fe e arsyes dhe e mendjes së shëndoshë, që jo vetëm se është e distancuar totalisht nga bestytnitë, legjendat dhe mitet, por u ka hapur një luftë të ashpër atyre. **“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhënë dritën me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj? Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë.”** (En’am, 122)

Islami u drejtohet njerëzve me mendje të shëndoshë. Kushti i parë i lindjes së përgjegjësive në Islam, është mendja. Prandaj, në Islam mendja nga feja dhe feja nga mendja janë të ndërvarura. Parimet kryesore të fesë mund të vërtetohen vetëm përmes mendjes. Po ashtu edhe mësimet e fesë mund të bëhen të kuptueshme vetëm përmes mendjes. Prandaj në Islam mendja ka një pozitë dhe vend të veçantë.

Përmes Kuranit dhe mendjes së shëndoshë mund ta ndërpresim furinë e ndikimit të rrymave të devijuara, që rrezikojnë seriozisht të ardhmen e njerëzimit sot. Prandaj, duhet ta mbartim besimin e tevhidit në jetën e njerëzve. Tevhidi shpreh nënshtrimin e plotë të njeriut ndaj Allahut, si në aspektin e mendimit, ndjenjave, shpirtit, trupit, teorisë dhe praktikës. Pra, nënshtrimin në të gjitha aspektet e jetës. **Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.”** (En’am, 162-163)

Kjo fe duhet t’i ofrohet njerëzimit me të gjitha vlerat dhe detajet që mbart. Përmes këtij besimi, njerëzimi mund të dalë nga kriza dhe pëshjellimi ku ndodhet, duke i dhënë jetës një kuptim të ri dhe duke rifituar përsëri ndjenjën e sigurisë. Besimi në një Zot të vetëm, Krijuesit dhe Rregulluesit të gjithçkaje, i jep së pari njeriut ndjenjën e sigurisë. Një besimtar nuk mund të ketë hezitime dhe frikë për të ardhmen. As vdekja nuk mund t’ia trondisë sigurinë dhe qetësinë një personi besimtar.

Qëllimi i krijimit të njeriut është njohja e krijuesit, e botës dhe urtësisë së krijimit. Përsosja e njeriut është në raport të drejtë me realizimin e këtij qëllimi.

Prej njeriut si krijesa më çmuar, kërkohet ibadeti me respekt dhe dashuri ndaj Allahut, ruajtja dhe zhvillimi i sjelljeve njerëzore, si dhe shërbimi ndaj njerëzimit.

Njerëzimi ka rënë shpesh në kriza shpirtërore dhe Kurani është i mbushur me historitë e popujve të hershëm, të cilët kanë rënë në shthurje dhe mosbesim. Kurani e ka konsideruar largimin nga parimet e fesë si zvetënim dhe çoroditje totale. **“O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë.”** (Nisa, 136)

Përballë ateizmit dhe “izmave” të tjera të ngjashme, që mbrojnë materializmin duke injoruar plotësisht botën shpirtërore të njeriut, duhet kundërvënë Tevhidi i Kuranit. Vetëm përmes Tevhidit mund të fitojë njerëzimi qetësinë e humbur, vetëm përmes tij mund të gjejë përsëri jetën.

PENGESAT NË RRUGËN E THIRRAJES ISLAME

Ebubekir M.

Rruga e thirrjes islame është një rrugë e gjerë dhe e gjatë. Tabelat udhërrëfyese, që duhen pasur kujdes janë anash rrugës. Interpretimet e deformuara dhe botëkuptimet e zvetënuara, ndryshe nga rruga e gjerë dhe e pastër e Islamit, janë rrugë të ngushta me kthesa që të çojnë në humnerë. Ti vazhdo rrugën tënde, duke ndjekur tabelat anash saj dhe mos dil nga kjo rrugë.

Muxhahidi vepron i lirë, duke refuzuar robërimin ndaj robit.

Gjithmonë do të ekzistojë një grup, që do të kapet fort mbas Kuranit dhe rrugës së Muhamedit (a.s.). E rëndësishme është pjesëmarrja në këtë grup.

Nëse braktiset xihadi, myslimanët fillojnë ta përdorin energjinë e destinuar kundër armikut, ndaj njerëzve dhe si përfundim, përçahen. Por, nëse zhvillohet xihadi në rrugën e Allahut, myslimanët bashkohen si një trup i vetëm.

Bindjuni udhëheqësve që janë prej jush, edhe nëse e keni të vështirë.

Myslimani i devotshëm është i vetëdijshëm për pozitën e lartë dhe duhet të frikësohet që të mos bjerë nga kjo pozitë.

Njeriu është i dobët. Nëse nuk lufton kundër dëshirave, të cilat janë të pafundme, atëherë rrezikon

të bjerë në gjendje të keqe.

Myslimanët janë si një zemër e vetme. Nuk është e drejtë vetmia dhe largimi nga bashkësia.

Largimi nga bashkësia islame mund të bëhet shkak për t'u tretur në bashkësinë joislame.

Kush ecën mbi rrugën e drejtë nuk bie në dyshime, kurse rruga e keqe është e shtrembër, dredha-dredha.

Asnjë mëkat mos e konsidero të vogël dhe lufto gjithmonë me nefsën.

Në thirrjen islame duhet urtësi, kujdes, delikatesë dhe mirësjellje.

Në predikimin e Islamit, në vend të ligjërit të zburuar të përdoret ligjërit i qartë dhe i rrjedhshëm.

Merr pjesë në mbledhjet dhe tubimet e njerëzve, të cilët janë dhënë pas kësaj bote, për t'u treguar Islamit.

Qëndroni afër dhe interesohuni për njerëzit që janë në kërkim të së vërtetës, por nuk arrijnë ta gjejnë.

Këshilloje shokun, i cili është zhytur në detin e dëshirave dhe epsheve.

Thirja islame ka nevojë për persona të drejtë, të vendosur, të qëndrueshëm dhe të ditur. Përndryshe, shoqëria islame nuk mund të krijohet.

Kur ftoni në Islam, këshillojini njerëzit me Kuran dhe Sunet. Mos u kapni pas mëkateve të vogla, për të cilat dijetarët nuk janë në konsensus për dispozitën e tyre.

Mospranimi i argumenteve të qarta është shkak për përçarje.

Mbajtja e fjalës kuptohet kur përballësh me atë problem.

Myslimani që është i sigurt në rrugën e tij, është i qetë, modest dhe shpërblimin e pret prej Allahut kurse ai që nuk është i sigurt në rrugën e tij, është i shqetësuar dhe mendjemadh.

Zemra që shkon pas dëshirave dhe gjërave të dyshimta është e hapur ndaj çdo lloji intrige, kurse zemra që lufton me egon është e qetë.

Fjalët e qarta të mbrojnë nga keqkuptimet.

Mos merr për bazë fjalë, të cilat e kanë të ulët nivelin e vërtetësisë.

Ki kujdes nga institucionet dhe organizatat, që në tabelë shkruajnë "Islam", por që fshehin ajetet e Allahut dhe përpiqen ta tregojnë veten si jomyslimanë.

Nëse ftohesh për t'u bërë anëtar në një organizatë, shiko besimin e liderëve të organizatës.

Gjej shokë që të këshillojnë dhe të qortojnë kur je gabim.

Ato që dinë të tjerët për ty, të mos i kalojnë ato që di ti për veten.

Mos u përpiq të zbulosh gabimet që ka fshehur shoku, përndryshe edhe Allahu e ngre perden që mbulon gabimet e tua.

Myslimani është pasqyrë e myslimanit. Syri shikon gjithçka, kurse veten e shikon vetëm në pasqyrë.

Ai që merret me të metat e të tjerëve, ka vetë shumë të meta.

Debatet dhe polemikat që bën me një shok, mos i ndaj me të tjerët.

Nëse gjatë një debati personi përballë nuk i pranon argumentet e qarta, atëherë mos e zgjat diskutimin me të.

Personi që nuk e përmirëson veten me argumentet e qarta, e dëmton grupin.

Kush ka mangësi dhe nuk përpiqet t'i rregullojë, jeton me frikën se do ta kritikojnë dhe kritikën e merr gjithmonë si sulm.

Vepra e mirë është dritë, nëse mbi këtë dritë fryn era e mendjemadhësisë, ajo shuhet dhe çdo gjë bëhet errësirë.

Kënaqësia nga lëvdatat që të bëjnë të tjerët dhe shfaqja e të metave me arsyen se nuk jeni mendjemadh, në fakt është një shfaqje në një formë ndryshe e mendjemadhësisë.

Nëse shejtani arrin t'i rrënjosë njeriut njërin nga këto

tre vese, thotë: "Nuk dëshiroj asgjë tjetër nga ai njeri!" Këto vese janë: mendjemadhësia, harrimi i mëkateve dhe mendimi se ka shumë vepra të mira.

Myslimani nuk merret me publikimin e veprave të tij me qëllim që ta dinë të gjithë.

Myslimani gjykon qëllimin e çdo veprë të mirë që bën.

Të gjitha të fshehtat janë të hapura tek Allahu.

Nëse nuk kontrollon egon, humbet lirinë.

Pritshmëritë e kësaj bote janë një në këmbë dhe pranga në duar, prandaj shpëto prej tyre.

Nëse sjelljet dhe veprat janë të drejta, nuk ka nevojë për t'i vërtetuar me fjalë.

Gjuha duhet të jetë përkthyesë e zemrës.

Tek Allahu më vlerë ka ajo që thotë zemra, sesa ajo që thotë gjuha.

Nëse ke të vërteta për të thënë, mos hesht, por nëse nuk ke të vërteta për të thënë, mos fol.

Njerëzit mund të hyjnë në Islam përmes gjuhës dhe mund të dalin prej tij po përmes gjuhës. Prandaj ki kujdes gjuhën dhe mos i jep liri të plotë.

Të janë dhënë dy veshë dhe një gojë prandaj dëgjo shumë e fol pak.

Personi që e konsideron fjalën veprim, nuk flet shumë.

Zemërohu për hir të Allahut, por për të mos u zemëruar për veten, pajisu me mantelin e devotshmërisë.

Diluni për zot shokëve që janë të sinqertë, por që njohuritë nuk i kanë të shëndosha.

Mbuloji të metat e shokut.

Mos u fut në polemika boshe me shokun tënd. Sido mos në publik kurrë, sepse kjo gëzon armikun.

Shikimi i të metave të të tjerëve dhe mospranimi i të metave vetjake, të çon në humbje nga rruga e drejtë.

Nëse dëshiron të kesh besim të shëndoshë, duhet të njohësh mirë veçoritë e xhahilijetit.

Nëse dëshiron të kuptosh mirë të sotmen, mëso mirë historinë.

Myslimani nuk bëhet kandidat për lider, por tregohet.

Nuk është e drejtë të akuzosh të parët, se kanë bërë gabim për të mbuluar gabimet tuaja.

Kërko prej Allahut të të ruajë prej injorancës.

Mos harro që dera e pendimit është gjithmonë e hapur dhe dritë në mes të errësirës.

Marrëdhëniet besim-moral në Islam

Prof. dr. Iljas Çelebi

Qëllimi i fesë islame është sigurimi i lumturisë së njeriut në të dyja botët dhe Allahu përmes pejgamberëve ka treguar rrugën e realizimit të këtij qëllimi. Pejgamberët na kanë mësuar parimet e fesë, na kanë shpjeguar karakterin e marrëdhënies sonë me Zotin, me veten, me shoqërinë dhe me natyrën. Parimet e fesë shprehin pozicionin tonë ndaj Allahut dhe kozmosit.

Në të njëjtën kohë, pejgamberët na kanë mësuar se çfarë duhet të bëjmë, si duhet të sillemi dhe si duhet të jetojmë për të fituar lumturinë e dybotëve. Të gjitha këto, në Kuran shprehen me termin "Salih amel" (vepër e mirë).

Me "Salih amel" nënkuptohet çdo veprim dhe sjellje e mirë, e dobishme dhe që është në harmoni me urdhëresat fetare. Veprat që këshillon dhe urdhëron feja përfshihen në termin "salih amel". E kundërta e kësaj janë veprat e ndaluara, të dëmshme dhe të dënueshme nga ana fetare.

Vepra dhe sjellja e mirë që mund të demonstrojë njeriu, ose ka lidhje me Zotin dhe në këtë rast quhet ibadet, ose ka lidhje me njeriun dhe në këtë rast quhet moral. Tre parimet e fesë janë përmbledhur në hadithin e famshëm të Xhebrilit përmes tri fjalëve: "iman", "islam" dhe "ihsan". "Imani" shpreh pjesën teorike, atë çfarë duhet të besojmë, "Islami" shpreh atë çfarë duhet të bëjmë dhe "Ihsani" shpreh sjelljet e mira dhe të hijshme. Sipas kësaj, morali përbën njërin nga tri pjesët që formojnë

parimet e fesë islame. Tri shtyllat në fjalë janë prekur përmbledhtazi në suren Asr në formën "iman, vepër e mirë dhe këshillë në të vërtetë dhe durim". Morali shpreh tërësinë e sjelljeve që shfaq një person.

Feja islame e konsideron njeriun me besimin, mendimin, ndjenjat dhe sjelljet e tij si të tërë. Besimi është produkt i zemrës, mendimi i trurit, ndjenja e ndërgjegjes dhe sjelljet produkt i organeve. Për mirëfunksionimin e jetës së njeriut, të gjithë këta elementë duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. Shembulli më i mirë i shprehjes së kësaj tërësie dhe harmonie është Pejgamberi (a.s.).

Një botëkuptim është kuptimplotë, kur ai përcaktohet nga mendime, ndjenja, ideale, qëllime të larta dhe sistem besimi fetar gjithëpërfshirës. Sipas këtij këndvështrimi e ka përcaktuar Kurani dhe Suneti botëkuptimin e myslimanit dhe për këtë e ka bërë obligim besimin dhe veprimin si të pandashëm nga njëri-tjetri.

Kurani, siç trajton parimet e besimit, në mënyrë sistematike trajton edhe temat morale dhe i ofron njeriut materialin e duhur për të krijuar një sistem moral të përsosur. "Salih amel" nuk përfshin vetëm veprim, adhurime që kanë lidhje me Allahun, si: namazi, agjërimi, haxhi etj., por përfshin të gjitha sjelljet e mira kundrejt njerëzve, si: bamirësinë, devotshmërinë, besnikërinë,



përgjegjësinë. Ajeti: **“Vërtet, ata që i përulen Allahut dhe bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen.”** shpreh dy anët e veprës së mirë. Kurse në një vend tjetër, në mënyrë figurative fenë e përngjason me një pemë, rrënjët e së cilës simbolizojnë besimin, trunqu veprat kurse frutat moralin.

Të gjitha mësimet, këshillat, sjelljet dhe veprimet e Profetit (a.s.), synojnë arritjen e dashurisë hyjnore. Si shembull mund të përmendim: *“Besimtar i vërtetë është ai që kur bën një vepër të mirë gëzohet dhe kur bën një vepër të keqe trishtohet.”* (Ahmet ibn Hanbel, Musned, I, 398.)

Një ditë, një sahabi vjen tek Pejgamberi (a.s.) dhe e pyet: *“Kush është myslimani më i mirë?”* Pejgamberi (a.s.), i thotë: *“Myslman më i mirë është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët janë të sigurt.”* (Buhari, Iman, 4-5.) Kurse një herë tjetër, kur e pyetën cili është islami më i mirë, tha: *“Të ushqesh njerëzit dhe të përshëndesësh me selam atë që njuh dhe atë që nuk e njuh”* (Buhari, Iman, 6.)

Kurse porosi profetike që tregojnë raportin e ngushtë të besim-moral mund të numërojmë: *“Nuk mund të jesh besimtar i vërtetë, përderisa nuk dëshiron për vëllain mysliman atë që dëshiron për veten tënde.”* (Buhari, Iman, 7) *“Ruajtja nga intrigat është pjesë e fesë.”* (Buha-

ri, iman, 12) *“Turpi është pjesë e besimit.”* (Buhari, iman, 16) *“Xhihadi (përpjekja) është prej besimit.”* (Buhari, iman, 26)

Siç theksohet në Kuran dhe Hadith, midis moralit dhe besimit ekziston një lidhje shumë e ngushtë. Nëse Islamin e përngjasojmë me një pemë, atëherë rrënjët janë besimi, degët veprat e mira dhe frutat morali i mirë. Nga kjo kuptohet lehtë që qëllimi përfundimtar dhe kryesor i pemës janë frutat. Prandaj, njeriu vetëm në këtë mënyrë mund t'i realizojë pritshmëritë. Hadithi profetik *“Unë kam ardhur për të përsosur moralin”* shpreh qëllimin përfundimtar të të gjithë sistemit.

Megjithëse pjesa teorike është shumë e qartë, për shkak të kushteve historike, koniunkturës dhe dallimeve kulturore, më vonë janë shfaqur rryma me pikëpamje të ndryshme përsa i përket marrëdhënies mes besimit dhe moralit.

Morali nga pikëpamja e sjelljes përfshihet tek veprat e mira, kurse nga pikëpamja e ndjenjave dhe vlerave përfshihet te besimi. Prandaj, me marrëdhënien besim-moral nënkuptojmë gërshetimin midis këtyre tri shtyllave kryesore. Fatkeqësisht, morali është shkëputur nga shkencat bazike islame, duke iu bashkëngjitur filozofisë. Por morali në kulturën islame nuk ekziston thjesht si një teori, ai së pari është gjendje që jetohet dhe shijohet.



Fryma e qytetërimit bashkëkohor dhe disa specifika të tij

I. HYRJE NË PERCEPTIMIN E FRYMËS SË QYTETËRIMIT BASHKËKOHOR

Sikurse çdo individ përbëhet prej shpirtit dhe trupit, ashtu edhe çdo qytetërim në vete ka frymën (shpirtin) dhe trupin. Frymën e qytetërimit e përbëjnë idetë, pikëpamjet, vlerat morale, mirësjellja dhe traditat, të cilat manifestohen në mënyrën e jetës së individit apo bashkësisë, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, në pikëpamjet mbi fenë, jetën, gjithësinë, njeriun, bashkësinë, etj. Trupin e tij e përbëjnë përparimet materiale, sikurse janë objektet, infrastruktura, arritjet tekniko-teknologjike, fabrikat, makinat për transport, prodhim, lukset e ndryshme, dekoret dhe të gjitha kënaqësitë e kësaj bote.

Qytetërimet e shumta, që ka shënuar historia, të mëdha e të vogla, kanë dalluar ndërmjet veti në pikëpamje të trajtimit të të përshtirës dhe materiale. Disa i kanë dhënë përparësi njëres e disa tjetres, deri sa disa qytetërimet kanë ruajtur njëfarë barazpeshë ndërmjet tyre.

Aktualisht, në botë dominon qytetërimi perëndimor. Ky qytetërim, sipas hulumtimeve, ka anët e tij pozitive, siç është liria e njerëzve (sidomos në raportet perëndimor-perëndimor), mospengimi i arritjeve shkencore në shkencat fizike, kimike, antropologjike, gjenetike, kozmike, spirituale etj. Këto janë bërë falë arritjeve në shkencë, duke zbuluar ligjet kozmike, an-

tropologjike dhe duke i vënë nën kontroll në dobi të përparimit njerëzor. Si rezultat i kësaj u ngrit standardi njerëzor, kështu që në kohët tona, njeriu i zakonshëm jeton në luksin e një mbreti të dikurshëm.

Përkundër këtyre përparimeve kolosale të pakontestueshme, ky qytetërim nuk i solli njeriut lumturinë dhe qetësinë, që i ka munguar dhe po i mungon.

II. RRËNJËT IDEORE TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

Në pyetjen se: Ç'është qytetërimi perëndimor? janë dhënë përgjigje të shumta, por ne do të themi se në qasjen tonë, qytetërim perëndimor do të thotë "ideologjia teorike e Perëndimit bashkëkohor, Evropës dhe Amerikës, mbi të cilën njerëzit i përcaktojnë pikëpamjet mbi fenë, jetën, kozmosin, njeriun, njohjen dhe vlerat etike, zë fill në Greqinë antike dhe Romë." Kjo ideologji përfshin filozofinë metafizike, atë negative dhe pozitive, filozofinë e moralit dhe filozofinë e sociologjisë, të rrymave, drejtimeve dhe grupeve të ndryshme. Quhet *perëndimore*, edhe pse disa nga këto sisteme janë kapitaliste, liberale, socialiste, komuniste apo moderniste dhe pasmoderniste. Atë e bëjnë perëndimore rrënjët e saj, karakteristikat dhe tiparet e saj e jo format apo

1. Tomazh Mastnak, Zoti i blasfemuar dhe demokracia perëndimore, Prizren, 2000, fq. 7 e tutje.

degët, që ndryshojnë njëra prej tjetrës.

Sa i përket mendimit shkencor të qytetërimit perëndimor, ai bazohet në metodën e induksionit. Për lexuesit sipërfaqësorë kjo nuk është e ditur, por shkencëtarët e dinë se kjo metodë është marrë nga qytetërimi mysliman. Disa dijetarë evropianë e pranojnë këtë fakt, sikurse R. Bekoni, apo më vonë Xhorxh Sartoni, Gustav le Boni, etj.² Praninë myslimane në Spanjë e ka përshkruar bukur një dijetar evropian: *"Shembulli i Spanjës tregon, veç tjerash, që dyqind vjet të dominimit arab mjaftuan për ta vendosur vendin e varfëruar, të braktisur e të robëruar, në krye të Evropës dhe të botës oksidentale, falë edukimit të të gjitha shtresave të shoqërisë, falë zhvillimit të shkencave dhe arteve. Dhe këtë përparësi Spanja e ruajti për pesë shekuj, gjersa arabët u dëbuan prej saj."*³

III. DISA SPECIFIKA TË FRYMËS PERËNDIMORE

Fryma perëndimore ka specifikat e saj, që e bëjnë të ndryshme nga idetë orientale e sidomos nga idetë orientale islame. Këto veçanti kanë rrënjët e tyre thellë në shtetin e vjetër grek, të cilat pastaj janë përcjellë në Romë e që më vonë kalojnë në Evropë dhe së fundi në Amerikë e Australi.

3.1. Perceptimi i mjegulluar i Zotit

Gjëja e parë që bie në sy është perceptimi jo i qartë për Zotin, përcjellë me panjohuri dhe fantazi, herë-herë mbështjellë me antropomorfizëm grek. Këtë karakteristikë Perëndimi e ka qysh prej fillimit të ekzistencës së vet. Duke qenë i vetëdijshëm se Perëndimi nuk ka pasur mision pejgamberik të mirëfilltë (së paku jo kohët e fundit), shpallje të mirëfilltë dhe njoftim të drejtpërdrejtë për fenë, ata kanë gjurmuar rreth shkakut të parë apo lëvizësit të palëvizshëm apo qenies së domosdoshme. Në këtë rrugëtim të vështirë ka pasur edhe dështime e rrëzime, kështu që shpesh ka dominuar pasioni dhe imagjinata, fantazia dhe ngatërrimi. Madje edhe filozofët teozofë, çfarë janë Sokrati, Platoni dhe Aristoteli, nuk kanë pasur koncept të pastër për Zotin.⁴

3.2. Synimet materialiste

Materializmi është ndër karakteristikat themelore të mendimit perëndimor. Janë ata të cilët besojnë në materializëm dhe nëpërmjet tij e shpjegojnë kozmosin, njohjen dhe moralin, duke mohuar metafizikën dhe çdo gjë që nuk mund të perceptohet me shqisa. Ata nuk besojnë në Zotin krijues, në pejgamberin që sjell shpallje hyjnore, as në botën përtej varrit. Në parim, ata e urrejnë botën frymore, por e madhërojnë botën seksuale, materiale. Kjo ide dominon në Perëndim në

2. Rozhe Garodi, Islami dhe kultura, Sarajevë, 1990.

3. Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin, Tiranë, 2007, fq. 415.

4. Shih mendimin e Gazaliut: El-Gazali, Izbavljenje od zablude, Sarajevë, 1409/1989, fq. 26-30.

rrafshin teorik dhe praktik. Me fjalë të tjera, feja e mirëfilltë e Perëndimit sot është materializmi.

Dikush mund ta kontestojë pohimin e shtruar, duke thënë se Perëndimi është kristian dhe kjo është e dukshme nga kishat, besimtarët katolikë dhe protestanë etj. Madje, ekzistojnë edhe parti kristiane, organizata joqeveritare, humanitare etj. Por nuk duhet harruar se feja në Perëndim është parullë, se kryqi është simbol rreth të cilit bashkohen, se kisha është objekt të cilin e vizitojnë për fundjavë, por nuk është vlerë morale, as ligj, as doktrinë, sipas së cilës orientojnë jetët e tyre. Thjesht, perëndimori është materialist dhe utilitarist.

Do të citojmë një njohës origjinal të mendimit dhe frymës perëndimore, një qytetar të saj, që e pranoi edhe Islamin, Leopold Veisin apo Muhamed Asadin:

*"Për perëndimorin bashkëkohor me gjysmëmohimin shpërfillës të shpirtit, çështja e qëllimit në jetën njerëzore nuk ka më kurrfarë rëndësie praktike. Ai i ka braktisur të gjitha spekulimet dhe përsiatjet mbinatyrore. Atë që e quajmë qëndrim religjioz, gjithnjë bazohet në besimin se ekziston ligji i gjithëmbarshtëm mbinatyror, moral dhe se ne, qeniet njerëzore, jemi të obliguar t'i nënshtrohemi urdhëresave të tij. Mirëpo, qytetërimi bashkëkohor perëndimor nuk pranon domosdoshmërinë e nënshtimit njerëzor kujtdo qoftë, përveç kërkesave ekonomike, sociale apo nacionale. Hyjnia e tij e vërtetë nuk është e llojit shpirtëror: ajo është Komoditeti..."*⁵

Po ky autor mendon se armiqësia evropiane kundër myslimanëve bëhet kryesisht për dy arsye kryesore:

E para, për shkak se Evropa ka trashëguar qytetërimin bizantin me drejtimin e plotë materialist, kur është fjala për jetën njerëzore dhe vlerën e tij.

E dyta, rebelimi i natyrshëm njerëzor kundër minimizimit kristian të kësaj bote dhe asfiksimit të instinktit natyror dhe nevojave njerëzore.⁶

Frymën evropiane e ka përshkruar bukur një Xhon Ginter, amerikan, në veprën e tij *"Evropa nga brenda"*: *"Anglezët gjashtë ditë në javë adhurojnë bankën angleze, ndërsa ditën e shtatë shkojnë në kishë."*⁷

3.3. Aspiratat shekullariste

Karakteristikë vijuese e mendimit perëndimor është aspirata shekullariste, e cila është rrjedhim i ideve tashmë të theksuara.⁸ Shekullarizmi nënkupton ndarjen e fesë nga shteti, përkatësisht nga jeta shoqërore. Pretendimi i ngulshëm i perëndimorëve ishte *"oksidentalizimi dhe shekullarizimi"* i shteteve dhe shoqërive moderne.⁹

5. Muhamed Asad, Islami në udhëkryq, Prizren, 2002, fq. 34.

6. Muhamed Asad, po aty, fq. 34-35.

7. Sipas: Jusuf el Karadavi, Islam civilizacija budućnosti, Novi Pazar, 2004, fq. 22.

8. Nexhat Ibrahim, Islami dhe kriza e identitetit, Shkup, 2004, fq. 47-54.

9. Azzam Temimi & Xhon L. Esposito, Islami dhe shekullarizmi në Lin -

Perëndimi, i mllfosur me fenë e vet gjatë mesjetës, e sheh atë brenda mureve të faltoreve. Feja nuk do të imponohet as me ligjet e veta, as me doktrinën e vet. Ata nuk kanë harruar se Kisha në mesjetë kishte organizuar inkuizionin kundër shkencës, arsyes, risive etj. Në këtë aspekt u vranë shumë dijetarë, shumë shkencëtarë dhe shumë zbulues. Kësaj ideje i ndihmoi edhe vetë Ungjilli, me thënien e njohur: *“Jepja Perandorit atë që i takon dhe jepja Zotit atë që i takon”*, e legalizoi këtë ndarje: shtetërore dhe hyjnore.¹⁰

3. 4. Konflikti si motiv për ekzistencë

Konflikti është në frymën e qytetërimit perëndimor. Mbi të ka zënë fill, mbi të është ndërtuar, mbi të jeton e vepron edhe sot. Perëndimi nuk njeh paqen, as dashurinë, edhe pse shpesh i proklamon publikisht. Ky konflikt kap raportet njeri-shpirt, njeri-natyrë, njeri-njeri dhe njeri-Zot.¹¹ Nëse njeriu dëshiron të bëjë jetë ideale, duhet të luftojë kundër vetvetes. Kristianizmi e konsideron jetën intime të ndyrë dhe jodinjitoze, pasurinë duhet ta braktisë, të durohet padrejtësia, etj. Kjo është jeta kundër natyrës njerëzore. Mirëpo, Islami nuk shkon kundër natyrës njerëzore. Ai aprovon mirësitë e Krijuesit:

“A nuk shihni, se si Allahu u ka mundësuar t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka plotësuar dhuntitë e Tij, të jashtme dhe të brendshme? E, ka njerëz që polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyese dhe pa libër ndriçues.” (Lukman, 20.)

Konflikti më i rëndë ndër të gjitha konfliktet ishte ai ndërmjet njeriut dhe Zotit, si rezultat i dy burimeve kryesore: politeizmit grek dhe Dhiatës së vjetër.¹²

3. 5. Ndjenja e superioritetit

Tipari vijues i qytetërimit perëndimor është ndjenja e superioritetit mbi të tjerët. Këtë ndjenjë e kanë thujse të gjithë perëndimorët. Ata mendojnë se prejardhja e tyre është e veçantë, më fisnike, me superiore sesa e të tjerëve. Ndërsa ne myslimanët besojmë se njerëzit janë të barabartë, evropianët mendojnë se raca ariane është më e vlefshme, më inteligjente dhe më e frytshme.¹³ Madje, njëfarë M. D. në doktoraturën e tij në Sorbonë, pohon se qelizat e njeriut të zi janë më të pakta se ato të të bardhit¹⁴, që është pohim tipik racist. Një profesor tjetër universitar, Dr. Zigfrid thotë: *“Zoti ka krijuar dy lloje racash në natyrë: shefin, i cili duhet të udhëheqë dhe punëtorin, i cili duhet të dëgjojë. Cili është më i nevojshëm? Sigurisht, punëtori. Në çdo njëmijë punëtorë ka dy deri në tre shefa. Kështu Zoti e ka*

*krijuar racën evropiane që është shefi dhe atë lindore, që është punëtori.”*¹⁵ Kjo ndjenjë perëndimore është edukatë familjare, shkollore, mentalitet qytetar perëndimor, prandaj qarkullojnë edhe sloganet nëpër rrugë: *Turku duhet të dëbohet nga Evropa, Evropa duhet çli-ruar nga turqit*¹⁶ etj.

Edhe pse kjo teori është e paqëndrueshme edhe nga aspekti humanitar, edhe nga aspekti shkencor, ata ende vazhdojnë të mendojnë se janë epiqendër e ngjarjeve botërore. Mirëpo, harrojnë se pishtari i qytetërimit erdhi pikërisht nga Lindja, Fenikia, Babilonia, India, Kina, Lindja islame. Harrohet se sërish trashëgiminë greko-romake e sollën myslimanët, të përkthyer dhe të interpretuar por të përcjellë edhe me krijime të reja, burimore, origjinale, si nga aspekti i tematikës ashtu edhe nga aspekti i metodologjisë.

PËRFUNDIM

Karakteristikat më ndikuese të qytetërimit perëndimor, si perceptimi i paqartë për Zotin, aspiratat materialiste, aspiratat shekullariste, natyra konfliktuale e qytetërimit perëndimor dhe ndjenja e superioritetit ndaj të tjerëve, kanë pasur ndikim dhe kanë lënë gjurmë në mirësjelljen, veprimet dhe raportet me vetveten dhe me të tjerët. Disa dijetarë perëndimorë, duke vërejtur pasojat negative të këtij qytetërimi materialist, gjykuan segmentet e tij shtylla¹⁷ dhe kërkuan kthimin e vlerave të besimit. Disa vepruan duke iu kthyer kristianizmit e disa duke kërkuar prehjen e tyre shpirtërore në Islam apo në ndonjë religjion tjetër lindor.

LITERATURË

1. Akbar S. Ahmed, Zbulimi i Islamit, Shkup, 2012.
2. Ali Sheriati, Njeriu dhe Islami, Tetovë, 1992.
3. Azzam Temimi & Xhon L. Esposito, Islami dhe shekullarizmi në Lindjen e Mesme, Shkup, 2010.
4. El-Gazali, Izbavljene od zablude, Sarajevë, 1409/1989.
5. Jusuf el Karadavi, Islam civilizacija budućnosti, Novi Pazar, 2004.
6. Muhamed Asad, Islami në udhëkryq, Prizren, 2002.
7. Nexhat Ibrahim, Islami dhe kriza e identitetit, Shkup, 2004
8. Nexhat Ibrahim, Vepra, 10, Shkup, 2009.
9. Rozhe Garodi, Islami dhe kultura, Sarajevë, 1990.
10. Sigrid Hunke, Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin, Tiranë, 2007
11. Tomazh Mastnak, Paqja kryqtare, Shkup, 2012.
12. Tomazh Mastnak, Zoti i blasfemuar dhe demokracia perëndimore, Prizren, 2000.

jen e Mesme, Shkup, 2010, fq. 11.

10. Akbar S. Ahmed, Zbulimi i Islamit, Shkup, 2012, fq. 40-41.

11. Jusuf el Karadavi, po aty, fq. 24.

12. Tomazh Mastnak, Paqja kryqtare, Shkup, 2012, fq. 15 e tutje. Jusuf el Karadavi, po aty, fq. 24-27.

13. Jusuf el Karadavi, po aty, fq. 27.

14. Ali Sheriati, Njeriu dhe Islami, Tetovë, 1992, fq. 57.

15. Nexhat Ibrahim, Vepra, 10, Shkup, 2009, fq. 245.

16. Tomazh Mastnak, Zoti i blasfemuar, po aty, fq. 26 e tutje.

17. T. Mastnaku thotë se në shoqërinë demokratike perëndimore “zëri i idiotit është i barabartë me zërin e intelektualit të madh.” Sipas: Tomazh Mastnak, Zoti i blasfemuar, po aty, fq. 31.



Detyrimi i njeriut NDAJ TOKËS

Dr. Lulzim Esati

Allahu (xh.sh.), ia krijoi njeriut mjedisin e përsosur, ashtu siç e përsosi edhe vetë njeriun. Prandaj kërkoi prej tij të përkujdesej për këtë mjedis, duke pasur parasysh se jeta e tij do të ndikohet pozitivisht ose negativisht nga mjedisi dhe rrethenat ku ai jeton. Nga kujdesi ndaj mjedisit në veçanti dhe ndaj tokës në përgjithësi, vjen edhe ndërtimi i saj dhe rindërtimi mbi të. Kjo është obligative nëse njeriu dëshiron të jetë konstruktiv në detyrën e tij ndaj tokës. Nëse bëjmë një vështrim në librin e Allahut (s.v.t.), gjejmë shumë ajete të Kuranit që na bëjnë të qartë se roli i njeriut ndaj tokës duhet të jetë konstruktiv dhe assesi nuk duhet të konsiderohet kjo si një lloj humanizmi prej njeriut ndaj saj, por si një detyrë dhe urdhër nga Krijuesi i Gjithëfuqishëm. I Lartëmadhërishtëmi në Kuran ka thënë:

“Fisit Themud (Ne i dërguam) vëllanë e tij, Salihun. “O populli im”, - u tha ai - “adhuroni vetëm Allahun. Ju s’keni zot tjetër përveç Atij! Ai ju krijoi nga toka dhe ju vuri të jetoni në të...” (Hud, 61.)

Edhe pse fjala *isteamere* është përkthyer **“ju vuri të jetoni në të”**, ajo ka edhe këtë kuptim: *kërkoj nga ju ndërtimin e saj*¹.

Ne jemi më se të vetëdijshëm se jo çdo njeri zotëron mundësi të bëjë rregullime e ndërtime në tokë, sepse për të afruar rregullime adekuate kërkohen norma e kushte të posaçme varësisht nga lëmi dhe profesioni që ka njeriu. Nëse dëshirojmë të rregullojmë gjendjen shëndetësore, atëherë duhet të pajisemi me njohuritë e sakta nga degët e mjekësisë. Nëse duam ta përmirësojmë ekonominë tonë, poashtu kërkohet që të njohim mirë fushën e saj. Poashtu, nëse dë-

shirojmë ta rregullojmë infrastrukturën e vendit ku jetojmë, që të kemi një mjedis të bukur, duhet të pajisemi mirë me njohuritë të arkitekturës, inxhinierisë etj. Kështu që çdo njeri nuk mund t’i plotësojë kushtet për të rregulluar dhe ofruar ndonjë kontribut rreth kësaj. Mirëpo, për të shkatërruar dhe për të bërë çrregullime në tokë nuk kërkohen kushte të rënda, madje mund të themi se nuk kërkohen kushte fare. Ndoshta edhe këtu qëndron arsyeja se pse fjala (ndërtoni) është përmendur vetëm një herë, ndërsa fjala (mos bëni çrregullime) është përmendur me dhjetëra herë.

Nëse njeriu nuk ka mundësi të bëjë rregullime në tokë, atëherë të mos bëjë çrregullime në të dhe kjo nuk kërkon njohuri të madhe ose kontribut të veçantë, por kërkon nga personi që ta ndalë veten, dhe të ushtrojë presion ndaj sjelljes së tij, kur ajo rebelohet dhe kënaqet duke e nxitur atë të bëjë ndonjë çrregullim apo shkatërrim në natyrë dhe rrethin ku jeton. Që njeriu ta ndalë rolin destruktiv të tij ndaj natyrës, është urdhër i prerë nga Allahu (s.v.t.) e sidomos për myslimanin.

I Lartëmadhërishtëmi në Kuran thotë:

“Dhe mos bëni çrregullime në Tokë, pasi është vënë rregulli...” (Araf, 56.)

“Mos kërkoni ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët.” (Kasas, 77.)

“...Por Allahu nuk e do shkatërrimin. (fesadin)” (Bekare, 205.)

“...Allahu nuk i do ngatërrestarët.” (Maide, 64.)

Në ajetet e sipërpërmendura qartësohet se Allahu nuk e do çrregullimin, e aq më pak ngatërrestarët.

Kjo çështje është me peshë aq të madhe, sa që njeriu mund

1. Ibën Kethiri, vël: 1, f. 111, el-Kurtubi. Vël: 4, f. 111.

ta kuptojë vetëm kur t'i shijojë vetë disa nga pasojat e saj. Allahu (s.v.t.), me fuqinë e Tij dhe butësinë që ka ndaj krijesave të Tij, bëri të mundur që çdo "fesad" e ngatërrim të hetohet me anën e ndjenjave e jo me anë të intelektit dhe diturisë që përfiton njeriu. Kjo ishte urtësi e Krijuesit, i Cili bëri që një gjë e tillë të hetohet me shqisa dhe ndjenja.

I Lartmadhërishtmi në Kuran thotë:

"Kur u thuhet: "Mos bëni çrregullime në tokë!" - ata thonë: "Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkaktarët e çrregullimeve, ndonëse nuk e ndiejnë. (Bekare, 11-12.)

Fjala: *shuur*, në gjuhën arabe do të thotë ndjenjë.

Po sikur të kishte përfunduar ajeti me fjalën: "nuk e dinë", siç është rasti me ajetin në vijim:

"Kur atyre u thuhet: "Besoni edhe ju ashtu siç kanë besuar njerëzit e tjerë!" - ata thonë: "Vallë, a të besojmë edhe ne ashtu siç besojnë mendjehetët?" Por jo! Në të vërtetë, pikërisht ata janë mendjehetët, por nuk e dinë këtë!" (Bekare, 13.)

Vallë, kur do të arrihet që të gjithë njerëzit të dinë ta dallojnë rregullimin prej çrregullimit apo shkatërrimin prej ndërtimit në mbarë rruzullin tokësor? Ose, çfarë niveli arsimimi dhe edukimi do të kishim mundur t'i ofronim njerëzimit në tërësi? Shkollim fillestar, të mesëm, universitar apo pasuniversitar, kur dihet se njeriu modern dhe postmodern nuk arriti deri më sot ta zhdukë analfabetizmin ndër njerëzit në tërë botën, duke pasur parasysh se gjysma e botës, në mos dy të tretat vazhdojnë të jenë analfabetë!

Pra ishte vërtet një urtësi e të Lartmadhërishtmit, e cila tërhiqte vëmendjen e atyre që analizojnë, se përse e zgjodhi këtë përfundim dhe nuk zgjodhi ndonjë përfundim tjetër, nga përfundimet e Tij të shumta për ta mbyllur fjalën e Tij të bekuar në këtë çështje (*fesad*). I qofshim falë Allahut (s.v.t.), i Cili thotë:

"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njuh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?" (Mulk, 14.)

Kjo ishte e tëra, sa i përket këndvështrimit të parë rreth përfundimit të ajetit 12 të sures Bekare.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së natyrës, të cilën Allahu (s.v.t.), e krijoi me një saktësi mahnitëse, që të jetë një ambient sa më i përshtatshëm për mirëqenien e njeriut, Ai me mëshirën e Tij dhe dashurinë që ka ndaj krijesave në përgjithësi e ndaj njeriut në veçanti, dërgoi mesazhe të një-pasnjëshme tek njerëzit, që përmbanin këtë porosi: **"Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj."** Këtë e bëri përmes çdo peygamberi (a.s.), duke filluar nga më të parët e deri tek Muhamedi (a.s.).

Porosia e Allahut (s.v.t.), përmes Shuajbit (a.s.), ishte:

"Popullit të Medjenit, Ne i dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin, i cili u tha: "O populli im! Adhuroni Allahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Me të vërtetë, ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj, prandaj matni dhe peshoni saktë, mos u hani hakun njerëzve dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregull në të. Kjo është më mirë për ju,

nëse jeni besimtarë!" (Araf, 85.)

Po ashtu, porosia e Tij përmes Musait (a.s.):

"Musai i tha vëllait të vet, Harunit: "Më zëvendëso te populli im, mbaj rregull dhe mos ndiq rrugën e ngatërrestarëve!" (Araf, 142.)

Porosia e të Lartmadhërishtmit përmes Muhamedit (a.s.):

"Mos kërkoni ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët." (Kasas, 77.)

Nëse vështrojmë me vëmendje ajetin kuranor, i cili flet për porosinë e Shuajbit (a.s.), duke lëshuar në të një shikim analizues, pa dyshim se gjejmë një lidhje të fortë rreth *Imanit* (besimit) të njeriut dhe ndalimit të *fesadit* (çrregullimit). Hapi i parë që ka marrë i dërguari i Allahut Shuajbi (a.s.), me popullin e tij ishte që njerëzit ta besojnë Allahun (Një) dhe vetëm Atë ta adhurojnë, pastaj kërkoi nga ata zbatimin e drejtë kur të peshojnë dhe të mos u bëjnë padrejtësi njerëzve në sendet e tyre gjatë shitblerjes, qoftë në cilësi apo sasi, ndërsa porosia e fundit ishte: **"...mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregull në të. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë!"**

Pra hapi i parë ishte futja e *imanit* (besimit të vërtet) në zemrat e njerëzve. Ndërsa përfundimi i ajetit me fjalët **nëse jeni besimtarë**, tregon pamundësinë e ndalimit të *fesadit* (çrregullimeve) në tokë në mungesë të *Imanit*. Urtësia e Allahut (s.v.t.), në zgjedhjen e kësaj fjale (**nëse jeni besimtarë**) nga mesi i shumë metodave, të cilat gjenden në Kuranin Kerim, gjatë përmbjlljes së ajeteve, nxori në pah rolin e *imanit* në parandalimin dhe ndalimin e çrregullimeve (*fesadit*) në tokë. Është për t'u habitur edhe këtu, në ndalimin e *fesadit*, se si nuk u përmend intelektit, mendja apo dituria e njeriut, siç ndodhi edhe më parë kur folëm rreth mënyrës se si hetohet *fesadi* (çrregullimi). Ne e dimë mirë sa të shumta janë ajetet që përfundojnë me fjalët logjikojnë, mendojnë, kuptojnë, shikojnë, përkujtojnë, etj., që janë attribute të njerëzve të dalluar, si rrjedhojë e kontributit dhe angazhimit të tyre të veçantë. Edhe pse Allahu, i çmon shumë personat që stolisen me këto veti të çmuara, është për t'u çuditur se asnjëra nga këto nuk funksionoi këtu.

Nga kjo që u tha deri tani, shtrohet pyetja: A ka mundësi të ndalohet *fesadi* (çrregullimi) në tokë me metoda të tjera përveç besimit të vërtetë?

Përgjigja do të kuptohet më vonë.

Rolin e *imanit* dhe ndikimin e tij në sjelljen e njeriut, si dhe raportet reciproke të tij me tokën e vë në fokus edhe hadithi i Resulullahut (a.s.), kur flet për përbërjen e *Imanit*: **"Imani përbëhet nga gjashtëdhjetë e ca kategori; më e larta është dëshmia dhe deklarimi se: S'ka zot tjetër, përpos Allahut, ndërsa më e ulëta; largimi i një sendi që ka zënë rrugën."**²

Pra, largimi i gjërave që pengojnë rrugën në veçanti, dhe largimi i tyre nga vendet ku shkaktajnë dëme në përgjithësi, është pjesë prej pjesëve që plotësojnë besimin e myslimanit. Nëse besimtari e sheh një gjë të tillë në rrugë dhe nuk e largon,

2. Imam el Bejheki, *shuubul iman*, f, r.r.

duke pasur mundësi ta bëjë atë, duhet ta dijë se një pjesë e imanit të tij ka shkuar huq.

Nëse kthehemi në historinë njerëzore, shihet qartë se shkatërrimet masive kanë qenë produkte të ushtrive në mënyrë të organizuara nga shoqëritë e civilizimeve dominuese të asaj kohe. Parimi i tyre ka qenë se kur të pushtohet ndonjë vend apo të mposhtet ndonjë civilizim rival, duhet të fshihet nga fytyra e dheut njëherë e përgjithmonë! Ndërsa masakrave të tyre nuk u kanë shpëtuar as gratë, as të sëmurët e as fëmijët, qofshin edhe foshnja të posalindura, madje shpeshherë kanë pësuar të njëjtin fat edhe kafshët! Kështu vepruan grekët e lashtë të Spartës, romakët ashtu edhe persianët paganë. Më pas edhe bizantinët, dhe pasardhësit e tyre evropianë në emër të kryqëzatave. Gjithashtu, bijtë e tyre ishin të etur për të bërë shkatërrime në tokë.

Gjatë kolonializmit anglez dhe francez këto shkatërrime ishin bërë pjesë e civilizimit të tyre³. Kështu vazhdoi edhe me Bashkimin Sovjetik në Afganistan dhe vazhdon sot në Çeçeni, siç vepronin serbët gjatë luftës në Bosnjë dhe në Kosovë, kur digjnin, shkatërronin dhe masakronin në emër të civilizimit të tyre. Këtij shtegtimi të gjatë në strategjinë e shkatërrimit në tokë nuk i shpëtuan as ushtarët amerikanë, si në Irak, po ashtu edhe në Afganistan!

Mos vallë u mungonte dituria këtyre ushtrive, që s'mund ta dallonin shkatërrimin nga rregullimi, kur dihet mirë se ishin të pajisur me akademitë ushtarake më të njohura të kohës. E vërteta është se këta zotëronin arritjet më të mira, por u mungonte vetëm një gjë: *Imani* (besimi i vërtetë). Me këto fakte synuam ta sqarojmë rëndësinë që i dha Allahu (s.v.t.), besimit në parandalimin e *fesadit* në bazë të përmblyljes e mbylljes së shumë ajeteve kuranore me fjalët: **(...nëse jeni besimtarë)**. Për ta dëshmuar këtë, mjafton të bëhet një qasje sado e shkurtër në historinë islame, për ta parë se si silllej ushtria e pajisur me Iman pa kryer asnjë akademi ushtarake moderne. Por këta të fundit ishin të pajisur me besim të vërtetë nën mbikëqyrjen e Zotit. Edhe pse ishin me shkollim të ulët, këta ishin shumë më të lartë në sjelljet e tyre ndaj natyrës dhe krijesave të tjerave. Historia e tyre në vijim na tregon dallimin e qartë mes të diturve pa besim dhe besimtarëve me dituri të ulëta, por me edukim të lartë, të mbështetur në shpalljen e Allahut.

Kur Ebu Bekri (r.a.), dërgoi ushtrinë myslimane për ta hapur Damaskun, ai porositi t'u përmbaheshin dhjetë pikave, ndër to: mos prekni të moshuarit, gratë, fëmijët, kafshët, mos shkatërroni pemët etj. Të njohura si "*el-vesajal ashera*", "dhjetë porositet" e Ebu Bekrit. Dhe ushtria myslimane i kryente këto amanete në mënyrë të përkryer. Këto porosi nga Halifi i parë (r.a.), i barte me vete çdo ushtri myslimane, si në hapjen e Damaskut, Afrikës Veriore, Andaluzisë, vendeve të Azisë, dhe në Ballkan. Ajo që bëri të funksionojnë këto porosi tek ushtarët myslimanë nuk ishte arsimiti dhe shkollimi i lartë, por *Imani*.

3. Ushtarët francezë gjatë pushtimit të Algjerisë, i cili zgjati 130 vite, kur kalonte pranë tyre ndonjë grua shtatzënë, vinin bast për gjininë e fëmijës së saj, pastaj ia çanin barkun për ta parë.

Kurani famëlartë na njofton gjithashtu se disa njerëz kënaqen kur bëjnë shkatërrime (*fesad*) në tokë. I Lartmadhërishti thotë:

"Ka ndonjë njeri (hipokrit), fjalët e të cilit në jetën e kësaj bote ta bëjnë qejfin dhe që betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë, është kundërshtari (yt) më i betuar. E, kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin. Kur atij i thuhet "Kije frikë Allahun!", ai mburret dhe bën më shumë të këqija. Atij i mjafton Xhehenemi. Eh, sa vendbanim i keq është ai vend!" (Bekare, 204-206.)

Dhe nëse këtij lloji të njerëzve i thuhet pse bëni shkatërrime? Do të përgjigjen siç njofton Kurani:

"Kur u thuhet: Mos bëni çrregullime në tokë! - ata thonë: Ne bëjmë vetëm përmirësime në tokë!" (Bekare, 11.)

Gjithashtu, Kurani na njofton se ka të atillë që rregullimet e të tjerëve mundohen t'i paraqesin si çrregullime e shkatërrime:

"Faraoni tha: Më lini ta vras Musain e ai le ta thërrasë në ndihmë Zotin e vet. Unë vërtet druham mos ai do t'ju ndryshojë fenë tuaj ose do të shkaktojë trazira në Tokë." (Gafir, 26.)

Faraoni dhe shumë si ai mundohen ta paraqesin punën e pejgamberëve dhe misionin e shenjtë të tyre si *fesad* (trazira e çrregullime) në tokë. Të tillët, edhe pse janë liderë të shoqërisë dhe konsiderohen si intelektualë të rrallë, prapëseprapë nuk po arrijnë ta dallojnë rregullimin prej çrregullimit. Ky është fryti i tiranisë, padrejtësisë dhe korrupsionit që bëjnë, deri në atë masë sa ua shkatërron edhe ndërgjegjen.

Si përmblylje, kur përmendet *fesadi* në Kuran, ka për qëllim pasojat masive në shoqëri dhe shkatërrimet e mëdha, siç janë: shkatërrimi i natyrës, moralit, shëndetit, ekonomisë e të tjera të këtij rangu, që nuk mund të kufizohen në një mjedis njerëzor, por përfshijnë edhe mjediset e tjera dhe dalëngadalë marrin përmasë globale. Kemi rastin e shtresës së ozonit dhe ngrohjes globale në planetin tonë, rrjedhojat e së cilës po e paguajmë të gjithë ne. Degjenerimin e të rinjve. Veshjet jonjerëzore apo moda e lakuriqësia (*kultura e zhveshjes*)⁴. Luftërat kolonizuese në emër të lirisë së të shprehurit dhe zgjedhjes etj. Gjithëkjo ndodh si rezultat i veprave të njerëzve. Të gjitha këto sjellje si të tilla, Allahu (s.v.t.), nuk i do te njerëzit. Këtë e ka bërë të qartë në Kuran, kur thotë:

Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim). (Rrum, 41.)

4. Siç e quan autori iranian i librit *kultura e zhveshjes dhe shveshja e kulturës*, f. 61.

sqimatarët

Nuredin Nazarko

Njeriu mban përbrenda vetes një mijë e një dëshira, për realizimin e të cilave ëndërron, fantazon dhe njëkohësisht punon, në qoftë se nuk ka mbetur ende peng i ëndërrimit dhe fantazimit. Një nga dëshirat, ndoshta një prej dëshirave të grupit më të fortë të dëshirave që gjenden tek njeriu dhe ushqehen vazhdimisht nga ëndërrimet dhe fantazitë e tij është sqima. Çdo njeri ka mënyrën, stilin, shijen e tij të të shprehurit të sqimës. Shprehja publike e anës përjashtësore e sqimës ndryshon nga njeriu në njeri, por ajo që i vendos të gjithë njerëzit nën të njëjtin emërues të përbashkët, edhe pse ndryshon mënyra e realizimit të sqimës, është dëshira e fortë për t'u diferencuar nga pjesa tjetër e njerëzve, me qëllim që të tërheqin vëmendjen e të tjerëve mbi vetet e tyre. Të veshurit bukur, pastër, natyrisht që është një gjë e kërkuar prej njeriut dhe asesi nuk mund t'i bashkohemi korit të asketizmit në këtë aspekt. Ajo që të shqetëson dhe është në të vërtetë për t'u shqetësuar është brejtja nga krimbi i dëshirës për t'u dukur dhe shfaqur superior përmbi të tjerët thjesht dhe vetëm përmes plotësimit të sqimës.

Ditët në të cilat jetojmë na përballin me ndryshime dhe transformime të vazhdueshme sociale, ndryshime dhe transformime që reflektohen edhe në jetën e përditshme të njeriut. Diferencimet ndërmjet njerëzve janë të llojeve të ndryshme, por një nga diferencimet që ka marrë më tepër rëndësi është diferencimi nëpërmjet sasisë së zotëruar të pasurisë e katandisë. Sa më shumë pasuri e katandi, aq më shumë mundësi për plotësim dëshirash e ëndrrash. Sa më pak pasuri e katandi, aq më pak mundësi për plotësim dëshirash e ëndrrash. Duke mbajtur si referencë, pikërisht pasurinë dhe katandinë dhe për më tepër mënyrën sesi reflektohet zotërimi i tyre në publik, njerëzit kanë hyrë në një garë të ethshme mes njëri – tjetrit për këtë të fundit. Mjaft njerëz, edhe pse me mundësi të kufizuara materiale për të shpenzuar tepër, bëjnë çmos që në mjediset publike të shfaqen si të barabartë me ata që kanë mundësi të shpenzojnë më tepër. Kjo shpeshherë ndodh për arsye që të mos ndihen inferiorë përballë pjesës që zotëron pasuri e katandi. Por kjo shfaqje e

rreme në publik mund të ndodhë edhe si rezultat i dëshirës që ka kjo kategori njerëzish për të qenë në të tilla pozita, pasi që ai që fiton respekt, për të qenë më afër së vërtetës servilosje, dhe prestigj në një shoqëri ku mbisundon forca e materies, është pikërisht ai që zotëron pasuri e katandi. Dëshira për të notuar në të tilla ujra i shtyn të pamundshmit materialë, drejt një gare të ethshme dhe rraskapitëse për të qëndruar të papërkulur në këtë shfaqje publike, e cila për hir të së vërtetës i ka çuar garuesit e saj drejt rruginave të lodhjes, rraskapitjes, stërmundimit shpirtëror e trupor. Ndezja e dëshirës për të hyrë në këtë garë të ethshme vjen edhe si rrjedhojë e përcaktimit si inferiorë nga ana e atyre që zotërojnë pasuri e katandi, të cilët e konsiderojnë veten si pararoja e modelit të njeriut që reflekton qytetërim. Kjo kategori e konsideron veten si përçuese të vlerave civilizuese, madje për të qenë në sintoni me këtë konsideratë, përpiqen me mish e me thonj ta transformojnë veten në modele të gjalla të jetësimit të vlerave civilizuese, veçanërisht kur shfaqen në publik. Shfaqja e tyre publike plot sqimë ndez kërkshërinë dhe sjell vëmendjen e asaj pjese njerëzish të cilët janë të dashuruar me sqimën dhe rrëzëllitjen përjashtësore të gjërave. Kjo pjesë njerëzish i konsideron njerëzit më me fat ata të cilët shfaqin para publikut sqimën e tyre që ushqehet nga zotërimi i pasurisë dhe katandisë. Shpeshherë poshtë e përpjetë dëgjon të thuhet se sa me fat është aksh njeri që zotëron shtëpi, makina, para, rreth të cilave vërdallosen edhe kënaqësi e qejfe të tjera. Kjo lloj zilie, e cila është tepër torturuese shndërrohet në gërryesin e qetësisë shpirtërore të njeriut, aq sa natë e ditë ëndërron e fantazon se kur do të mund të vijë ajo ditë kur edhe ai të zotërojë të tilla gjëra që zotëron aksh njeri. Por nuk duhet të harrojmë se ndoshta ajo ditë nuk vjen asnjëherë pasi që, pavarësisht asaj çfarë dëshirojmë dhe ëndërrojmë të kemi në jetën tonë mbi sipërfaqen e lëmshit të dheut, e ardhmja mbetet e panjohur. Ndërkohë që zhytet në ëndërrimet e vazhdueshme të zotërimit të pasurisë e katandisë, harron se njeriu të cilin e quan më me fat për shkak të katandisë që ka, ka të njëjtën origjinë me “të pafatin” dhe do t’i kthehen që të dy së njëjtës origjinë. E kur t’i kthehen origjinës së tyre, as njëri dhe as tjetri nuk kanë për të gjetur as pasuri e as katandi përballë tyre. Shumë syresh do të thonë se çfarë na duhet ne me atë që vjen. Ne duam atë që mund ta shijojmë sa pa i kthyer potkonjtë nga dielli. Ne duam të dukemi të qytetëruar, bashkëkohorë, përparimtarë, të emancipuar, me kulturë alla evropiane. Por çfarë bën ky njeriu i qytetëruar shqiptar, si vepron e si silltet që është kaq i lakmuar si model i një jetese bashkëkohore. Po sjellim në vëmendje një përshkrim të këtij njeriu nga ana e Faik Konicës në vitin e largët 1902. Edhe pse përshkrimi në fjalë nuk përmban larushinë e formave të katandisë

që kemi sot në qarkullim, në thelb mbetet tejet aktual dhe realist përsa i përket konsideratës mbi njeriun e qytetëruar.

AI QË ËSHTË I QYTETËRUAR

E njihni të gjithë atë që “ka parë botë, që është i qytetëruar”. Çdo qytet i Shqipërisë e çdo katund sidomos i madh ka një të tijn. “Njeriu që është i qytetëruar” i lag përditë me vaj leshrat, vishet me “të ngushta” (ca pak të fidikuara), mban një stap të lehtë në dorë – e shikon sipër – poshtë gjithë botën. Vajzat çuditën, pleqtë shkëndallëzohen, djelmët i bien prapa duke thirrur e duke vërsëllyer a duke i hedhur gurë, - mjeshtri i shkollës i qaset të lidhë fjalë me të. Mendjet e larta merren vesh aq udobisht njëra me tjetrën! – “Si vete sot? – Si vini? – Si vini, si shkoni? Si kurdoherë më pëlçet zemra. Ku rrohet në këtë vend, me këta njerëz që s’dinë të vishen, të hanë të flasin! Ah, Evropa e shkretët! Kur isha në Evropë...” Kur ish në Evropë, ish si peshku në ujë. Gjithë shijen, gjithë hollësinë e shoqërisë së qytetëruar i ka thëthitur. I ka parë të gjitha sa janë për të parë e ca të tjera, i njuh të gjithë. Ka folur, ka lidhur miqësi me fytyrat e njohura të Evropës së tërë. Po ku ka lindur, në pyeç, ky njeri aq i hollë e aq i çuditshëm? Pa dyshim, do të jetë rritur në “Rue de la Paix” të Parisit, në “Strand” të Londonit” a në “Grahën, të Vjenës”. Mos kërko aqë larg...Ka parë ditën në Dardhë, në Mollë, a në Breg të Pulës. Është rritur në mes të bajgave të gomarit dhe të kakërdhisë së deles. (Konica, F. (2001) *Vepra 1*. Tiranë: Dudaj, f. 144).

Nevoja për të qenë i kulturuar është nevoja më e madhe për njeriun dhe si e tillë duhet marrë në konsideratë seriozisht. Këtu duhet mbajtur parasysh që kultura nuk është privilegj vetëm i Europës dhe çdo gjë e importuar prej andej është në thelb kulturë. Sqimatarët që reklamohen me markën “Made in Europe”, duhet ta kuptojnë më së pari vetë Europën dhe kulturën e saj, për të parë nëse i përshtaten markës nëpërmjet së cilës kërkojnë të shiten në publikun vendas. Duhet të përpiqemi të adaptojmë dhe të jetësojmë vlerat e larta shpirtërore, pa kthimin e të cilave në kategori ontologjike nuk do të mund të shpëtojmë nga shitja si produkte të një imitimi të verbër, pa shpirt dhe me pasoja jo vetëm në jetën individuale ashtu sikundërse thotë edhe fjala e urtë dhe e mençur se hunda e madhe është bela e të zot. Duhet kuptuar se inferioriteti apo superioriteti i dikujt nuk varet nga elementë që lidhen me gjëra të paqëndrueshme dhe të zhdukshme, por varet nga virtytet e larta shpirtërore, të cilat janë melhemi dhe balsami i ndezullive të pavenda për shkëlqimet përjashtësore të atyre gjërave, pronar i të cilave as ka qenë dhe as do të jetë ndokush, përsa të ketë jetë mbi këtë lëmsh dheu.

TREGTIA ME ALLAHUN E MADHËRUAR

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

Allahu të flet ty për këtë. Flet për tregtinë. A je i vetëdijshëm të bësh tregti me Allahun dhe çfarë tregtie, sa është fitimi i garantuar...?

Fjala "tregti" (tixherah) në Kuran përmendet tetë herë.

Allahu i madhërishtëm urdhëron e thotë:

"Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje! Kjo është fitorja madhështore." (Teube, 111.)

Çfarë përshkrimi madhështor... Allahu me Vetën bën marrëveshje tregtare me besimtarin dhe këtë e konfirmon në tre Librat e shpallur...

Ai thotë (ishtera) "ka blerë" në kohën e kaluar, d.m.th. çdo gjë ka përfunduar, shikoje sa është e madhe mëshira e Tij ndaj teje. Ndërsa Ai është Pronari i vërtetë i pasurisë, që ti e quan tënden. Mendo pak për këtë!

A je i vetëdijshëm?

Çfarë shitet këtu?

Sa është çmimi që ofrohet?

Kush dëshiron të blejë diçka nga ti?

Ku ndodhi e tërë kjo?

Ku është e shkruar marrëveshja e shitblerjes dhe kush e ka përshkruar dhe e ka shpallur?

Kush është garant se të gjitha pikat e marrëveshjes do të respektohen?

Vëlla i dashur!

Blerësi është Allahu. Lënda e shitjes janë pasuria dhe jeta e besimtarëve. Vlera e pagesës është Xheneti, të cilin as syri nuk e ka parë dhe as që mund të paramendohet. Marrëveshja e shitblerjes është e shënuar në Teurat, Inxhil dhe Kuran. Ndërsa garant, i cili do ta paguajë është Vetë Allahu!

Shitblerja është e vlefshme vetëm me marrëveshje reciproke. Blerësi është serioz dhe nuk blen çfarëdo. Ai blen vetëm nga besimtarët e sinqertë. Ai e di mirë çfarë vlen.

Derisa lexoj këtë ajet kuranor, pyes veten: "Çfarë janë jetët tona dhe pasuria, për të cilën Allahu ofron këtë çmim të lartë?"

Myslimanët e parë kanë qenë të vetëdijshëm për marrëveshjen që kanë bërë me Allahun,

Shembulli i Omerit (r.a.), ilustron këtë më bukur, i cili 700 deve me mall ua shpërndau të varfërve.

Allahu i madhërishtëm thotë:

"O besimtarë, a doni t'ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?" (Saf, 10.)

Sahabët kanë punuar shumë për Islam, ndërsa Pejgamberi (a.s.), asnjërit nuk i ka premtuar asgjë përveç Xhenetit. Në çdo mënyrë të mundshme i ka lidhur për Xhenet. Njërit prej tyre i tha: "Prit të të jap diçka..." I dha një shkop duke i thënë: "Ja po ta jap këtë shkop, dëshiroj të ma kthesh në Xhenet." Ai nuk u nda kurrë nga shkopi e para vdekjes la amanet që ta varrosnin me të, sepse duhet t'ia kthente Pejgamberit (a.s.).

Kur Xhaferi (r.a.), u kthye nga lufta ku qëndroi disa vite e kjo ishte në ditën e fitores së Hajberit, Pejgamberi (a.s.), tha: "Nuk e di, më tepër të gëzohem për kthimin e Xhaferit apo për fitoren e Hajberit!" Xhaferi për vete nuk kërkon vilë, pagë, as pushim vjetor. Kërkon vetëm një gjë, një rast të ri për punë në rrugën e Allahut dhe një tregti me

Allahun... Në detyrën e parë të ardhshme arriti nderin e shehidit.

Nëse shitblerja ka përfunduar... ,nëse blerësi të jep shumë më tepër se sa vlen malli yt..., a do të ngurosh apo mos e dhashtë Zoti tërë këtë, do ta shesësh në ndonjë kafene. A thua në ndonjë altar të epsheve, pasurinë me të cilën do të mund "ta blesh" Xhenetin, do ta japësh për një kënaqësi të shkurtër ...?

Nëse blerësit nuk ia jep mallin e mire, kur ai e kërkon, atëherë marrëveshja priset dhe blerësi do të hidhërohet me ty... Nëse je i vetëdijshëm për këtë tregti, ti me pasurinë dhe jetën tënde nuk ke asgjë...Asgjë nuk është e jotja...

"Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre. (Ahzab, 23)

Ti je në pritje. Kërkon rastin të bësh atë, që Allahu kërkon prej teje. Nëse Ai thotë: "Mos e bëj këtë që e kam ndaluar", ti e lë menjëherë. Nëse të thotë, bëje këtë, ti e bën menjëherë. Je i kënaqur dhe nuk je i qetë me një çmim më të ulët se sa të është ofruar.

Pret me padurim ditën, kur malli yt do të paguhet...

Shiko çfarë kanë bërë ata, për të cilët u shpall ky ajet. Këta ishin pjesëmarrësit e Besëlidhjes së madhe në Akabe, ishin 70 vetë të cilët i prezantonte Abdullah b. Revaha (r.a.). Ai tha: "I Dërguar i Allahut, kërko për Zotin tënd dhe për vete çfarë dëshiron."

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha: "Për Zotin tim kërkoj, që vetëm Atë ta adhuroni dhe mos t'i bëni shok. Ndërsa për vete kërkoj të më mbronin ashtu siç mbronin veten tuaj dhe pasurinë tuaj." Abdullahu përsëri pyeti: "E çfarë fitojmë si këmbim për këtë?"

"Xhenetin" - u tha Pejgamberi (a.s.).

Sahabët u ngritën në këmbë duke thënë: "Pati sukses tregtia jonë! Zgjate dorën ta kurorëzohet këtë marrëveshje. Këtë marrëveshje asnjëherë nuk do ta shkëpusim dhe nuk dëshirojmë që edhe pala tjetër ta shkëpusë!"

Këta njerëz pranuan Islamin para disa muajve dhe tani janë të vetëdijshëm që duhet bërë tregti me Allahun. Janë të ndërgjegjshëm që Allahu nuk e then premtimin e Tij:

"E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu?..." (Teube, 111)

Sa herë e kemi dëgjuar këtë ajet dhe sa vjet jemi në Islam, por ende nuk e kemi kuptuar? Apo ndoshta mendojmë që Xhenetin ta fitojmë me çmim më të ulët?

Apo jemi bërë pishman dhe marrëveshjen e kemi shkëputur? Apo ndoshta dyshojmë që blerësi do ta paguajë çmimin e plotë! Çfarë po ndodh kështu me ne? Kur kërkojmë nga Allahu, kërkojmë shumë, ndërsa kur Allahu kërkon pak prej nesh, ne bëhemi koprracë dhe nuk jemi të vendosur... As anëtarësinë nga e cila varet ardhmëria e kësaj feje nuk jemi të gatshëm t'ia japim Allahut. Allahu na dhuron begati të panumërta, ndërsa ne për fenë e tij nuk jemi të gatshëm të bëjmë asgjë. Dhe pas të gjitha këtyre,

kërkojmë Xhenet.

Nuk i japim Allahut atë që ka blerë nga ne, e dëshirojmë pagesën me Xhenet...

Ebu Derda dëgjoi fjalët e Allahut:

"Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni." (Bekare, 245.)

- dhe e pyeti Pejgamberin (a.s.): "A thua Allahu kërkon prej nesh huazim?" Pejgamberi (a.s.), tha: "Po." Ebu Derda tha: "Zgjate dorën të bëjmë marrëveshje. Unë Allahu ia huazoj këto kopshte me 600 palma." E thërret bashkëshorten e tij duke i thënë: "O Ummu Dehdah, eja e dil nga kopshti, sepse ia kam huazuar Zotit tim!"

Kur e dëgjoi këtë ajet për herë të parë Ebu Bekri (r.a.), qau duke thënë: "Na ka parë Zoti ynë sa koprracë jemi dhe nuk kërkon më nga ne të harxhojmë në rrugën e Tij, por kërkon huazim."

Më lehtë është t'i huazosh dikujt, sepse ai këtë ta kthen shpejt, sesa t'i dhurosh diçka.

Suhejbi (r.a.), e la tërë pasurinë e tij dhe bëri hixhret. Para se të arrinte në Medine, Allahu shpalli për të ajetin:

"Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet." (Bekare, 207.)

E pret Pejgamberi (a.s.), duke i thënë: "Gëzohu, tregtia jote është e suksesshme, Suhajb!"

Dhe në fund pyete veten:

A thua pasuria jote dhe jeta janë aq të vlefshme sa t'i blejë Allahu?

A thua tashmë i ka blerë prej teje?

A thua marrëveshja e shitblerjes është bërë?

A je i përgatitur t'ia dorëzosh mallin Blerësit?

A je i gëzuar që me këtë Blerës ke bërë marrëveshje?

A i dëgjon udhëzimet e Pronarit të vërtetë të mallit?

Thuaj atë që ka thënë besimtari i vërtetë nga familja e Faraonit:

"Ju së shpejti do ta kujtoni atë që po ju them! Unë çështjen time ia lë Allahut, sepse Ai i sheh vërtet robërit e Vet." (Gafir, 44.)

Besimtari i vërtetë gjurmon për tregun në të cilin Allahu nga ai do të blejë diçka. Allahu i madhërishtëm thotë:

"Është Ai, që ju ka bërë trashëgimtarë në Tokë. Kush nuk beson, do të mbajë barrën e mohimit të vet. Mosbesimi u shton jobesimtarëve vetëm urrejtje para Zotit të tyre; mosbesimi u sjell atyre vetëm humbje." (Fatir, 29.)

Vëlla i dashur, bëje vakëf kohën tënde, familjen dhe veten... E pastaj prite ditën kur masa e plotë do të paguhet për mallin që Allahu e mendon aq me vlerë.

O Zot! Na jep, që ne të bëjmë tregti me Ty dhe që kjo tregti të jetë e suksesshme.

Mishi dhe gjaku i Kurbanit

Kur thuhet Kurban, në mendje të vjen menjëherë gjallëria që përfshin të gjithë shoqërinë islame. Sigurisht një pakicë të caktuar të njerëzve u kujton edhe rritjen e kafshëve për kurban, transportin, mishin, lëkurën, etj.

Kafshët që bëhen kurban në emër të Zotit, ndahen në pjesë të caktuara dhe u shpërndahen nevojtarëve; kështu atyre u qesh fytyra nga gëzimi. Kjo atmosferë vjen si rrjedhojë e elementeve materiale të Kurbanit...

Mirëpo, ashtu sikurse në të gjitha ibadetet, edhe në këtë, Zoti na kujton që nuk duhet neglizhuar aspekti shpirtëror i kësaj veprë sublime, ndaj Ai na tërheq vëmendjen duke na thënë: **“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj.”** (Haxh, 37) Asnjë vepër a sjellje, brenda së cilës nuk ka sinjeritet dhe çiltërsi, nuk ka vlerë të Allahut, pasi ato vepra që na shpëtojnë të pëlqimi i Zotit të Madhëruar,

janë ato ibadete që bëhen me devotshmëri dhe çiltërsi në zemrat tona dhe me qëllim pëlqimin e Allahut të Madhëruar.

Ashtu sikurse ka thënë edhe Pejgamberi ynë (s.a.s.), *“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve.”* kështu, një veprim dhurimi i një pjesëze të vogël që bëhet për hir të Allahut, fiton statusin e ibadetit. Ndoshta akoma pa arritur në dorën e nevojtarit ka mbërritur te Zoti i Madhëruar dhe shënohet në listën e veprave të mira dhe të pranuar.

Përkundrazi, as gjaku që derdhet e as pjesët që shpërndahen nuk kanë asnjëfarë vlere. Pjesët që ndahen pa këtë qëllim, nuk hynë në veprat e mira të individit. Sinjeriteti, devotshmëria dhe kushtet për të qenë vetëm akt për hir të Allahut, duhet të jenë në të gjitha veprat, kurse në ato që bëhen haptazi kjo gjë është e domosdoshme.





POLITIKA E EKUILIBRIT

Nuredin Jëlldëz

Të gjithë ne jemi robërit e Zotit, të krijuar nën emrin 'njeri'. Pikërisht, ngaqë jemi njerëz, jemi vënë në garën e të qenit robërit e denjë të Tij, me qëllim që të dallohemi se kush prej nesh e meriton këtë status të nderuar. Në provimin tonë nuk marrin pjesë engjëjt. As xhindët! Po ashtu, as krijesat e tjera që janë krijuar nën nivelin tonë, nuk janë pjesë e së njëjtës garë për të arritur statusin "rob i denjë i Zotit".

Ne jemi pjesë e një provimi, që është bërë enkas për ne. Kemi organe, si: tru, sy, veshë e stomak, që kemi nevojë për muskuj, që të mund të bëjmë ruku e sexhde dhe që muskujt tanë mund të forcohen në varësi të ushqimit që përdorim.

Ne jemi një formulë e ndërlidhur mbi ekuilibrin e përsosur: një fetë bukë kundrejt një sexhdeje; një gotë ujë kundrejt një tesbihati; një frymëmarrje e shëndetshme kundrejt një kijami.

Po ashtu, jemi të detyruar të jetojmë së bashku me gjithfarëlloj njerëzish. Vetmia është njëfarë skamjeje për ne. Për ta ndërë që jetojmë në këtë botë, syri duhet të na shohë njerëz, veshi duhet të na dëgjojë zëra. Aq sa kemi nevojë për xhaminë, kemi nevojë edhe për shtëpinë. Në xhami kërkojmë xhenetin, por në xhami nisemi nga shtëpia. Buzët tona janë krijuar në një mënyrë të atillë që të nxjerrin si zërin e të qarit, po ashtu edhe zërin e së qeshurës.

Kjo nuk është zgjedhja jonë. Kjo natyrë e jona është krijuar me dëshirën e Zotit tonë, i Cili krijon më të mirën dhe i jep formën që dëshiron kujtdo që Ai do. Ashtu sikurse ka krijuar natën dhe ditën, të ngrohtin dhe të ftohtin, të bukurën dhe të shëmtuarën, po ashtu Ai ka dashur të krijojë njeriun si qenie që qesh e qan. Pavarësisht nëse mund ta dimë ose jo urtësinë e këtij krijimi, Ai ka bërë krijimin më të bukur dhe më të përshtatshëm. Nuk mund të ketë asnjë lloj alternative tjetër më të përsosur sesa krijimi i Tij.

Politika e ekuilibrit është e vetmja mënyrë për të arritur qëllimin e krijimit, veçanërisht kur shohim njeriun që gjendet mes përplasjes së vazhdueshme të nevojave të

shturura dhe objektivave sublimë. Kësaj i thonë të jetosh në një ekuilibër të përshtatshëm në vlerën e vërtetë mes xhenetit dhe dynjasë. Të jetosh në ekuilibrin mes robërimit ndaj begatave të kësaj bote dhe robërisë ndaj Zotit.

Një botë që nuk bëhesh rob i saj, ushqimi që është konsumuar vetëm për të qëndruar në këmbë, shtëpia për t'u strehuar dhe për të mbrojtur nderin, tregtia që bëhet për të mbijetuar, afrimiteti me të afërmit, shoqërinë e miqësinë... Që të gjitha bëhen për hir të xhenetit. Ashtu sikurse gjendemi në këtë botë për të shkuar në xhenet...

Ja pra, ekziston një perceptim i tillë mes krijimit tonë si "forma më e përsosur" (ahsani takvim) dhe kërcënimit "forma më e poshtëruar" (esfeli safilin).

Të mos devijojmë synimin tonë; le të dimë të jetojmë për hir të Allahut.

Të mos i shenjtërojmë shtëpitë tona; le të mjaftohemi me ato çfarë nevojiten vërtet.

Të vazhdojmë tregtia jonë, puna jonë; le të mos jenë pengesë për përkujtimin e Allahut, që është qëllimi kryesor dhe për përpjekjen tonë, që të jemi robërit e Tij.

Të vazhdojmë miqësitë, lidhjet tona, por mos t'i bëjmë njerëzit më të shtrenjtë sesa fenë tonë, sesa kauzën tonë.

Të interesohemi për fëmijët tanë, të bëjmë investime për ta, por fëmijët tanë, nuk duhet të bëhen më të rëndësishëm se Krijuesi jonë, se feja jonë.

Të hajë e të pijë çdokush, por mos ta rëndojmë trupin tonë me teprime në konsumin e ushqimeve dhe pijeve të ndryshme.

Të mos na verbojnë epshet tona; le të mjaftohemi me disiplinën dhe me të lejuarën.

Të qeshim; le të mos ketë të qeshura që na shkaktojnë të qarat.

Të jetë e jona kjo botë; le ta marrim që të gjithën, por të mos hyjë në zemrat tona, por në kasafortat tona, në vendet ku lamë pasuritë tona materiale.

Atëherë edhe xheneti bëhet i yni...



Sulbe të zgjedhura

Naim Drilja

QËLLIMET E Haxhit

PARIMI I BARAZISË

Gjatë kryerjes së haxhit, të gjithë myslimanët e botës, pa dallim race, ngjyre, kombi, gjuhe, pozite etj., tubohen të gjithë në të njëjtin vend, veshin të njëjtat rroba, bëjnë të njëjtat veprime, në të njëjtën kohë, duket shumë qartë parimi i barazisë së njerëzve mes njëri-tjetrit. E gjithë kjo tregon unitetin e tyre në ndjenja, në simbole, në qëllime, në veprime dhe në fjalë.

Këtë parim kaq të lartë e ka shprehur i Dërguari i Allahut (a.s.), duke thënë: *"S'ka dyshim se ju të gjithë rridhni nga një baba, prandaj nuk ka dallim mes arabit dhe joarabit, as mes të bardhit dhe të ziut, por dallimi matet vetëm sipas devotshmërisë dhe frikës ndaj Allahut"* (Ahmedi)

RRËNJOSJA E PARIMIT: VËRTET,
BESIMTARËT JANË VËLLEZËR

Të gjithë haxhinjtë nga e gjithë bota, kanë të njëjtin qëllim: të shkojnë tek i njëjti vend, në një kohë të caktuar, duke kryer të njëjtat adhurime dhe rite. Kështu, në zemrat e besimtarëve forcohet vëllazëria islame. Le të meditojmë pak më shumë në ajetin, ku Allahu (xh.sh.), thotë:


"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër..."
(Huxhurat, 10.)

Lidhja që Allahu i Lartë ka pëlqyer për be-

simtarët, është më e fortë se vëllazëria e gjakut. Sa e bukur është kjo vëllazëri, sepse ajo qëndron mbi themelet e fesë dhe burimi i saj është lidhja mes njerëzve për hir të Allahut.

VAZHDIMI I ADHURIMEVE

Nga frytet më të dallueshme që vjel haxhiu gjatë kryerjes së Haxhit, është vazhdimësia në adhurimin e Allahut edhe pas kthimit prej tij. Kjo është edhe shenjë e pranimit të Haxhit. Kur e kanë pyetur Pejgamberin (a.s.), se cila punë është më e dashur tek Allahu, ai është



përgjigjur: "Ajo punë, e cila kryhet vazhdimisht, edhe nëse vlera e saj është e vogël." (Buhariu, Muslimi)

Haxhiu gjatë këtyre ditëve kalon nga një adhurim në tjetrin; sapo mbaron një adhurim, kalon tek një tjetër. Me këto veprime, besimtari edukohet që të jetë adhurues dhe të përjetojë ëmbëlsinë e adhurimeve të ndryshme, duke realizuar edhe qëllimin kryesor për të cilën është krijuar i gjithë njerëzimi po ashtu edhe xhindet. Allahu (xh.sh.), thotë:

"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë." (Dharijat, 56.)

EDUKIMI I VETES ME DISIPLINË

Kryerja e Haxhit në muajt e caktuar, agjërimi në muajin e Ramazanit, kohët e namazit në një kohë të caktuar apo edhe adhurimet e tjera, e dispijlojnë myslimanin të jetë korrekt në jetën e tij. Kjo gjë shtohet edhe më shumë në ditët e veçanta të kryerjes së Haxhit, ku secili rit kryhet në kohën dhe vendin e caktuar.

Kjo është një ftesë për çdo mysliman, që të dallojë nga të tjerët për disiplinën dhe korrektesinë që duhet treguar në afatet dhe takimet që ka në jetën e përditshme në marrëdhënie me të tjerët.



PËRBALLIMI I KUSHTEVE TË VËSHTIRA

Ai që shkon në haxh, i ndalon vetes shumë nga veprimet e jetës së luksit, të cilat i praktikonte më parë në shtëpi dhe në vendin e tij, qofshin ato edhe të lejuara. Po kështu, prania e madhe e njerëzve, vështirësitë dhe mundimet duke kaluar nga një vend në një tjetër, të gjitha këto e stërvisin besimtarin për të përballuar vështirësitë që has gjatë jetës së tij.

KA VETËM NJË MOTO

Jo rrallë dëgjojmë, lexojmë apo shikojmë parulla dhe moto të ndryshme, që ftojnë tek një racë, popull apo ide e veçantë, e cila fut tek myslimanët me besim të dobët urrejtjen dhe konfliktet, duke e shtuar edhe më tepër përçarjen dhe largimin e myslimanëve nga njëri-tjetri dhe duke i ndarë në grupe dhe rryma të ndryshme. Prandaj, të gjithë haxhinjtë kanë vetëm një moto dhe ajo është: **Leb-bejk Allahum-me leb-bejk!** "I përgjigjemi thirrjes tënde O Allah, I përgjigjemi!"

Ky është edukim për çdo mysliman që të bashkohet rreth një motoje, dhe të lërë pas krahëve të gjitha thirrjet dhe parullat e tjera, të cilat vetëm sa shtojnë konfliktet dhe përçarjen mes nesh.

EDUKIMI I NDËRGJEGJES

Sa shumë nevojë ka sot shoqëria islame të dallohet nga të tjerat me adhurime dhe me moralin e saj të bukur. Haxhi është ai, i cili rrënjës tek çdo mysliman këto synime fisnike dhe edukatë të lartë, në mënyrë që haxhiu të jetë shembulli dhe udhëzuesi më i mirë për atë që e shikon, e takon dhe jeton bashkë me të nga myslimanët dhe njerëzit e tjerë.

Myslmani patjetër duhet ta edukojë veten e tij dhe të jetë i vetëdijshëm se Allahu e shikon në çdo moment dhe duhet të ketë ndërgjegjen, e cila e mënjanon dhe e pengon nga fjalët e këqija dhe veprimet e shëmtuara.

I lutemi Allahut (xh.sh.), që veprat tona të jenë të singerta vetëm për Allahun, dhe t'ua pranojë haxhilerëve adhurimet dhe haxhin e tyre.

PËRFITIMET SHËNDETËSORE NGA USHQIMET PROFETIKE

"Stomaku është pellgu qendror i trupit, dhe venat janë të lidhura me të. Kur stomaku është i shëndetshëm, ai kalon gjendjen e tij në venat dhe venat do të qarkullojnë njësoj (shëndetshëm), dhe kur stomaku është në kalbje e sipër, venat do të thithin një gjë të tillë dhe do të lëshojnë të njëjtën gjë".

Sa u përket erëzave, përbërësit e preferuar ushqimor të Profetit Muhamed a.s ishin mjalti, vaji i ullirit, kripa dhe uthulla.

Sipas Muslimit, i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Stomaku është pellgu qendror i trupit, dhe venat janë të lidhura me të. Kur stomaku është i shëndetshëm, ai kalon gjendjen e tij në venat dhe venat do të qarkullojnë njësoj (shëndetshëm), dhe kur stomaku është në kalbje e sipër, venat do të thithin një gjë të tillë dhe do të lëshojnë të njëjtën gjë".*

MJALTI

Në përmbledhjen e Buhariut (Vëllimi 7), Aishja (r.a) transmeton se i dërguari i Allahut ka përdorur mjaltin.

Ai gjithashtu i atribuohet shumë kompetencave shëruese të mjaltit. Kurani i Shenjtë (16:69) thotë, **"Nga barku i saj [bletës], del një pije e ngjyrave të ndryshme, ku ka shërim për njerëzit. Sigurisht që këtu ka shenja për ata të cilët mendojnë."**

Mjalti nuk është vetëm një sheqer, por edhe një kombinim kompleks i enzimave, acideve organike, estereve, mineraleve, dhe komponentëve të paidentifikuara ende! Një kile mjaltë përmban 1,4 gram të proteinave, 23 miligram kalcium, 73 miligram të fosforit, 4.1 miligram te hekurit, 1 miligram i niacin dhe 16 miligram vitaminë C. Mjalti ka qenë përdorur për shërimin e plagëve dhe djegieve, dhe duke e bërë lëkurën të shëndoshë dhe të qetë. Brenda vetes, mjalti është një kurë për të gjithë, me përfitime të veçanta për sistemin e tretjes dhe si një tonik për shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien.

VAJI I ULLIRIT

Profeti Muhamed a.s gjithashtu na këshilloi për të

përdorur vajin e ullirit si ushqim dhe melhem, sepse siç tha ai, vjen nga një pemë e bekuar. (Tirmidhi).

Gjithkush e di se yndyra shtazore përmban acide yndyrore të ngopura vertikalisht që rrisin nivelet e kolesterolit në



gjak. Por acidet yndyrore, si vaj ulliri, kontrollojnë nivelet e yndyrës, dhe stabilizojnë ato. Në fakt, nuk ka vaj tjetër të prodhuar natyrshëm si vaji i ullirit.

Vaji i ullirit përmban edhe vitamina E dhe K, dhe polifenole, të cilat ofrojnë një mekanizëm mbrojtës në vonesat e plakjes dhe parandalon karcinogjenezën dhe arteriosklerozën, çrregullimet e mëlçisë dhe inflamacionet. Oleatet në vaj gjithashtu nxisin formimin e kockave të fëmijëve mbrojnë, dhe kockat e të moshuarve. Edhe Gazeta Amerikane e Institutit Kombëtar të Kancerit raportoi se vaji i ullirit ofron mbrojtje të fortë në luftën kundër kancerit të gjirit.

KRIPA

Në kundërshtim me besimin popullor modern, kripa është gjithashtu një erzë e dobishme. Profeti tha, "Kripa



është mjeshtër i ushqimit tuaj, Allahu i zbriti katër bekime nga qielli; Zjarrin, ujin, hekurin dhe kripën" (Ibën-Maxhe). UNICEF raporton se trupi ka nevojë vetëm për një sasi minimale të kripës, megjithatë, mungesa e lëndës ushqyese shkakton çrregullime të ndryshme trupore.

Mungesa e kripës shkakton edhe dëmtime mendore. Studimet vlerësojnë se fëmijët që jetojnë në zonat e mangëta me jod, kanë shkallë më të ulët të inteligjencës. Mjekët shpesh rekomandojnë ujë të kripur kur punojmë punë të rënda fizike. Marrja e mjaftueshme e kripës lufton sindromën e lodhjes kronike.


UTHULLA

Uthulla është një lëng i përbërë kryesisht prej acidit acetik (CH₃CO₂H) dhe ujit. Acidi acetik është prodhuar nga fermentimi i etanolit nga baktereve të acidit acetik.

Profeti e ka quajtur uthullën "erëza e bekuar" (Mus-

limi). Shkenca moderne ka konfirmuar se uthulla ka me të vërtetë shumë bekime. Një libër i kohëve të fundit flet rreth uthullës, dhe përfitimeve që i sjellë ajo shëndetit tonë, dhe citon prova të shumta shkencore të këtij pohimi. Megjithatë, uthulla, si një nga "mrekullitë" ishte e njohur edhe para kohës së Pejgamberit (a.s.).

Megjithatë, gjëja më e rëndësishme që ne mund të mësojmë nga të ushqyerit profetik është moderimi në ushqim (mos teprimi). Si dhe gjithmonë duhet të ja kujtojmë vetes se çfarë thotë Kurani i Madhëruar: **"Hani nga të mirat që u kemi dhënë, por mos e teproni"**



KUJDES ME PJET E ËMBËLSUARA

Konsumimi i pijeve jocalësore, atyre të ëmbëlsuara me sheqer artificial, është shumë i lartë, veçanërisht te fëmijët dhe adoleshentët.

Hulumtimet kanë treguar se energjia e konsumuar përmes pijeve të cilat përmbajnë kryesisht sheqerna të thjeshta, grumbullohet më shumë në organizëm se sa energjia e konsumuar nga pijet e shëndetshme, që përmbajnë kombinim të lëndëve të ndryshme ushqyese.

Për më tepër, pijet e ëmbëlsuara artificialisht, japin një



ndjenjë edhe më të madhe etjeje, duke shtuar më shumë nevojën për konsumim.

Në këtë mënyrë pijet me sheqerna artificial kanë prirje më të madhe për të nxitur obezitetin te fëmijët dhe të rinjtë, që më pas lidhet me një varg problemesh tjera shëndetësore.

Ekspertët këshillojnë fëmijët dhe prindërit të mos shmangin konsumimin e lëngjeve, por të zgjedhin ato që janë qind për qind natyrale, t'i shtrydhin vetë ose të konsumojnë më shumë pemë të freskëta në vend të lëngjeve.

MË SHUMË USHQIM TË SHPEJTË, MË PAK VITAMINA

Konsumimi i shpeshtë i ushqimit të shpejtë ka për pasojë edhe konsumimin e paktë të vitaminave dhe mineralave.

"Fastfood" gjithnjë e më shumë po pushton njerëzit, përfshirë edhe fëmijët. Kjo me arsyen kryesore se prindërit janë të angazhuar dhe nuk kanë shumë kohë t'u përgatitin ushqime të shëndetshme fëmijëve të tyre.

Por ekspertët paralajmërojnë prindërit se konsumimi i shpeshtë i ushqimeve të shpejta rezultojnë me shmangie të lëndëve esenciale ushqimore.

Me anë të ushqimit jo të shëndetshëm, fëmijët tuaj konsumojnë sasi të lartë të kripës, karbohidrateve dhe yndyrave, të cilat nxisin obezitetin dhe i bëjnë ata më

të prirë ndaj problemeve në të ardhmen.

Në anën tjetër, ka një ulje të konsumimit të vitaminave dhe mineraleve, të cilat janë esenciale për rritje dhe zhvillim të shëndetshëm fizik dhe mental të fëmijëve.



DAVUTOGLU - OKB-SË: SHANSI I FUNDIT PËR TA SHPËTUAR FYTYRËN TUAJ

Përderisa trafiku diplomatik në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është i drejtuar kah Siria, Ministri i Jashtëm turk paralajmëroi se ky ishte "shansi i fundit" për Këshillin e Sigurimit që ta shpëtoj fytyrën e vet.

Ahmet Davutoglu, ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë i cili ishte në Nju Jork me rastin e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, mbajti një konferencë të përbashkët për shtyp me Ministrin e Jashtëm të Finlandës, Erkki Tuomioja, pasi ndiqte një takim të Grupit të Miqve të Ndërmjetësimit.

Duke vënë në dukje se kriza siriane duhet të ndalet pa humbje të mëtejshme të jetëve, Davutoglu tha: "Ky është shansi i fundit i Sigurimit të OKB-së për të ruajtur fytyrën e saj, të cilën veçse e ka humbur për shkak të dështimit për të parandaluar luftën siriane. Ky është një test për të gjithë ne, dhe Këshillit të OKB-së në veçanti, dhe unë shpresoj që ata ta kalojnë këtë test."

Duke theksuar se KS i OKB-së ka dështuar të bëjë punën e saj për krizën në Siri deri tani, Davutoglu tha se shpresa e fundit ishte për të gjetur një zgjidhje politike.

Duke rikujtuar se Turqia ka bërë të gjitha përpjekjet që mund të kishin parandaluar një përshkallëzim të mëtejshëm të situatës në Siri, Davutoglu tha se KS i OKB ka



dështuar disa herë për të dalë me një rezolutë.

"Unë shpresoj se ata nuk do të dështojnë këtë herë; sepse çdo dështim shkakton humbjen e më shumë jetëve. Ata kanë një përgjegjësi shumë më të madhe tani."

Ministri i Jashtëm i Finlandës, Erkki Tuomioja tha se KS i OKB duhet të veprojnë menjëherë, jo vetëm për të ndaluar përdorimin e armëve kimike, por edhe për t'i dhënë fund dhunës aktuale të kryer nga armët konvencionale. "Dështimi për të arritur një rezolutë nuk është një opsion," tha Tuomioja.

Ndërkohë, Davutoglu zhvilloi një takim dypalësh me sekretarin e Jashtëm britanik Uilliam Hagë për të diskutuar çështjen e Sirisë dhe të shkëmbejnë ide mbi rezolutën e KS të OKB-së.

Duke deklaruar se zgjidhja duhet të jetë e rreptë dhe parandaluese, Davutoglu tha se duhet të ketë sanksione të qarta kundër regjimit të Asadit në rast se ato nuk janë në përputhje me procesin e shkatërrimit të armë kimike, dhe vuri në dukje rëndësinë për të marrë hapat e nevojshëm për t'i dhënë fund gjakderdhjes.

TAKIMI RAMA-GYL: TURQIA PREMTON NDIHMË EKONOMIKE PËR SHËNDETËSINË

Në ditën e tretë të zhvillimit të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama u takua me disa liderë të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Rama pati takim me Presidentin e Turqisë Abdullah Gyl,

Presidentin e Bullgarisë Rosen Plevneliev, Presidentin e Kroacisë Ivo Josipović, Kryeministrin e Malit të Zi MiloGjukanović, si edhe Drejtoreshën e Përgjithshme të PNUD Helen Clark.

Gjatë takimit me Presidentin turk, Rama nënvizoi edhe njëherë partneritetin strategjik

mes dy vendeve. Gyl dhe Rama biseduan edhe për nxitjen e mëtejshme të marrëdhënieve tregtare mes Shqipërisë dhe Turqisë. Një vëmendje të posaçme në këtë takim pati gjithashtu edhe ndihma që qeveria turke mund të japë për përmirësimin e sistemit shëndetësor në vendin tonë.

NASA KONFIRMON SE VOYAGER 1 KA LËNË SISTEMIN TONË DIELLOR

Shkencëtarët e NASA-s kanë konfirmuar se sateliti kërkimor Voyager 1 ka hyrë në histori përsëri, pasi është tani objekti i parë i ndërtuar nga njerëzit për të lënë sistemin tonë diellor dhe vazhdon të bëjë rrugën e saj në të gjithë pjesën tjetër të hapësirës ndër-yjore.

Gjatë viteve të fundit, vendndodhja e saktë e Voyager 1 ka qenë debatuar në mesin e ekspertëve, nëse e ka lënë sistemin tonë diellor apo jo dhe kur NASA tha se kjo është zyrtare, atëherë

ajo është. Rëndësia e kësaj arritjeje është padyshim një testament për ekipin prapa satelitit Voyager 1, pasi ka udhëtuar 12 miliardë milje që kur u nis në vitin 1977.

Voyager 1 është duke fluturuar përmes hapësirës me një shpejtësi prej 37.000 kilometra në orë dhe tani që është aq larg, i duhet 17 orë vetëm për të dërguar sinjale në tokë. David Alexander, i cili drejton Institutin e Hapësirës në Universitetin Rice, tha se, "informacionet që ne do të marrim nga Voyager do të ndryshojë atë që ne



dimë rreth universit, thjesht sepse ne dimë aq pak përtej sistemit tonë diellor. Ne nuk kemi qenë atje më parë."

STUDIUESIT KONTROLLOJNË TRURIN E NJË PERSONI NËPËRMJET INTERNETIT



Studiuesit në Universitetin e Uashingtonit, kanë lidhur me sukses trurin e dy personave nëpërmjet internetit.

Në një eksperiment të quajtur

"Komunikimi tru më tru në njerëzit", shkencëtarët e përfshirë në hulumtim ishin në gjendje të dërgojnë një sinjal në tru përmes internetit për të kontrolluar dorën e një studiuesi tjetër, i ulur në një zonë të veçantë.

Dy studiuesit e përfshirë në projekt, Rajesh Rao dhe Andrea Stocco, kanë lidhur trurin e tyre me një kapelë që përfshinte një "spirale magnetike stimulimi," e cila mund të lexojë dhe të stimulojë trurin. Z. Rao pastaj dërgoi një sinjal në trurin e z. Stocco, duke e detyruar atë të lëvizë gishtin e tij,

për të goditur butonin "zjarr" në një lojë kompjuterike.

Teknologët kanë punuar për vite për të krijuar ndërfaqe kompjuterike që kontrollohen me atë të trurit, e cila do të na lejojë për të bashkëvepruar me telefonat inteligjentë dhe kompjuterët, thjesht duke përdorur mendjen tonë.

Studiuesit e Universitetit të Uashingtonit kanë përdorur elektroencefalogramin, ose EEG, për të regjistruar aktivitetin e trurit dhe pastaj kanë "stimuluar" trurin, duke përdorur një teknologji të quajtur transkranial magnetike.

ASGJËSIMI I PAJISJEVE TË VJETËRUARA ELEKTRONIKE

Imagjioni, që një ditë, të mos keni nevojë ta hidhni telefonin celular, ose kompjuterin tuaj të vjetruar, sepse ato do të asgjësohen duke i shkrirë. Sot duket e pamundur, por kimistët amerikanë thonë se është vetëm çështje kohe para se kjo të bëhet diçka e realizueshme, duke na ndihmuar të përmirësojmë gjendjen e mjedisit.

Tani, studiuesit në Universitetin e Illinoit kanë krijuar projektin

"Born to die". Ata kanë krijuar një mikroçip të bërë nga fibra natyrale, si mëndafshi, që funksionon njëllë si çdo mikroprocesor tjetër. Kështu, çdo magnetofon, televizor, kompjuter, apo telefon i vjetruar, që e ka kryer funksionin, do të mund të shkrihet me një spërkatje të vetme.

Çdo vit prodhohen male me mbeturina nga prodhimet elektronike që hidhen dhe që ndotin mjedisin dhe materiali i ri mund



t'i japë rrugë zgjidhjes së këtij problemi.